This paper elaborates on the public debt in the Republic of Kosovo. Public debt or government debt refers to the obligations a government has to pay a specified amount at a specified future to bondholders issued by the government or other related institutions. State debt in particular is present in less developed countries, which burdens the economy and population of these countries, which are also faced with numerous problems. The countries of the region, including Kosovo, with a low level of development, have been facing public debt in recent years. The objectives of this paper consist of:

- ☐ To analyze the budget deficit, internal debt and external debt;
- ☐ To analyze the public debt in Kosovo compared to the countries of the region.
- ☐ Analysis of the progress of public debt in the Republic of Kosovo in recent years;

In function of the objectives within this study, we will mainly use the analysis method and the comparative method, examining in dynamics the issue related to the public debt in the Republic of Kosovo. Through this study in the field of public finance, we aim for the conclusions and recommendations offered regarding the public debt to be taken into consideration.

Key concepts: Public debt, External debt, Internal debt, budget deficit.

Hyrje

Borxhi Shtetëror mund të jetë borxh i drejtpërdrejtë apo borxh i nënhuazuar. Kurse sa i përket juridiksionit të cilit i nënshtrohet, Borxhi i Përgjithshëm mund të ndahet në Borxh Ndërkombëtar dhe në Borxh të Brendshëm – ku Borxhi i Brendshëm i nënshtrohet juridiksionit vendor, ndërsa ai Ndërkombëtar mund t’u nënshtrohet edhe juridiksioneve jashtë Republikës së Kosovës.

Në Kosovë, materia e borxhit publik rregullohet me Ligjin Nr. 03/L-175, Për borxhin publik në Republikën e Kosovës, ku përcaktohet forma e borxhit dhe mënyra e menaxhimit të tij. Në Republikën e Kosovës, borxhi publik zë fill viteve të fundit dhe krahasuar me vendet tjera të rajonit, Kosova ka nivelin më të ulët të borxhit publik në raport me BPV-në.

Materiali dhe metoda

Për finalizimin e këtij punimi, materiali i paraqitur ka mbështetje si vijon:

- Studime dhe literaturë vendëse dhe të huaj, si dhe raporte e publikime nga Ministria e Financave, ku trajtohen çështje lidhur me Borxhin publik në Republikën e Kosovës.
- Është përdorur burimi statistikor vendas, metoda e analizës dhe sintezës, tabelore dhe grafike veçmas, metoda krahasuese, etj.

Rezultate dhe diskutime

Borxhi publik

Ligji Nr. 03/L - 175, Për borxhet publike në Republikën e Kosovës, neni 1 i këtij ligji i jep të drejtën Qeverisë së Republikës së Kosovës për të huazuar para, për të dhënë garanci për hua, për të paguar shpenzimet për marrjen e borxhit dhe për të paguar kryegjënë dhe interesin e Borxheve të saja Shtetërore. Veç kësaj, i jep Ministrit të Ekonomisë dhe Financave të drejtën dhe përgjegjësinë, për t’u kujdesur për tërë menaxhimin dhe administrimin e Borxheve. Borxhi i Përgjithshëm përkufizohet me Ligjin për Borxhin publik si, tërësia e borxhit shtetëror dhe borxhit komunal. Borxhi i përgjithshëm i Kosovës është borxh shtetëror, pasi Republika e Kosovës akoma nuk ka borxh komunal. Në tabelën në vijim jepet borxhi i përgjithshëm sipas llojit.

Tabela- 1: Borxhi i përgjithshëm në Republikën e Kosovës, në periudhën 2017 – 2022.


- milionë euro


Kategoria	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Borxhi i jashtëm	422.15	416.43	409.10	525.80	576.75	641.20
Niveli Qendrorë	365.18	364.53	359.45	479.50	532.31	594.19
Nën-huazimet	56.97	51.90	49.65	46.29	44.44	47.01

Komunat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Borxhi i Brendshëm	574.27	676.62	791.94	961.90	1,106.14	1,112.00
Niveli Qendrorë	574.27	676.62	791.94	961.90	1,106.14	1,112.00
Komunat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej Borxhi i përgjithshëm	996.42	1,093.05	1,201.05	1,487.69	1,682.89	1,753.20
Garancionet Shtetërore	44.00	43.70	42.68	31.65	30.63	29.61
Borxhi i përgjithshëm(% BPV-së)	16.37%	17.04%	17.63%	22.44%	21.53%	20.74%

Burimi: Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Të dhënat tre-mujore mbi borxhin e përgjithshëm - TM1, Prishtinë, 2022, fq, 5.

Grafiku-1: Borxhi i përgjithshëm në Republikën e Kosovës, në periudhën 2017 – 2022.





■ Gjithsej Borxhi i Përgjithshëm ● Gjithsej Borxhi i Përgjithshëm (% e BPV-së)

Tabela 2. Protofoli i Borxhit sipas valutës

	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Borxhi i Përgjithshëm	996.4	1,093.05	1,201.05	1,487.69	1,682.89	1,753.20
Fiks	835.65	932.91	1,055.51	1,355.66	1,600.29	1,676.95
Variabil	160.77	160.14	145.54	132.03	82.6	76.26
Borxhi Ndërkombëtar	422.2	416.43	409.1	525.8	576.75	641.2
Fiks	261.38	256.29	263.57	393.77	494.14	564.95
Variabil	160.77	160.14	145.54	132.03	82.6	76.26
Borxhi i Brendshëm	574.3	676.62	791.94	961.9	1,106.14	1,112.00
Fiks	574.27	676.62	791.94	961.9	1,106.14	1,112.00

Tabela 3. Protofoli Borxhit sipas interesit

	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Borxhi i Përgjithshëm	996.4	1,093.05	1,201.05	1,487.69	1,682.89	1,753.20
EUR	856.91	948.33	1,068.73	1,368.38	1,590.86	1,672.09
SDR*	139.51	144.46	128.99	117.5	89.74	79.6

SAR	0	0.25	2.08	1.23	1.66	1.31
USD	0	0	1.24	0.57	0.63	0.2
Borxhi Ndërkombëtar	422.2	416.43	409.1	525.8	576.75	641.2
EUR	282.64	271.71	276.79	406.49	484.71	560.09
SDR*	139.51	144.46	128.99	117.5	89.74	79.6
SAR	0	0.25	2.08	1.23	1.66	1.31
USD	0	0	1.24	0.57	0.63	0.2
Borxhi i Brendshëm	574.3	676.62	791.94	961.9	1,106.14	1,112.00
EUR	574.27	676.62	791.94	961.9	1,106.14	1,112.00

Nga tabela dhe grafiku vërehet se, kryesisht borxhi publik i Republikës së Kosovës është në nivelin qendror. Struktura e borxhit publik përfshinë përveç borxhit të jashtëm edhe borxhin e brendshëm.

Borxhi publik në Kosovë në periudhën 2017-2022 ka pasur ecure në rritje, duke u rritur nga 996.42 milionë euro sa ishte në vitin 2017, duke arritur në tremujorin e parë 2022 në 1,753.20 milionë euro. Po ashtu borxhi publik në Republikën e Kosovës ka ecure në rritje sa i përket pjesëmarrjes në BPV-në, duke u rritur pjesëmarrja e borxhit publik në raport me BPV-në nga 16.37% sa ishte në vitin 2017, duke arritur pjesëmarrja e borxhit publik në raport me BPV-në në 20.74% në tremujorin e parë të vitit 2022.

Borxhi i jashtëm në periudhën 2017-2022 vërehet se ka ecure në rënie sa i përket pjesëmarrjes në borxhin e përgjithshëm, ku në vitin 2017 borxhi i jashtëm ishte 82 përqind duke pasur ecure të rënies në vitet në vijim, kështu që në vitin 2021 kishte pjesëmarrje në borxhin e përgjithshëm prej 43.83 përqind.

Borxhi i brendshëm në periudhën 2017-2022 kishte ecure në rritje të pjesëmarrjes në borxhin e përgjithshëm, ku në vitin 2017 borxhi i brendshëm kishte pjesëmarrje në borxhin e përgjithshëm prej 17.88 përqind, duke u rritur në vitet në vijim kështu që në vitin 2021 pjesëmarrja e borxhit të brendshëm në borxhin e përgjithshëm ishte 56.17 përqindja.

Financimi i deficitit buxhetor

Për të mbuluar deficitin buxhetor, shteti duhet të hyjë borxh, që shprehet negativisht në rrjedhat ekonomike. Borxhi shtetëror apo publik, siç quhet ndryshe, paraqet vlerën e akumuluar të huave, të cilat shteti i ka huazuar për t'i financuar deficitet e kaluara. Borxhi shtetëror për një periudhë të caktuar kohore është i barabartë me deficitin buxhetor të të njëjtës kohë. Me Ligjin Nr. 03/L – 175, për Borxhin Publik, neni 3, qëllimet e autorizuara për huamarrje,

Ministria (Ministria e Financave) është entiteti i vetëm i autorizuar për të hyrë në (shkaktuar) borxhe shtetërore për qëllimet në vijim:²⁷

1. Për financimin e deficitit të buxhetit shtetëror, kur shpenzimet e autorizuar me ligj tejkalojnë, apo ka mundësi të tejkalojnë, sipas gjykimit (vlerësimit) të Ministrit, të hyrat e nevojshme për t'i paguar ato;
2. Për financimin e projekteve investuese të cilat vlerësohet të jenë synim kombëtar dhe janë të përfshira në BKK (Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës) dhe në KASH (Korniza Afatmesme e Shpenzimeve);
3. Për të ri-financuar Borxhet Shtetërore të kontraktuara më herët;
4. Për të paguar Garancitë Shtetërore, në tërësi apo pjesërisht, në rast se huamarrësit dështojnë ti përmbushin obligimet e tyre të huas;
5. Për të paguar shpenzimin e shërbimit të Borxhit Shtetëror, duke përfshirë, mirëpo duke mos u kufizuar vetëm në, shpenzimet e ndërlidhura, si për shembull provizione për emetimin e letrave me vlerë, mirëmbajtja e llogarive, riblerjen dhe provizionet e agjencive fiskale;
6. Për të paguar shpenzimet e ndërlidhura me një emergjencë kombëtare të shpallur nga Kuvendi.

Qeveria përmes Ministrisë së Financave, përveç legjislacionit bazë mbi borxhin publik ka hartuar Rregulla dhe Procedura përkatëse, për të rritur transparencën e menaxhimit dhe përcaktimin e përgjegjësive menaxhuese.

Tabela-4: Deficiti buxhetor ndaj BPV-së në Republikën e Kosovës në periudhën 2016-2019

Përshkrimi	2016	2017	2018	2019 Proj.
Të hyrat publike	1,345	1,470	1,634	1,725
Shpenzimet publike	1,480	1,564	1,732	2,001
Financimi vjetor nga huamarrja	121	187	184	361
Stoku i borxhit të brendshëm	257	378	478	578
Garancionet shtetërore	0.00	10.00	40.00	44.00
BPV	5,568	5,568	6,031	6,410
Deficiti si % e BPV-së	-2.3%	-1.4%	-1.6%	-1.5%

²⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Borxhin Publik, Nr. 03/L – 175, neni 3, Prishtinë, 2009.

Burimi: Ligji Nr.05/L-125, Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, fq, 19.

Deficiti buxhetor mbahet në nivelet e përcaktuara përmes rregullës fiskale nën 2% të BPV-së. Deficiti buxhetor kryesisht financohet nga huamarrja e brendshme dhe huamarrja e jashtme.

Borxhi i brendshëm dhe Borxhi i jashtëm i Kosovës

Borxhi i brendshëm

Borxhi i brendshëm paraqet pjesë të borxhit publik që shteti u detyrohet subjekteve ekonomike dhe qytetarëve të vet.²⁸ Në nenin 7 të Ligjit Nr. 03/L - 175 „Për borxhet publike” në Republikën e Kosovës, përcaktohet forma e borxheve, ku një nga format e borxheve është edhe emetimi i letrave me vlerë. Qeveria ka filluar të emetoj Letra me Vlerë (Bona të thesarit) në janar të vitit 2012. Ankandi i parë ka përfunduar me sukses më 17 janar 2012.²⁹ Sipas Ligjit për Borxhet Publike³⁰, Komuna nuk mund të hyjë në borxh publik pa i plotësuar parakushtet e parapara, kështu që aktualisht nuk ka ndonjë borxh komunal.

Huamarrja nga borxhi i brendshëm bëhet përmes emetimit të letrave me vlerë, ku instrumentet kryesore janë Bonot e Thesarit me maturitet deri në 12 muaj, si dhe Obligacionet Qeveritare, me maturitet më të gjatë se 1 vit.³¹

Tabela-5: Borxhi i Brendshëm sipas instrumenteve (vlerë nominale), në periudhën 2014-2018

-milionë euro

Instrumenti	2014	2015	2016	2017	2018
3 muaj	30.00	15.20	9.7	10.00	40.00
6 muaj	44.00	84.00	57.67	48.60	60.00
12 muaj	---	55.00	140.10	150.00	160.00
2 vite	---	---	52.00	126.95	85.00
3 vite	---	---	---	30.00	50.00
5 vite	---	---	---	15.00	35.00
Letrat me Vlerë (nominal)	74.00	154.20	259.52	380.55	430.00

Burimi: Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Buletini vjetor 2019, Prishtinë 2019, fq. 11

Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Të dhënat tre-mujore mbi borxhin e përgjithshëm - TM1, TM2, TM3, TM4 2016, Prishtinë, 2019, fq.10

²⁸ Dr. Musa Limani, Makroekonomia, Prishtinë 2013, fq, 237.

²⁹ Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Strategjia vjetore e borxhit 2022, Prishtinë 2022, fq, 9.

³⁰ Ligjit Nr. 03/L – 175, Për borxhet publike në Republikën e Kosovës, Neni 30.

³¹ Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Programi i borxhit shtetëror 2016-2022, Prishtinë 2022, fq, 17.

Sa i përket emetimeve të reja gjatë periudhës 2014-2018, në secilin vit ka pasur ecuri në rritje të emetimeve të reja, kështu në vitin 2014 emetimet e letrave me vlerë ishin 73.3 milionë euro, në vitin 2015 emetimet e reja ishin 79.2 milionë euro, duke u rritur emetimet e reja në 104.01 milionë euro në vitin 2016, në 121.2 milionë euro në vitin 2017 dhe në 101.19 milionë euro në vitin 2018.

Borxhi i brendshëm në Republikën e Kosovës është i shpërndarë në blerës të ndryshëm dhe pjesëmarrja gjatë periudhës 2014-2018 ishte e ndryshme, kurse në tremujorin e parë të vitit 2017 kishte këtë pjesëmarrje të blerësve.

Tabela-6: Borxhi i brendshëm sipas blerësve në Tremujorin e parë 2018

Nr.	Mbajtësit e Letrave me Vlerë	Tremujori i parë 2017, Përqindja
1	Bankat komerciale	47%
2	Fondet e pensioneve	16%
3	Institucionet Publike	31%
4	Kompanitë e sigurimeve	4%
5	Të tjera	2%
6	Totali	100%

Burimi: Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Të dhënat tre-mujore mbi borxhin e përgjithshëm - TM1, Prishtinë, 2017, fq,10.

Investitorët kryesor në tregun e brendshëm vazhdojnë të jenë bankat komerciale të licencuara në Kosovë, pastaj Trusti Pensional dhe në fund si të tjerë janë klasifikuar individ, korporata private dhe publike që kanë tregtuar në tregun sekondar.

Në tabelën dhe grafikun më lartë paraqiten blerësit e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të cilën pjesën më të madhe e përbëjnë Bankat komerciale dhe Fondet pensionale, etj. Borxhi i brendshëm i qeverisë, i cili në pjesën më të madhe është borxh në formë të letrave me vlerë ndaj bankave (47 përqind e gjithsej borxhit të brendshëm) institucioneve publike (31 përqind) dhe fondeve pensionale (16 përqind).

Borxhi i jashtëm

Borxhi i jashtëm paraqet borxhin që një vend u detyrohet vendeve të huaja ose institucioneve financiare ndërkombëtare nga të cilat ka marrë hua.³² Borxhi i jashtëm i Kosovës është borxhi që e ngarkon Kosovën ndaj kreditorëve të jashtëm, ku pjesa më e madhe e borxhit është ndaj Bankës Botërore dhe FMN-së. Borxhi Shtetëror i Kosovës është krijuar në vitin 2009. Në atë kohë, portofoli përbëhej prej vetëm një kredie të quajtur Kredia e Konsoliduar C nga Banka Botërore.³³ Shuma totale e kësaj kredie ishte 381.21 milion Euro. Kredia KKC është trashëguar nga ish-Jugosllavia si pjesë e Borxhit Shtetëror të Kosovës. Përmes tabelës në vijim pasqyrohet ecuria e borxhit të jashtëm gjatë viteve 2017-2022.

Tabela-7:Ecuria e borxhit të jashtëm në periudhën 2017-2022
-milionë euro

Përshkrimi	2017	2018	2019	2020	2021	2022 (TM 1)
Borxhi i jashtëm	422.15	416.43	409.10	525.80	576.75	641.20
Niveli qendrorë	365.18	364.53	359.45	479.50	532.31	594.19
Borxhi i nën huazuar	56.97	51.90	49.65	46.29	44.44	47.01
Borxhi i përgjithshëm	996.42	1,093.05	1,201.05	1,487.69	1,682.89	1,753.20
Gjithsej borxhi i përgjithshëm (% e BPV-së)	16.37%	17.04%	17.63%	22.44%	21.53%	20.74%

Burimi: Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Të dhënat tre-mujore mbi borxhin e përgjithshëm - TM1, Prishtinë, 2022, fq, 5-7

Zhvillimet fiskale dhe borxhi publik në vendet e Ballkanit Perëndimor

Borxhet gjithnjë e më të mëdha të shtetit, prirja gjithnjë e më e madhe e organeve ligjdhënëse dhe ekzekutive të pushtetit që shumë shpenzime nga kompetenca e shtetit ti financojnë me mjetet e huas, tendenca gjithnjë e pranishme në shumë vende për zgjerimin e aktivitetit financiar të shtetit po e aktualizojnë gjithnjë e më tepër problemin e kufirit të hyrjes borxh të shtetit.³⁴ Në Kosovë kufiri i hyrjes borxh të shtetit parashihet në nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-175, Për borxhet publike në Republikën e Kosovës, ku përcaktohen kufizimet në Borxhin e Përgjithshëm, i cili nuk duhet të tejkalojë 40% të BPV-së. Borxhi shtetëror në veçanti është i pranishëm në vendet jo mjaft të zhvilluara, i cili ngarkon, edhe ashtu të ballafaquara me probleme të shumta, ekonominë dhe popullatën e këtyre vendeve.

³² Dr. Musa Limani, Makroekonomia, Prishtinë 2013, fq, 241.

³³ Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Buletini vjetor 2015, Prishtinë, 2016, fq, 8.

³⁴ Dr. Bozhidar Jelçiq, Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare, Prishtinë 1985, fq, 442.

Kjo aq më parë kur dihet se borxhi qeveritar paraqet barrë të madhe për ekonominë dhe popullsinë e vendit përkatës, pasi që ai duhet kthyer me interes dhe si i tillë ngarkon, përkatësisht zvogëlon, të ardhurat kombëtare. Vendet e rajonit duke përfshirë Kosovën me nivel të ulët zhvillimor ballafaqohen viteve të fundit me borxhin publik.

Përfundimi

Qeveritë marrin hua duke emetuar letra me vlerë, obligacione qeveritare, si borxh i brendshëm dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare si borxh i jashtëm. Kosova vazhdon të ketë një nivel rritje ekonomike pozitive dhe një stabilitet makroekonomik, mirëpo viteve të fundit ka filluar të ketë edhe borxhin publik, duke pasur ecuri të rritjes në vijueshmëri gjatë viteve të fundit.

Në kuadër të punimit lidhur me borxhin publik në Republikën e Kosovës në periudhën 2017-2022, paraqesim disa nga konkluzionet dhe rekomandimet si vijon:

Në kuadër të borxhit publik në Republikën e Kosovës, bazuar në ligjin për borxhin publik, kufizimi i borxhit publik që nuk duhet të tejkalojë 40 përqind të BPV-së, si dhe me rregullën fiskale, deficitit buxhetor nuk duhet të jetë më shumë se 2 përqind të BPV-së.

- Kosova aktualisht ka nivel të ulët të borxhit publik në raport me BPV-në që në fund të vitin 2016 ishte 14.47 përqind të BPV-së.
- Borxhi publik në Kosovë kryesisht është borxh i nivelit qendror, ngase aktualisht nuk ka borxh të nivelit komunal.
- Borxhi publik në Republikën e Kosovës në periudhën 2017-2019, përkundër nivelit të ulët në raport me BPV-në është rritur për 6 përqind, përkatësisht nga 8.44 përqind sa ishte në vitin 2017 në 14.47 përqind në vitin 2020 në raport me BPV-në.
- Sa i përket stokut të borxhit publik në periudhën 2015-2019, borxhi i brendshëm është rritur me ritme më të shpejta sesa borxhi i jashtëm. Borxhi publik i Kosovës fillimisht është dominuar nga borxhi i jashtëm, ndërsa viteve të fundit vërehet rritje e borxhit të brendshëm duke arritur në fund të vitit 2019 në 56.17% përqind të pjesëmarrjes në borxhin e përgjithshëm të Kosovës.

Rekomandime

Borxhi publik në Kosovë karakterizohet kryesisht nga borxh i brendshëm dhe borxhi i jashtëm. Deficitit buxhetor konsiderohet ndër shkaqet kryesore, që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e borxhit publik, ngase deficitit buxhetor rregullisht financohet nga huamarrja.

- Vitet e fundit vërehet se rritja e borxhit të brendshëm ka qenë më e lartë se ajo e borxhit të jashtëm, nisur nga kjo duhet kushtuar vëmendje në vijueshmëri menaxhimit të borxhit publik.

- Politikë bërësit nuk duhet të reduktojnë shpenzimet qeveritare-Investimet publike, për të reduktuar deficitin buxhetor, por duhet përmes rritjes së kontrolleve sistematike dhe forcimit të autoriteteve tatimore të ndikohet në rritjen e inkasimit të të hyrave buxhetore nga tatimpaguesit.
- Mjetet e siguruar nga huamarrja e brendshme dhe huamarrja e jashtme duhet të vazhdojnë të orientohen kryesisht në investime publike.

Literatura

I. Literatura profesionale

1. Ahmet Manqellari, Sulo Haderi, Dhori Kule, Stefan Qirici, Hyrje në ekonomi, Tiranë 2007;
2. Brajshori, dr. Behxhet, Financat Publike, Prizren 2014;
3. Harver S. Rosen, Financa Publike, Përktheu: Manjolla Kalica, Gentiana Cane, albin Tiranë, 2003;
4. Jelqiq, Bozhidar, Shkencat mbi financat dhe e Drejta Financiare, enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i KSAK-së, Prishtinë 1985;
5. Kadriu, dr.Sabri, Financat publike, Prishtinë 2012;
6. Koka, dr. Mimoza, Makroekonomia, Tiranë 2014;
7. Komani, Dr.Sabahudin, Financat publike, Prishtinë, 2008
8. Limani, dr.Musa, Hyrje në ekonomi, Prishtinë 2002;
9. Limani, dr.Musa, Makroekonomia, Prishtinë 2013;
10. N.Gregory Mankiw dhe Mark P. Taylor, Makroekonomia, Përktheu: Artan Meci; Jorgji Qirjako, UET Press 2012;
11. Sharku. Gentiana, Leka. Brikena, Bajrami. Enklava, Financa, Tiranë 2013;
12. Tafa (Bungo), Genta, Shkencat mbi financa dhe e drejta financiare, Tiranë 2010.

II. Materialet e shfrytëzuara

1. Agjencia e Statistikave e Kosovës, Statistikat ekonomike, Bruto Produkti Vendor 2012-2022, Prishtinë 2022;
2. Banka Qendrore e Kosovës, Raporti i zhvillimeve makroekonomike, Numër 4, Prishtinë 2022;
3. Banka Qendrore e Kosovës, Rregullorja për tregun primar dhe sekondar të Letrave me vlerë, Prishtinë 2022;
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Borxhin Publik, Nr. 03/L – 175, Prishtinë, 2009;
5. Ministria e Financave, Programi i Borxhit Shtetëror 2014-2022, Prishtinë 2022;
6. Ministria e Financave, Programi i borxhit shtetëror 2016-2019, Prishtinë 2019;
7. Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Buletini vjetore 2022, Prishtinë 2022;
8. Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Të dhënat tre-mujore mbi borxhin e përgjithshëm, Prishtinë 2022;
9. Republika e Kosovës-Ministria e Financave, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2016-2018, Prishtinë 2022;
10. World Bank Group, Ballkani Perëndimor, Raport i Rregullt Ekonomik, Nr.11;
11. Ligji Nr.05/L-125, Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.

¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Borxhin Publik, Nr. 03/L – 175, neni 3, Prishtinë, 2009.

¹ Dr. Musa Limani, Makroekonomia, Prishtinë 2013, fq, 237.

¹ Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Strategjia vjetore e borxhit 2022, Prishtinë 2022, fq, 9.

¹ Ligjit Nr. 03/L – 175, Për borxhet publike në Republikën e Kosovës, Neni 30.

NDIKIMI I NDRYSHIMEVE TEKNOLOGJIKE NË EKONOMINË MODERNE

Msc. Gjovalin Deda- Universiteti, Luigj Gurakuqi, Shkoder

Msc. Dorian Deda-Universiteti, Luigj Gurakuqi, Shkoder

Abstract

The paper examines the relationship between technological change, economic growth, and economic development through structural analysis applied to the macroeconomic variable such as the PBB growth rate, related to the use of digital technologies. The results show an insignificant increase in the value of world PBB, which indicates the continuous positive processes of absorption of the mentioned technological changes. The creation of value through innovation in the economy as a whole is reflected in structural shifts, expressed through the main macroeconomic indicators. The growth of an economy is measured by the change in the volume of its output or the real income of its inhabitants. Aggregates are based on constant 2015 prices, expressed in US dollars. PBB accounts for all domestic production, regardless of whether the income accrues to domestic or foreign institutions. The World Bank re-estimates PBB and value added by industrial origin in a common reference year. Because the rescaling changes the implied weights used in forming regional aggregates and income groups, aggregate growth rates are not comparable to those from previous editions with different base years. To avoid distortions in growth rates, the discrepancy is left undistributed.

Abstrakti

Punimi shqyrton marrëdhëniet midis ndryshimit teknologjik, rritjes ekonomike dhe zhvillimit ekonomik përmes analizës strukturore të aplikuar për variablin makroekonomikë sic është norma e rritjes së PBB-së, e lidhur kjo me përdorimin e teknologjive dixhitale. Rezultatet tregojnë për një rritje të parëndësishme të vlerës së PBB-së botërore, gjë që tregon për proceset e vazhdueshme pozitive të përthithjes së ndryshimeve teknologjike të përmendura. Krijimi i vlerës nëpërmjet inovacionit në ekonominë në tërësi reflektohet në zhvendosje strukturore, të shprehura nëpërmjet treguesve kryesorë makroekonomikë. Rritja e një ekonomie matet nga ndryshimi në vëllimin e prodhimit të saj ose në të ardhurat reale të banorëve të saj. Agregatët bazohen në çmimet konstante të vitit 2015, të shprehura në dollarë amerikanë. PBB-ja përbën të gjithë prodhimin vendas, pavarësisht nëse të ardhurat u grumbullohen institucioneve vendase apo të huaja. Banka Botërore rivlerëson PBB-në dhe vlerën e shtuar sipas origjinës industriale në një vit të përbashkët referimi. Për shkak se rishkallëzimi ndryshon peshat e nënkuptuara të përdorura në formimin e agregateve rajonale dhe të grupeve të të ardhurave, ritmet e rritjes agregate nuk janë të krahasueshme me ato nga botimet e mëparshme me vite bazë të ndryshme. Për të shmangur shtrembërimet në ritmet e rritjes, mospërputhja lihet e pashpërndarë.

Hyrje

Fillimi i epokës dixhitale, i quajtur edhe epoka e informacionit, lidhet me dinamikën e arritjeve novatore në fushën e teknologjive dixhitale, pasi përcakton fushën e njohurive shkencore ose teknike që lidhen me krijimin dhe përdorimin e pajisje dixhitale ose të kompjuterizuara. Ky term i referohet periudhës historike në fillim të shekullit të 21-të, e cila karakterizohet nga një tranzicion i shpejtë drejt një ekonomie të bazuar në përdorimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, aktivitetet e së cilës kontribuojnë në rritjen e paprecedentë të dijës dhe përhapjen e saj brenda organizatave, ndërmjet individëve dhe strukturave shoqërore, si rezultat i të cilave mbulohen pothuajse të gjitha fushat e veprimtarisë ekonomike dhe shoqërore.

Deri më sot, janë shkruar një numër i madh punimesh që marrin në konsideratë ndikimin e teknologjisë së informacionit në operacionet e biznesit, aktivitetin ekonomik, si dhe në krijimin e një hapësire tjetër interaktive, e karakterizuar nga shfaqja e tregjeve të reja globale, modeleve inovative të biznesit dhe shumëllojshmërisë së gjerë të konsumatorëve. Nga pikëpamja teorike ndikimi i teknologjisë në ekonomi vihet re, kryesisht, në modelin e kauzalitetit kumulativ nga Nicholas Kaldor³⁵, i cili merr parasysh një marrëdhënie pozitive midis PKB (produktit kombëtar bruto) dhe rritjes së prodhimit. Ai shprehet se industrializimi përshpejton ritmin e ndryshimeve teknologjike në të gjithë ekonominë, gjë që sugjeron rëndësinë e inovacionit për rritjen ekonomike. Në fillim të shekullit të 21-të, besimi tradicional në mundësinë e përparimit shkencor dhe teknologjik, mund të shkaktohet nga risitë që lidhen me ardhjen e teknologjive dixhitale. Ndikimi i tyre kryesor në aktivitetin ekonomik çon në modelin e ekonomisë së re, si ekonomia e internetit ose ekonomia dixhitale. Shumëllojshmëria e përkufizimeve që gjenden në botimet për këtë çështje, tregon shfaqjen e një konstruksioni të ri teorik, interpretimin e pranuar përgjithësisht e cila i referohet - përdorimit të një lidhjeje interneti - për të gjitha veprimet ekonomike, proceset dhe transaksionet e kryera në bazë të teknologjive dixhitale. Programe si iniciativa e MIT³⁶ për ekonominë dixhitale janë pika specifike studimi se si transformimet dixhitale ndikojnë në tregje.³⁷ Skenari standard mbulon një periudhë kohore të karakterizuar nga ndryshime vërtet dramatike në mjetet e konkurrencës, krijimi i tregjeve jomateriale, flukset masive të klientëve të padukshëm në shkallë globale, mungesa e kufizimeve kohore dhe dominimi i përpunimit elektronik të informacionit. Në fushën e ekonomisë dixhitale, konceptet e hapësirës, kohës, territorit dhe prekshmërisë po transformohen nga paradigma ekonomike që pasqyrojnë transaksionet fizike dhe paraqitjet materiale, në operacione globale 7/24, mjedise jomateriale të shekullit të 21-të, të cilat barten jashtë, përmes infrastrukturës mbarëbotërore të teknologjive dixhitale. Ai fokusohet në gjenerimin e të dhënave, të cilat kontribuojnë në shfaqjen e një matjeje të zgjeruar të treguesve makroekonomikë.

³⁵ Kaldor Nicholas (1908-1986), ekonomist neokejnesian anglez. *Economic Growth and the Problem of Inflation*, 1959, Economica.

³⁶ Massachusetts Institute of Technology

³⁷ [Digital Economy. Techopedia - *ëëë.techopedia.com/definition/32989/digital-economy*](https://www.techopedia.com/definition/32989/digital-economy)

Mbështetja teorike

Dixhitalizimi sjell më tej në fokus faktin se PBB (prodhimi i brendshëm bruto) është një matës i prodhimit dhe jo një masë e mirëqenies ose e tepicës së konsumatorit, kjo përforcon nevojën për të plotësuar PBB-në me tregues të tjerë që kapin mirëqenien. Në përputhje me këtë konsideratë, qasja teorike e kësaj analize bazohet në marrjen parasysh të ndikimit të teknologjive inovative si një burim konkurrues i kompanive. Krijimi i vlerës nëpërmjet inovacionit në ekonominë në tërësi reflektohet në zhvendosje strukturore, të shprehura nëpërmjet treguesve kryesorë makroekonomikë. Dihet se PBB-ja, treguesi më i përgjithshëm i efikasitetit të ekonomisë, është po aq i rëndësishëm dhe treguesit e arritur nga kompanitë në tregjet e brendshme dhe botërore.

Krijimi i një sistemi të ri teknologjik në shekullin XXI solli sfida të ndryshme me të cilat përballet shoqëria globale si: përshkallëzimi i luftërave tregtare, fleksibiliteti financiar, proceset e shpërbërjes në Evropë, kriza e migracionit, militarizimi i ekonomive, ngrohja globale - këto dhe shumë probleme të tjera kanë dëmtuar jetën e qëndrueshme të qenieve njerëzore.

Çfarë do të ishte më e kotë se përpjekjet e përqendruara në përmirësimin e sistemit politiko-ekonomik të vjetëruar dhe të keqfunksionuar?

Le të kujtojmë këtu deklaratën e Simon Kuznets³⁸, të cilën ai e bëri në leksionin e tij Nobel në vitin 1971: "... kursi në ndryshim i historisë ekonomike mund të ndahet ndoshta në epokë ekonomike, secila e identifikuar nga inovacioni epokal me karakteristikat dalluese të rritjes që ajo gjeneron. Inovacionet globale dhe transformimi global i ekonomisë kërkon njohuri të reja, mendësi të reja dhe individë të rinj, duke ndjekur risitë në vendimmarrje teorike dhe praktike.

Le të bëjmë disa vështrime paraprake, të cilat me siguri do të pasqyrohen në hetimet e mëtejshme. Së pari, evolucioni i përgjithshëm çon në një zëvendësim gradual të mënyrës së prodhimit intensiv dhe kapitalit, përkatësisht me kursim të punës dhe kapitalit. Në këtë drejtim, çdo vendim që kërkon punë intensive apo investim intensiv në ekonomi duhet të trajtohet si në kundërshtim me trendin dhe perspektivën e përgjithshme.

Së dyti, karakteristika tjetër vendimtarje e teknologjive të ardhshme kyçe për rifillimin e rritjes ekonomike rrjedh nga shkurtimi i ciklit jetësor të teknologjisë. Rritja e shpejtësisë me të cilën teknologjitë e reja po zëvendësojnë ato tashmë të aplikuara, duke kërkuar bashkëpunim të ngushtë (ndërveprim ballë për ballë) midis shkencëtarëve nga fusha të ndryshme të dijes (ndërveprimi ndërdisiplinor), kompanive të vogla dhe të mesme të inovacionit, administratës lokale, institucioneve financiare, universiteteve dhe "aktorëve të tjerë të inovacionit". Fleksibiliteti më i lartë i kompanive të vogla dhe të mesme në përputhje me shpejtësinë në rritje të ndryshimeve teknologjike i bën ato kompani një shtytës të ri teknologjik, duke zëvendësuar kompanitë e mëdha në atë mision. "Ekonomia e shtrirjes" kur prodhimi i produkteve teknologjikisht unike dominon mbi shfrytëzimin e teknologjive të dhëna brenda paradigmes së "ekonomisë së shkallës", nënkupton shfaqjen e një faze të re në zhvillimin teknologjik.

³⁸ "Economic Growth of Nations: Total Output and Production Structure". (1971)

Së treti, ndikimi i teknologjive dixhitale në aktivitetin ekonomik, në përputhje me supozimin se dinamika e inovacionit reflektohet në përshpejtimin e ciklit jetësor të mallrave dhe teknologjive dhe në përgjithësi në reduktimin e tij. Përhapja e inovacioneve kryhet midis njësive të biznesit. Në këtë fushë, është e nevojshme të theksohet studimi i kontributit të E.Penrose³⁹, i cili zhvilloi teorinë e rritjes së kompanisë. Ai rrjedh nga fakti se një kompani është një organizatë sipërmarrëse që ka burime prodhuese, qoftë në formën e aktiveve të prekshme, si një fabrikë, pajisje, tokë, minerale dhe lëndë të para, stoqe, mbetje dhe nënprodukte, si dhe në formën e burimeve të punës. Në bazë të kësaj teorie koncepti i burimeve të shoqërisë merr një kuptim të veçantë, ai përfshin, përveç aseteve, edhe njohuritë e zhvilluara, informacionin, proceset organizative, atributet e kompanisë etj. dhe kombinimet e tyre të propozuara dhe të kontrolluara nga kompania për të përmirësuar efikasitetin dhe përfitimin.

Metodologjia

Nga pikëpamja metodologjike, ecuria e veprimit të ndërmarrë për të kryer një studim që synon studimin e formës së ekonomisë në fillim të epokës dixhitale dhe evulimin e tij, qëndron në mbledhjen e të dhënave sekondare sic është literarura të ndryshme në lidhje me ekonomine modern dhe digjitalizimin e saj, si dhe organizimi i të dhënave, zgjedhja e llojit të grafikut, analiza dhe interpretimi i grafikut. Përsa i përket modelit konceptual metodologjik, qasja bazë bazohet në një studim që synon studimin e komponentëve të ndryshëm që të njohim marrëdhëniet midis tyre ekonomise dhe teknologjisë, si dhe të përcaktojmë madhësinë e secilit prej tyre. Zbatimi i kësaj metode lejon integrimin e një spektri të gjerë teorish në një model relational - një kornizë teorike, e cila jep një paraqitje vizuale të marrëdhënieve midis shumë teorive përbërëse. Hapi tjetër lidhet me përzgjedhjen e një metode analize që do të lejojë interpretimin e përbërësve sasiorë që përmbahen në treguesit dhe parametrat ekonomikë.

Ndikimi i dixhitalizimit në ekonomi

Dihet se PBB-ja, treguesi më i përgjithshëm i efikasitetit të ekonomisë, është po aq i rëndësishëm dhe treguesit e arritur nga kompanitë në tregjet e brendshme dhe botërore. Dixhitalizimi sjell më tej në fokus faktin se PBB është një matës i prodhimit dhe jo një masë e mirëqenies ose e tepricës së konsumatorit, kjo përforcon nevojën për të plotësuar PBB-në me tregues të tjerë që kapin mirëqenien. Rishikimi i vlerës totale të PBB-së së Shqipërisë, të përzgjedhur për këtë studim pasqyron, siç tregohet në teorinë makroekonomike të përmendura, skenarin ekonomik për shfaqjen, funksionimin dhe zhvillimin e inovacioneve. Është e nevojshme të përcaktohet se çfarë nënkuptohet me ekonomi dixhitale në diskursin aktual shkencor, si ka evoluar ky koncept deri më sot dhe si lidhet me realitetin ekonomik. Përkufizimi aktual i ekonomi digjitale ⁴⁰përfshin tre nivele (Fig. 1):

³⁹ *The Growth of the Firm —A Case Study: 1960*

⁴⁰ Digital Economy. Techopedia - www.techopedia.com/definition/32989/digital-economy




Figura 1 Tre nivelet e ekonomisë digjitale⁴¹

Niveli i parë është infrastruktura bazike e TIK, e thënë ndryshe bërthama e “ekonomisë digjitale” që i referohet përkufizimit të sektorit për prodhimin e produkteve elektronike dhe ofrimin e shërbimeve të TIK⁴², i cili u prezantua në vitin 1998 nga OECD⁴³.

Niveli i dytë ka të bëjë me vetë ekonominë digjitale e cila mbulon, përveç sektorit dixhital, edhe ato sfera të veprimtarisë që nuk do të shfaqeshin ose nuk do të mund të ekzistonin pa përdorimin e teknologjive TIK.

Niveli i tretë është ekonomia e digjitale, ku përfshihen ato lloje të aktiviteteve ekonomike që kanë ekzistuar përpara përdorimit të gjerë të teknologjive TIK, por që po përdorin gjithnjë e më shumë të dhëna të dixhitalizuara në proceset organizative.

Krijimi i vlerës nëpërmjet inovacionit në ekonominë në tërësi reflektohet në zhvendosje strukturore, të shprehura nëpërmjet treguesve kryesorë makroekonomikë. Rritja e një ekonomie matet nga ndryshimi në vëllimin e prodhimit të saj ose në të ardhurat reale të banorëve të saj. Sistemi i Llogarive Kombëtare të Kombeve të Bashkuara i vitit 2008 (2008 SNA⁴⁴) ofron tre tregues të besueshëm për llogaritjen e rritjes: vëllimin e produktit të brendshëm bruto (PBB), të ardhurat e brendshme bruto reale dhe të ardhurat reale bruto kombëtare. Vëllimi i PBB-së është shuma e vlerës së shtuar, e matur me çmime konstante, nga familjet, qeveria dhe industritë që operojnë në ekonomi. Agregatët bazohen në çmimet konstante të vitit 2015, të shprehura në dollarë amerikanë. PBB-ja përbën të gjithë prodhimin vendas, pavarësisht nëse të ardhurat u grumbullohen institucioneve vendase apo të huaja. Normat e rritjes së PBB-së dhe përbërësve të saj janë llogaritur duke përdorur metodën e katrorëve më të vegjël dhe të dhënat konstante të çmimeve në monedhën vendase. Çmimet konstante në seritë e dollarit amerikan përdoren për të llogaritur normat e rritjes rajonale dhe të grupit të të ardhurave. Seritë e monedhës vendase konvertohen në dollarë amerikanë konstante duke

⁴¹ According to the classification adopted by United Nations Conference on Trade and Development

⁴² Teknologjia e informacionit dhe komunikimit

⁴³ The Organization for Economic Cooperation and Development

⁴⁴ System of National Accounts

përdorur një kurs këmbimi në vitin e përbashkët referues. Siç pasqyrohet dhe tek grafiku i vendit tonë, Shqipërisë, po zbatohen reforma të rëndësishme strukturore që do të mbështesin rritjen e barabartë, të cilat do të rrisin produktivitetin dhe konkurrencën në ekonomi, dhe do të krijojnë më shumë vende pune dhe do të përmirësojnë qeverisjen dhe ofrimin e shërbimeve publike. Lidhja dhe aksesimi i përmirësuar rajonal në tregjet rajonale dhe globale, së bashku me eksportin dhe diversifikimin e tregut, mund të ndihmojnë gjithashtu në nxitjen e rritjes më të shpejtë. Për të marrë seri të krahasueshme të të dhënave të çmimeve konstante për llogaritjen e agregatëve, Banka Botërore rivlerëson PBB-në dhe vlerën e shtuar sipas origjinës industriale në një vit të përbashkët referimi. Për shkak se rishkallëzimi ndryshon peshat e nënkuptuara të përdorura në formimin e agregateve rajonale dhe të grupeve të të ardhurave, ritmet e rritjes agregate nuk janë të krahasueshme me ato nga botimet e mëparshme me vite bazë të ndryshme. Rishkallëzimi mund të rezultojë në një mospërputhje midis PBB-së së rishkallëzuar dhe shumës së komponentëve të rishkallëzuar. Për të shmangur shtrembërimet në ritmet e rritjes, mospërputhja lihet e pashpërndarë. Si rezultat, mesatarja e ponderuar e ritmeve të rritjes së komponentëve në përgjithësi nuk është e barabartë me normën e rritjes së PBB-së.




Figura 2: Norma e rritjes së PBB⁴⁵

Ashtu siç mund të lexohet qartë dhe nga të dhënat e pasqyruara në World Bank për normën e rritjes së PBB për vitet e fundit rezultojnë se kemi luhata të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe 5(pesë)vjecare e shoqëruar me problemet e pandemisë, tërmetit, krizës së çmimeve etj.

Norma e rritjes e PBB-së së Shqipërisë-së për vitin 2016 ishte 3.31%, e cila rezultojnë një rritje prej 1.09 % krahasuar me vitin 2015.

Norma e rritjes e PBB-së së Shqipërisë-së për vitin 2017 ishte 3.80%, cila rezultojnë një rritje prej 0.49 % nga viti 2016.

Norma e rritjes e PBB-së së Shqipërisë-së për vitin 2018 ishte 4.02%, cila rezultojnë një rritje prej 0.22 % nga viti 2017.

Norma e rritjes e PBB-së së Shqipërisë-së për vitin 2019 ishte 2.09%, cila rezultojnë një rënie prej 1.93 % nga viti 2018.

⁴⁵ <https://data.worldbank.org/indicator>

Norma e rritjes e PBB-së së Shqipërisë-së për vitin 2020 ishte -3.48%, cila rezulton një rënie prej 5.57 % nga viti 2019.

Norma e rritjes e PBB-së së Shqipërisë-së për vitin 2021 ishte 8.52%, cila rezulton një rritje prej 12 % nga viti 2020. Gjithashtu kjo rritje e PBB nga viti 2020 në vitin 2021 tregon se ekonomia përjetoi një rikthim të fortë, duke u rikuperua nga problemet e pandemisë dhe rigjallërimin e udhëtimeve, ndërtimit dhe industrisë nxjerrëse. Investimet private, konsumi dhe shpenzimet publike nxitën rritjen, ndërsa borxhi publik mbeti i lartë. Pasi i përballoi mirë pasojat e tërmetit, pandemisë dhe krizës së çmimeve, fokusi do të jetë një rimëkëmbjen e plotë me vëmendje të veçantë në turizmin, bujqësinë dhe dixhitalizimin. Por rritja e inflacionit dhe lufta në Ukrainë kërcënojnë perspektivat ekonomike dhe të varfërisë në vitin 2022.

Konkluzione

Fillimi i epokës dixhitale, i quajtur edhe epoka e informacionit, lidhet me dinamikën e arritjeve novatore në fushën e teknologjive dixhitale, pasi përcakton fushën e njohurive shkencore ose teknike që lidhen me krijimin dhe përdorimin e pajisje dixhitale ose të kompjuterizuara.

Krijimi i një sistemi të ri teknologjik në shekullin XXI solli sfida të ndryshme me të cilat përballlet shoqëria globale si: përshkallëzimi i luftërave tregtare, fleksibiliteti financiar, proceset e shpërbërjes në Evropë, kriza e migracionit, militarizimi i ekonomive, ngrohja globale - këto dhe shumë probleme të tjera kanë dëmtuar jetën e qëndrueshme të qenieve njerëzore.

Dixhitalizimi sjell më tej në fokus faktin se PBB është një matës i prodhimit dhe jo një masë e mirëqenies ose e tepicës së konsumatorit, kjo përforcon nevojën për të plotësuar PBB-në me tregues të tjerë që kapin mirëqenien.

Për shkak të rishkallëzimit, mund të rezultojë një mospërputhje midis PBB-së së rishkallëzuar dhe shumës së komponentëve të rishkallëzuar. Për të shmangur shtrembërimet në ritmet e rritjes, mospërputhja lihet e pashpërndarë.

Norma e rritjes e PBB-së së Shqipërisë-së për vitin 2021 ishte 8.52%, cila rezulton një rritje prej 12 % nga viti 2020. Kjo rritje e PBB tregon se ekonomia përjetoi një rikthim të fortë, duke u rikuperua nga problemet e pandemisë dhe rigjallërimin e udhëtimeve, ndërtimit dhe industrisë nxjerrëse. Investimet private, konsumi dhe shpenzimet publike nxitën rritjen, ndërsa borxhi publik mbeti i lartë.

Biblografia dhe referenca

- ✓ Kaldor Nicholas (1908-1986), Economic Growth and the Problem of Inflation, 1959
- ✓ "Economic Growth of Nations: Total Output and Production Structure". (1971)
- ✓ Schumpeter, J.A. (1912). The Theory of Economic Development.
- ✓ The World Bank. World Development IndicatorsGrimm, B. T., and R. P. Parker, 1998. "Reliability of the Quarterly and Annual Estimates of GDP and Gross Domestic Income," Survey of Current Business
- ✓ OECD (2015). OECD Digital Economy Outlook. OECD Publishing, Paris
- ✓ Massachusetts Institute of Technology
- ✓ The Growth of the Firm —A Case Study: 1960
- ✓ Teknologjia e informacionit dhe komunikimit
- ✓ The Organization for Economic Cooperation and Development
- ✓ System of National Accounts
- ✓ data.worldbank.org/indicator

DIALOGU KULTUROR FETAR DHE KOMUNIKIMI MEDIAL

Prof. As. Dr. Rexhep Suma-Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë

Abstract

The mutual relationships between media, culture, religion, and society in general have never been as perceptible as they became after the emergence of television, especially after the fall of the Soviet system. The influences between media (both new and old) and the nature of social relations, the way in which society defines itself as an organic unit (Gemeinschaft or Corporation) or as a Society (Gesellschaft or Partnership), have never been so clear.

This contrast, according to Michel Terestchenko (Philosophie Politique, 1994), reflects the same relationship that exists between the vision of the ancient city or the "beautiful harmony" of the Greeks according to Hegel, and the individualistic vision of modern societies. Whether electronic or print media, in democratic societies, play the most crucial role in providing accurate and reliable information to society. At least that should be the role and importance of the existence of media as the fourth power, alongside the legislative, executive, and judicial powers. Behind every editorial and informational policy, there are powerful circles, clans, and oligarchs who have extraordinary influence in shaping and communicating information to the wider public of a country or even beyond.

Keywords

Culture, communication, diversity, harmony, intercultural dialogue.

Abstrakt

Marrëdhëniet e ndërsjella mes medieve, kulturës, fesë dhe shoqërisë në përgjithësi nuk kanë qenë asnjëherë aq të perceptueshme sa u bënë pas shfaqjes së televizionit dhe sidomos pas rënies së sistemit sovjetik. Asnjëherë ndikimet e ndërsjella mes medieve (të reja e të vjetra) dhe natyrës së lidhjeve shoqërore, mënyrës sipas së cilës shoqëria përcakton vetveten si njësi organike (Gemeinschaft ose Corporate), ose si Societas (Gesellschaft ose Partnership) nuk kishin qenë kaq të qarta.

Kjo kundërvënie, sipas Michel Terestchenko-s (Philosophie Politique, 1994) reflekton të njëjtën marrëdhënie që ekziston mes vizionit të qytetit antik ose "harmonisë së bukur" greke sipas Hegelit dhe vizionit individualist të shoqërive moderne. Mediet qoftë ato elektronike apo të shtypit në shoqërinë demokratike luajnë rolin më crucial të informimit të drejt dhe të saktë të shoqërisë. Së paku kështu duhet të ishte roli dhe rëndësia e ekzistimit të medieve si formë e pushtetit të katërt, krahas atij legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësorë. Pas çdo politike redaktuese gazetareske dhe informative, qëndrojnë qarqe, klane, oligark të fuqishëm që kanë influencë të jashtëzakonshme në sajimin dhe komunikimin e një informacioni për publikun e gjerë të një vendi apo edhe më gjerë.

Fjalë kyçe: kulturë, komunikim, diversitet, harmoni, dialog ndërkulturor

Hyrje

Përmbajtja e kulturës së një populli nuk mund të kuptohet jashtë fesë ose feve që ai beson, jashtë ndikimeve të tyre në mënyrën e të menduarit, të veshjes dhe të sjelljes. Një nga sociologët më të shquar në fushën e sociologjisë së fesë, E. Durkheim ka shkruar: “Feja nuk është vetëm një sistem praktikash; është edhe një sistem idesh, synimi i të cilit është të shprehë botën. Lidhur mbi impaktin e fesë në jetën tonë të përditshme qartësohet edhe nga një studim interesant që është zhvilluar në Shqipëri ku shpjegohet se 34.53% e nxënësve (të dyja besimeve-mysliman dhe krishterë) frekuentojnë rregullisht institucionet fetare, kurse 40.04% e tyre frekuentojnë vetëm në ditë festash fetare, ndërkaj 16.12% e tyre rrallë, kurse vetëm 9.31% asnjëherë nuk vizitojnë objektet dhe institucionet fetare (xhamitë apo kishat).⁴⁶

Nga ana tjetër, një nga sociologët më të shquar në shkencat e komunikimit MacLuhan ka shkruar se nëpërmjet rrjetit të dendur të medie, veçanërisht të televizionit, bota e sotme është zvogëluar mjaft. Informacioni qarkullon shpejt si figurë, si zë dhe si shkronjë në të katër anët e botës dhe për një kohë shumë të shkurtër. Gati të gjithë njerëzit kanë të njëjtin informacion, të njëjtat stereotipa mediatike, për të mos thënë të njëjta reagime ndaj jetës.

Varshmëria e njeriut modern nga mjetet e komunikimit masiv në shoqëritë demokratike, po edhe në të tjerat është rritur deri në përmasa kritike. Shpeshherë njeriu nuk është i aftë të mendojë dhe të veprojë pa sugjerimin e mas-medies: ekzistenca e tij varet nga ato urdhëresa elementare, kështu që futja e çfarëdo dykuptimësie të vetëdijshme, e çfarëdo sugjerimi për anulimin e vendimit për një kohë të pacaktuar të introspektimit dhe analizës, do të kishte pasoja katastrofike. “Për të qenë më e plotë fotografia e mjerimit të njeriut modern, fotografia që sugjerojnë potencialet “apokaliptike” të mas medie, kësaj që u theksua i duhet shtuar edhe fakti se mas mediet kushtëzojnë jo vetëm strukturën e tij psikike, po edhe sjelljen e tij fizike.”⁴⁷

Në fillim të vitit 2000, një dhjetëvjeçar pas rënies së Murit të Berlinit dhe shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, dukej se globalizimi i ekonomisë dhe revolucionit numerik po përruronin një erë të re. Shumëfishimi i këmbimeve ndërkombëtare ishte tregues i kalimit nga një ekonomi shumëkombëshe në një ekonomi botërore apo “globale”. Nën ndikimin e “konvergjencës” së rrjeteve, mediet e kanë shoqëruar këtë globalizim, fillimisht duke marrë pjesë vetë në të, pastaj duke përshpejtuar rrjedhën, sidomos nëpërmjet flukseve të informacionit dhe flukseve financiare.

Në prill të vitit 2000, shpërthen fluska financiare rreth vlerave të internetit, duke tërhequr me vete në rënien e tyre pjesën më të madhe të vlerave TMT (Teknologji-Media-Telekomunikacione); premtimet nuk ishin mbajtur dhe filizat e rinj po zbulonin ligjet e zakonshme të ekonomisë së tregut dhe të konkurrencës. Pse paralajmërimi i prillit të 2000 nuk prodhoi efektin e një njoftimi? Sepse globalizimi i njëkohshëm i tregjeve dhe medie para 11 shtatorit të 2001 nuk kishte vënë ende sado pak në dyshim këto figura të të ardhmes nën kujdesin e të cilave kishte lindur shekulli XXI, disa vite më përpara se në kalendar: shoqëria e informacionit, ekonomia e re dhe “fundi i historisë”.

Iluzionet humbura dhe ëndrrat e thyera të shekullit paraprirës arrijnë ende të fshehin që revolucionin numerik, sipas shumë shenjave, s’është veçse në belbëzimet e tij të para. Të lindur me internetin, Google, Yahoo dhe e-bay u nënshtrohen ligjeve të hekurta të ekonomisë së tregut. Betejat për përmbajtjet dhe për standardet, më të ashpra se kurrë, u hapin rrugën produkteve apo shërbimeve të reja, ndërkohë që e drejta për konkurrencë rreket të afirmohet në shkallë rajonale dhe botërore. E shqyer ndërmjet ndarjeve të veta dhe ëndrrës së saj për unitet, bota më e padeshifrueshme se kurrë, pre e diktaturave dhe terrorizmit, nuk pret më nga teknika apo ekonomia, por vetëm nga urtësia e politikanëve, që këta të pajtojnë kërkesat e kulturave të veçanta, rajonale, etnike apo fetare, me ato të universalizmit të të drejtave të shenjta dhe të patjetërsueshme të qenies njerëzore.⁴⁸

Deri më sot në historinë e njerëzimit janë themeluar me dhjetëra qytetërime dhe kultura të mëdha, të cilat në themelin e tyre kishin tekste të shenjta sikurse janë: Vedat, Upanishadët, Bibla dhe Kur’ani.

⁴⁶ Artan Fuga, Zyhdi Dervishi, *Ndërmjet fshatit dhe qytetërimit global*, Dudaj, Tiranë, 2010, f.202.

⁴⁷ Dr. Ismail Bardhi, “*Karikatura e Karikaturës*”, Dituria Islame, mars. nr. 20. Prishtinë, 2006, f.13.

⁴⁸ Francis Balle, *Mediat & shoqëritë*, përkthim grup autorësh, bot. 15 botimet Papyrus, Tiranë, 2011, f.441.

Marrë në përgjithësi ato ishin qytetërime edukatore të njeriut që i mësuan njeriut përgjegjësinë apo thënë ndryshe, disa qytetërime i krijoi njeriu i mendjes së përgjegjshme. Në ato qytetërime kishte kode të përgjegjësisë së shumanshme, të përkthyer në gjuhën e thjeshtë, mund të shprehen me një formulë thelbësore: njeriu është përgjegjës para Zotit, para natyrës, para njerëzimit, para vetvetes...Papjekuria fetare, siç thoshte Kant-i (1724-1805) është jo vetëm më e dëmshme, por edhe më e pandershme nga të gjitha. Të dëmshëm dhe të pandershëm janë edhe ata që dinë pak për fe e pak për shkencë e grinden. Millikan-i (1868-1953), fitues i çmimit nobel për fizikë, për këtë, thoshte: "Kur të grinden njerëzit që dinë pak për fenë dhe ata që dinë pak për shkencën, ndokush mund të mendojë se aty ka vend mosmarrëveshja ndërmjet fesë dhe shkencës, ndërsa aty kanë vend, në të vërtetë, dy lloj injorancash"

As shkenca s'mund të strehohet te religjioni, as qytetërimi të kthehet te familja klasike.

Brenda qytetërimit, pa dalë nga ai, nuk shihen kurrfarë forcash që do t'u kundërvihen të gjitha këtyre dukurive. Për më tepër, në shkallën e vlerave që qytetërimi njih, nuk gjendet asnjë argument për t'u theksuar kundër /të këqijave që i shkaktoi shkenca e papërgjegjshme dhe të tjerat nga kriza e moralit, sikurse janë/ vërshimi i shundit, pornografisë, alkoolit, etj. Kjo është po ajo ndjenjë e pafuqisë dhe rezignimit që ndihet në qëndrimin e kriminologëve amerikanë para ardhjes së baticës së kriminalitetit. Në të vërtetë, kjo është pafuqia e shkencës kundër ligësive, të cilat përveç dimensionit shoqëror kanë edhe atë moral.

Brenda civilizimit, pa dalë nga ai, nuk shihen kurrfarë forcash që do t'u kundërvihen të gjitha këtyre dukurive. Për më tepër, në shkallën e vlerave që civilizimi njih, nuk gjendet asnjë argument për t'u theksuar kundër vërshimit të shundit, pornografisë, alkoolit. Kjo është po ajo ndjenjë e pafuqisë dhe e rezignimit që ndihet në qëndrimin e kriminologëve amerikanë para ardhjes së baticës së kriminalitetit. Në të vërtetë, kjo është pafuqia e shkencës kundër ligësive, të cilat përveç dimensionit shoqëror kanë edhe atë moral. Mohimi i civilizimit s'është i mundshëm nga vetë ai, por nga jashtë, pra nga kultura. Edukata religjioze-etike dhe familja paraqesin sheshazi shtegdalje. Mirëpo, as shkenca s'mund të strehohet te religjioni, as civilizimi të kthehet te familja klasike. Nga aspekti i civilizimit, rrethi është mbyllur.⁴⁹

Koncepti perëndimor për prerje të thuktë mes të shenjtës dhe shekullares është një rezultat i një procesi të gjatë historik, është produkt i pushtetit dhe kundërtive lidhur me ngjashmërinë e autoritetit. Luftërat e reformacionit janë pasqyruar si në besnikërinë proto-nacionale, ashtu edhe në qëllimet fetare (Riis, 1998b). Ne s'duhet ta nënvlefësojmë edhe ndikimin e fuqisë së pandershme dhe mbizotërimit në krijimin e këtyre kufijve. Zhvillimi i hershëm modern i kulturave kombëtare evropiane ka qenë i lidhur fort me identitetet fetare të njerëzve. Këtë lidhje mund ta ilustrojmë mendëthurjen e identitetit luterian me atë suedez, të identitetit katolik me atë irlandez, të identitetit anglikan me atë anglez. Ndonëse në dekadat e fundit shtetet kombëtare e patën eliminuar përcaktimin "e shtetit" ose "të kishës bazë, supozime të shumta të mishëruara thellë në fetë kombëtare kanë mbetur në kuadër të ligjit, të politikës publike (siç janë të ardhurat vjetore prej taksve), në mbarështrimet institucionale (si ato në shkolla) si dhe në të kuptuarit e natyrës së autoritetit "shekullar"⁵⁰ Mediet e hapura dhe të pavarura kanë rëndësi të veçantë në çdo shoqëri demokratike. Rëndësia e informatave dhe qasshmërisë së tyre për audiencën e gjerë është parakusht jetësor për të drejtat e lirisë së shprehjes dhe pjesëmarrjes politike.⁵¹ Respektimi i të drejtës fetare është e garantuar me ligj, "Nëse jeni pjesëtar i një komuniteti në Kosovë, ju keni të drejta kushtetuese për ta shprehur, mbajtur dhe zhvilluar më tej kulturën dhe traditat tuaja. Ju gjithashtu keni të drejtë të administroni zhvillimet tuaja kulturore"⁵²

Noam Chomsky vazhdimisht vë në dukje një përfundim të thjeshtë: nuk ka nevojë për asnjë zbulim komploti për të analizuar devijimet e medias në vendet perëndimore. Një grusht njerëzish dhe korporatash që sot kanë në pronësi shumicën e organeve të medias, i fituan firmat e tyre duke mbështetur hapur elitat politike në vendet ku veprojnë mediet e tyre.

⁴⁹ Alija Izetbegović, Islami ndërmjet lindjes dhe perëndimit, Logos-A, Shkup, f.69.

⁵⁰ Meredith B. McGuire, Religion: *The Social Context (Religjioni: konteksti shoqëror)*, përktheu nga anglishtja dr. Ali Pajaziti, Logos-A, 2007, Shkup, f. 476.

⁵¹ www.ecmikoso.org

⁵² (Kushtetuta, Neni 59.1; Ligji për Komunitetet, Neni 5.1.

Vite më parë, kur Chomsky-n e pyetën se si e kontrollonin elitat e korporatave medien, ai u përgjigj: “Kjo është njësoj si të pyesësh se si elitat e korporatave kontrollojnë General Motors. Ata nuk kanë nevojë ta kontrollojnë atë. Ajo është pronë e tyre.”⁵³

Studimet analitike kulturore përkritazi me rolin medieve tashmë është bërë paradigmë dominante në hulumtimet e komunikimit. Hulumtimet kulturore shkencore vë në spikamë njohjen e rëndësisë e ashtuquajturës “kërkime administrative” që zakonisht përdoren për të ditur shkallën dhe efektin programeve, por pajtohen që efektet kuantitative e hulumtimeve vërtet nuk ofron përgjigje mbi pyetjen qenësore për mediet fetare. Studimet kulturore koncentrohen mbi atë se individ në grup përdorin medien për të ndërtuar botëkuptime fetare në jetën e tyre dhe së dyti sa këto botëkuptime fetare ndërlidhen me shumë aspekte të ndryshme jetësore. Deri në vitet e 70-ta i gjithë koncepti fetar i programeve dhe shkrimeve ndërlidhej me efektin e audiencës që kishte si rezultat apo impresionizmin se çka ndonjë mund të bëjë për ceremoninë e së dielës dhe që të angazhohej që sa më shumë të konvertoj njerëz. Por gradualisht studimet u largoheshin “efekteve” të këtyre pyetjeve duke u orientuar kah se sa audienca është e gatshme të krijoj opinion nga mediet etj.

Por nga ana tjetër antagonizmi karshi islamit gjithmonë ka qenë e ngulitur në Evropë që nga koha e kryqëzatave. Por kjo ishte në kufij të largët nga distanca gjeografike. Por bazuar në realitetin e sotshëm kur kemi një numër të madh emigrantësh si dhe shumë evropianëve por edhe amerikane që po e përqafojnë islamin, për fat të keq ka edhe aso zëra që kjo shoqëri të ndjek rrugën e konfrontimit me myslimanët.

Për fat të keq mediet në perëndim në këtë drejtim kanë luajtur një rol shumë destruktiv në afrimin e feve dhe besimeve për të jetuar në paqe dhe harmoni fetare, bile kanë kontribuar në mbjelljen e armiqësive duke paraqitur stereotipe për myslimanët se . ata janë fundamentalist e edhe terroristë. Psh pas 26 janarit 1995 kur ndodhi shpërthimi në Qendrën Tregtare Botërore, mediet në mënyrë gjeneralë portretizuan myslimanët amerikan si shkak i katastrofës. Pra, ishte një gabim qoftë me dije apo pa dije dhe mediet morën rolin e gjykatësit duke i fajësuar dhe i shpallur fajtorë të gjithë myslimanët amerikan.

Ka shumë pikëpamje të përbashkëta që obligojnë të gjitha religjionet, që ndonëse me botëkuptime të ndryshme, të gjenden në të njëjtën detyrë sepse ato lidhen nga premisa të ngjashme morale dhe horizonte të ngjashme shpirtërore.⁵⁴ Si do që të jetë në raportet e medieve hasim shpesh herë fjalën fundamentalist. Në sinonim të fjalës ekstremist dhe kjo është gabim i pafalshëm që bëhet nga mediet pasi që në realitet islami e ka ndaluar ekstremizmin rreptësisht. Pejgamberi a,s ka thënë, “Ata persona që kalojnë në ekstremitet (në praktikimin e fesë) ata janë të mallkuar (nga Zoti)”.Prej besimit që mbjell Islami tek myslimanët është edhe fakti se krahas Muhamedit a,s, ata i besojnë të gjithë të dërguarit pa kurrëfar dallimi dhe filluar që nga Ademi, Nuhu, Ibrahim Musa dhe Isa, por në Kuran më shumë përmendet Isa se sa Muhamedi a.s. Dhe ky fakt heshtet nga mediet të cilat janë të thirrura që të prezantojnë dhe të publikojnë të vërtetët mbi këto argumente e mos të fokusohen vetëm në propagandën e zezë kundër një feje e në këtë rast Islamit. Pra, nuk ka aspak ndërlidhje me portretizimin e islamit si fe dhe si realitet,kundër asaj që prezantohet në media, dhe paraqitet e tilla në opinion vetëm sa e forcojnë mitin dhe të pavërtetat që po shpifin për këtë fe.

Dhe plasimi i informacioneve të tilla vetëm sa nxit dhe rrit vëllimin e urrejtjes mes feve dhe popujve të ndryshëm.

Rruajtja e identiteteve

"Dialogu ndërkulturor, vetëm kontribuon drejt mirëkuptimit të faktit se pavarësisht veçantive tona, ndajmë vlera pozitive dhe ballafaqohemi me sfida të ngjashme"Para fundit të Dekadës së KB-së për dialog midis civilizimeve, dhe Dekadës për kulturën e paqes, në kushte kur procesi i globalizmit gjithsesi se na bashkon, me rëndësi esenciale është që të mos lejojmë që religjioni dhe kultura të shndërrohen në forca që çojnë drejt konflikteve dhe ndarjeve."Prej atje del edhe fuqia e madhe e liderëve të bashkësive fetare dhe të tjera që pozitivisht të ndikojnë për mirëkuptim dhe bashkëjetesë të ndërsjellë, si dhe të kontribuojnë në edukimin e të rinjve në këtë drejtim, posaçërisht në rajonet

⁵³ Pronësia e Medias dhe ndikimi i saj në pluralizmin dhe pavarësinë e medias, përkthim.edicion elektronik Botues: Instituti Shqipar i Medias, Tiranë,2004,f.1.

⁵⁴ www.horizonti.com

multikulturore dhe multikonfesionale, siç është rajoni i Evropës Juglindore", thotë drejtoresha përgjithshme e UNESCO-s Irina Bokova⁵⁵.

Meqë burimet ekonomike, teknologjike dhe financiare nuk janë të shpërndara në mënyrë të barabartë rreth botës, disa grupe etnike, kulturore dhe kombëtare përballen, me më shumë vështirësi në ruajtjen e identiteteve dhe traditave të tyre. Për rrjedhojë, për të kuptuar problemet rreth imperializmit kulturor, është e rëndësishme të analizojmë ndikimin e kulturës popullore amerikane. Nuk ka mënyra të lehta për të marrë ndikimin e kulturës popullore, por duhet të jemi në ndjeshëm ndaj ndikimeve të saj në komunikimin ndërkulturore.

Shumë grupe kulturore përreth botës shqetësohen rreth ndikimit të imperializmit kulturor. Qeveria e Kebekut, për shembull, është e shqetësuar për efektet e medieve në gjuhën angleze mbi gjuhën dhe kulturën franko-kanadeze. Francezët kanë shprehur gjithashtu shqetësim rreth dominimit të kulturës popullore të SHBA-së dhe ndikimit të saj në shoqërinë franceze. Imazhet e prodhuara nga industritë e kulturës siç janë filmi dhe televizioni na mundësojnë "udhëtimin" në shumë vende të botës. Kultura popullore gjithashtu na ndihmon të mësojmë rreth grupeve të tjera kulturore.. Ne priremi të mbështetemi më fuqimisht në imazhet e medias të grupeve kulturore për të cilat kemi pak apo pothuajse aspak përvojë personale, por në këtë rast stereotipizimi mund të përbëjë një problem. Një pjesë e madhe e kulturës popullore prodhohet në SHBA dhe qarkullon në të gjithë globin. Mungesa e ekuilibrit të shkëmbimit midis kulturës popullore amerikane dhe teksteve të tjera të kulturës popullore, ka ngritur shqetësime rreth imperializmit kulturor.⁵⁶

Identiteti ynë kombëtarë ndikon me siguri mbi natyrën se si ne e shohim botën dhe komunikojmë me njerëz të kombësive tjera. Ashtu sikurse njëri prej studenteve tanë nënvizoi: Sa më shumë zgjeroj horizontin kulturor, aq më i mrekulluar jam nga mënyra se si e shikoj jetën si rezultat i të qenurit amerikan. Ka kaq shumë gjëra që ne i marrim të mirëqena, si mënyra e vetme për të bërë diçka apo për të menduar, ashtu si i gjithë ajo që ka të bëjë me individualizmin dhe sjelljet, vlerat e lidhura me të. Ka kaq tipa njerëzish dhe personalitetesh që nuk i kisha imagjinuar kurrë më parë.⁵⁷

Duhet theksuar se neve na nevojitet edhe vetëm një hap i vogël në drejtim të mirëkuptimit të tërësishëm se jeta në botë me shumë kultura dhe religjione të ndryshme vetëm mund të na i forcojë raportet tona në shumë llojllojshmëri të besimeve, ideve dhe mendimeve, por normalisht duke respektuar gjithsecili kulturën, besimin e vet.

Dhunë është çdo imazh që e lëndon rëndë spektatorin dhe që e shkëput atë përkohësisht nga realiteti

Duke analizuar rrethanat e frymëzimit të fesë islame në trojet shqiptare, nuk iu është dhënë edhe vendi i merituar në hapësirat mediale të të gjitha zhanreve, por këtu duhet të kihet një gjë e qartë se kjo nuk ka kaluar në shenjë harrese, por ka qenë një model laik (kundër islam) që është praktikuar vetëm për fenë islame e cila ka një shtrirje vertikale dhe horizontale shumë të gjerë në trojet tona etnike. Disa media deri më tash islamin e trajtuar si fe të një kulture e civilizimi të prapambetur, si të huaj për shqiptarët, si fe e dhunës dhe e fanatizmit, që pengon modernizimin e jetës, lirinë e të menduarit dhe të të shprehurit; fe afriko-aziatike e madje disa e kanë quajtur fe të Lindjes.

Kryeministri maqedon Nikolla Gruevski në hapjen e Konferencës së dytë botërore për dialog ndërfaqetarak dhe ndërcivilizuese që me moton "Religjioni dhe kultura lidhja e pashkëputshme mes popujve", që u mbajt në Ohër, pos tjerash tha "Personaliteti është i shenjtë. Ai është qenie shpirtërore që është krijuar në mënyrë të barabartë, kur përqendrohemi tek tjetri dhe i duam të afërmit si vetveten, mund të jetojmë në paqe, mirëkuptim dhe tolerancë njëri me tjetrin. Edhe krahas dallimeve në religjionet dhe civilizimet tona, kur koncentrohemi drejt nevojave të justifikueshme të fqinjëve tanë, kur i duam sa e duam vetveten dhe kur e duam Zotin tonë, mund të mësojmë të jetojmë së bashku".⁵⁸

⁵⁵ www.yllpress.com, 7 Maj . 2010

⁵⁶ Judith N. Martin, Thomas K. Nakayama, *Hyrje në komunikim ndërkulturore*, përkthyer nga Elena Bozheku, UET Press, 2010, Tiranë, f.229- 231

⁵⁷ Judith N. Martin, Thomas K. Nakayama, *Ibid.* f.124.

⁵⁸ www.shqipmedia.com/2010/05

Më datën 3 dhjetor 1977 gazeta britaneze “*The Independent*” e ka botuar një shkrim të Robert Fiskut, që ka të bëjë me mënyrën e trajtimit të çështjeve të muslimanëve në mediat perëndimore, ku sqaron se Perëndimi vazhdimisht dhe me qëllim e ofendon Fenë islame me të gjitha mënyrat, me anë të shtypit dhe të mjeteve tjera. Në këtë shkrim, ai i përmend dy shembuj për këtë, njëri prej të cilëve është i njohur dhe aktual: pas eksplodimit të soliterit tregtar internacional në Nju Jork, revista “*Time*” faqen e parë e fillon me këtë titull: “Terrorizmi islamik”! E në anën tjetër, vazhdon Fisku, kur serbët ushtruan lloj-lloj gjenocidi e krimi mbi muslimanët e Bosnjës dhe Hercegovinës, ajo në mediat franceze paraqitej si konflikt nacional e jo fetar. Dhe, asnjëherë nuk ka ndodhur të konsiderohen krimet serbe si terror krishterë evropian.

Përkundrazi, ai konflikt është paraqitur në shumicën e mediave perëndimore si konflikt për sundim të tokës apo për shkak të kufijve gjeografik.

Nganjëherë media shndërrohet edhe në mjet dhune. Publikimi i 12 karikaturave të Profetit Muhamed a.s., nga e përditshmja daneze “*Jyllands –Posten*” më 30 shtator të vitit 2005 ka nxitur dhe ka provokuar miliona opinione të botës islame dhe më gjerë. Mbase vetë qëllimi i gazetës ka qenë rritja e tirazhit të lexueshmërisë që në thithë sa më shumë reklama dhe publicitet. “Se amullia e botës lindore muslimane ka marrë edhe trajta të tragjedi-komedisë si te tregtari i flamujve i Koliqit, dëshmon edhe lajmin se në Egjipt është rritur shitja e flamujve danez të cilët muslimanët i blejnë për t’i djegur. Një dalldi për t’u vajtuar”.⁵⁹

Dhe a e dini kujt i drejtohet Ernesto Sabato ?! Gjithë atyre që janë për një botë të lirë ku të gjithë duhet patjetër të ndërtojnë një strategji të re me Islamin, dhe kjo strategji nuk do të jetë një strategji lufte mes dy qytetërimeve e kulturave, por një strategji bashkëpunimi, mirëkuptimi dhe pranimi, duke integruar qytetërimet, kulturat dhe civilizimet mes feve. Ernesto Sabato i referohet në një vend Helder Linit : “..... Qeveritë kanë harruar në mbarë botën se qëllimi i tyre është të promovojnë të mirën e përbashkët. Solidariteti luan, kështu, një rol vendimtar në këtë botë pa krye, përjashtuese të llojeve të ndryshme.....Miliona qenie mbijetojnë heroikisht në mjerim. Ata janë martirët.....Në këtë varfërim ekzistencial dhe metafizik, të gjithë janë viktimë të një qielli dhe të një çatie.....Banalitetet, ku kalben ndjenjat më fisnike, e degjenerojnë njeriun në një karikaturë patetike që nuk e gjen më veten në të qenit njeri.....Mjerë njeriu që mbështetet vetëm tek arsyeja-shpëtojme hera-herës e mbi të gjitha falë grave, jo thjeshtë sepse dhurojnë jetën, por janë ato që mbrojnë këtë specie enigmatike.....”

Por, edhe kultura edhe media nga një aspekt tjetër vetës ja kanë vënë obligim duke u shndërruar në një fushë profitabile të lartë. Bazuar në një studim të botuar në janar 2009 nga Sindikata e Regjive Internet (SRI), reklamapaguesit në Francë investuan gati 2 milionë euro në VEB në vitin 2008. Ky vlerësim i realizuar nga shoqëria Cap Gemini Consulting me kërkesën e SRI, mban parasysh lidhjet e sponsorizuara (të papërfshira në studimin e tregut publicitar të botuar nga IREP), të cilat në vitin 2008 përfaqësojnë segmentin kryesor të tregut të reklamës në linjë ose 800 milionë euro. Pjesa kryesore e kësaj dhurate kapet nga Google që në të kundërt, nuk jep statistika. Kështu, sipas këtij vlerësimi, të ardhurat e Internetit përfaqësojnë 59% të të ardhurave publicitare të televizionit dhe rreth 6% të shpenzimeve totale të reklamapaguesve. Investimet publicitare në Internet do të binin me 14% në vitin 2009, sipas SRI-së.⁶⁰

Shpeshherë mediet jo vetëm që nuk luajnë rolin e ndërafrimit kulturor por ata shfaqin imazhe të dhunshme apo përçon mesazhe të cilat lëndojnë ndjenjat e fetarëve e sidomos fesë islame që mediet e etiketojnë me lloj lloj etiketimi. Dhuna nuk matet, ajo është cilësore. Dhuna është relative, ajo varet nga secili njeri, nga kuptimi që ai i jep, nga kuptimi që mund të ketë sipas tij, por edhe nga shoqëria nga e cila ajo është e pandashme, e cila e konsideron si një gjë të keqe që mund të kapërcehet me anë të drejtësisë dhe duke shkuar drejt “qytetërimit, ose si një të keqe të domosdoshme për lindjen e”mbinjeriut” ose për një të plot lumturi. Sipas Serge Tisseron, psikiatër dhe psikanalist, mund të konsiderohet si I dhunshëm “çdo imazh që e lëndon rëndë spektatorin dhe që e shpëput atë përkohësisht nga realiteti”. Aq më shumë që sot imazhet janë akoma edhe më të rrezikshme sepse “ato synojnë dëshirat tona” sepse përdorin dhe abuzojnë me

⁵⁹ Zekirija Ibrahimiri “*Karikaturimi i Lirisë*“, Gazeta Besa, f. 15. nr 19 viti i 2, shkurt 2006.

⁶⁰ Francis Balle, Ibid. f.553.

fuqinë e tyre të joshjes. Por duhet të kujtojmë se çështja e dhunës lidhet me çështjen e moralit me gjëra të ndaluara e gjërat e detyruara dhe se vetëm mësimi i normave na mundëson të bëjmë dallimin midis asaj që psikanalisti Daniel Sobony e quajti “dhuna e jetës”, që ka të bëjë me të takuarin e të tjerëve dhe “dhunës së vdekjes”, synimi i vetëm i të cilit është t’i bëjë keq të tjerëve pa arsye si dhe duke u mburrur.⁶¹ Gjithnjë e më tepër ndëreligjioziteti dhe konfliktet ndërkulturore nga do në botë kanë bërë që gjithsesi të promovohet inter-religjioziteti dhe dialogu ndërkulturore. Shkaqet apo arsyet e këtyre konflikteve mund të jetë disa sosh. Bota ishte e ndarë në dy pole, jugor dhe verior, ku poli verior kishte shënuar një zhvillim të hovshëm ekonomik se sa poli jugor i cili i goditur me ngecje, analfabetizëm dhe varfëri.

Në epoka të shkuara, shkruan Robert Eco çdo komunikim i drejtohej një marrësi të përcaktuar mirë, kodet interpretuese të të cilit përkonin me ato të dërguesit. Çdo keqkuptim karakterizohej si “dekodifikim rravgues”, që rrallë përjashtonte regullat kulturore të pranuar nga të gjithë. Ndërsa në shoqërinë e masave, ku publiku është me përkufizim i vagullt dhe i diferencuar, dekodifikimi rravgues bëhet normë. Lind, kështu, nevoja e një studimi semilogjik, që të kontrollojë flukset e komunikimit dhe që të pajiset me mjetet e nevojshme të analizës, për të kuptuar procedurat e dekodifikimit rravgues (dhe, po të doni, edhe për shmangur shfaqjen e saj në të ardhmen). Kjo parakupton, duke e krahasuar me çdo hetim sociologjik apo vlerësim estetik, analizën e strukturave komunikuese që TV-ja vë në jetë, pra të kodeve paraprake të dërguesit, të formës që ka marrë mesazhi dhe kodeve të përdorura nga marrësi.⁶²

Ndër religjioziteti dhe dialogu ndërkulturore

Çështja e dialogut mbetet e vetmja rrugë që të arrihet dhe mbështetet mirëkuptimi në mes grupeve konfliktuale. Dialogu mund të zhvillohet midis tre lloj grupeve. E para grupet politike; 2) grupet fetare dhe 3) mbështetësit grupeve politike dhe fetare. Sigurisht që gjithashtu ka edhe dallime mes nivelit të dialogut dhe procesit gjithëpërfshirës që dialogu i involvon të gjitha këtë nivel. Ai mund të vendoset në nivelin e liderëve politik apo fetarë, apo në nivelin e intelektualëve nga grupe të ndryshme, por edhe të masës. Natyra e dialogut ndryshon varësisht prej niveleve, si p.sh. në nivelin intelektual kërkon dhe është më analizues, më detajues për ngjarjet dhe kuptimin e natyrës së forcës që është involvuar në mbështetjen e konfliktit. Në këtë nivel të dialogimit gjithashtu duhet që të bëhet strategjia e promovimit të ndëreligjiozitetit dhe harmonisë ndërkulturore. Kurse në nivelin politik dialogu mundet të bëhet me ata politikan që besojnë në politikat sekulare dhe që refuzojnë çdo ideologji, politik të fesë apo konfrontimit kulturor. Në rrafshin politik dialogu mund të trajtoj strategjinë sjelljes së aleancave sekulare për të izoluar forcat shoqërore dhe fundamentale. Ndërkaq në rrafshin fetar, dialogu duhet të trajtoj fenë dhe aspektet teologjike. Poashtu edhe feja duhet të kuptohet në nivele të ndryshme, në atë të ritualeve, besimit, institucioneve dhe vlerave. Edhe pse ritualet, besimet dhe institucionet ndryshojnë nga feja në fe, vlerat janë të detyruar të jenë plotësuese, p.sh. feja islame veç tjerash karakterizohet për drejtësi dhe barazi mes njerëzve. Ritualet, besimet dhe institucionet janë unike në çdo fe dhe kjo shpesh herë çon në keqkuptim. Çdo traditë fetare thekson rendësin e ritualeve të caktuara dhe besimi mbetet qendra në traditën e fesë dhe krahas kësaj tregon edhe superioritetin e ritualeve dhe besimit në përgjithësi. P.sh feja islame rreptësisht e ndalon faljen dhe qëndrimin para idhujve për iradat. Poashtu Islami vë në fokus besimin në një Zot dhe largon çdo lloj rivaliteti në adhurim përveç Tij. Në hinduizëm çështja është më ndryshe pasi që ata besojnë dhe lejojnë përluljen dhe lutën para idhujve. Këto koncepte e bindje fetare në disa vende siç është India kanë shpër në konflikte të dhunshme dhe të përgjakshme. Si do që të jetë nga ana tjetër kjo dhunë nuk është mbështetur apo nxitur nga liderët fetarë, të kundërtën e liderëve politikë të cilët shqetësohen seriozisht nga ritualet dhe besimet. Kjo assesi nuk do të thotë se liderët fetarë nuk ndryshojnë. Këto ndryshime për një dialog të duhur, duhet që kuptohet dhe vlerësohet e jo të luftohet. Shumë nga sufistët e bhakti shenjtorët e bëjnë pikërisht këtë. Ata jo vetëm që u përpoqën për të bërë vlerësimin e këtyre ndryshimeve konceptuale por u përpoqën për ti pajtuar ato.

⁶¹ Ibid. 735

⁶² Gianfranco Marrone, Corpi sociali, *Trupat shoqërore proceset komunikuese dhe semiotika e tekstit*, përkthyer nga Dhurata Shehri dhe Persida Asllani, shtypur Guttenberg, Tiranë, 2008, f.74.

Efekti i rigjallërimit fetar në të drejta njerëzore dhe në drejtësinë shoqërore universale. Institucionet fetare kanë bërë sigurisht shumë deklarata mbi të drejtat e njeriut dhe drejtësinë shoqërore.⁶³

Asgar Ali Engineer në shkrimin e tij “On religious and intercultural dialogue”, veçon disa rregulla që mendon se janë një ndihmë e madhe në rezultatin e një dialogu. Rregullat vijuese do të ishin një ndihmë e madhe për të ndihmuar dialogun ndërfaqetor janë:

1) Palët që përfshihen në dialog duhet të jenë të brumosur fort në traditën e tyre dhe duhet të kenë besim dhe bindje të brendshme. Kjo është bindja e vërtetë dhe është një themel i fortë për dialog.

2) Në dialog assesit të mos të zhvillohen polemika, ngase stili polemizues është antitezë e dialogut ngase polemika shtyn dialogun në kahe të gabuar dhe mos kuptimin e palëve.

3) Dialogu nuk duhet të zhvillohet vetëm për të kuptuar tjetrin por edhe duhet të respektoj integritetin e tij. Çdo dialog që nuk përmban respekt për integritetin dhe bindjet e tjetrit është i prirur të dështoj.

4) Ideja e dialogut duhet të jetë në funksion të shpjegimit të pikëpamjeve e jo të shndërrohet në një pikëpamje, sepse për ndryshe një përpjekje e vogël tjetër do të dëmtonte dhe shembte frymën e dialogut dhe kjo poashtu do të çonte në pakënaqësi mes palëve dialoguese.

5) palët në dialog poashtu duhet të kenë parasysh diversitetin si një bazë qenësore e jetës. Pa diversitet jeta kalon në monotoni dhe do ta humbte bukurinë e saj. Nga ana tjetër edhe Kurani jo vetëm që e njeh diversitetin por edhe e legjitimon atë. Kjo është dëshira e Allahut xh.sh, që tek njerëzit të ketë diversitet. “Ne edhe ty (Muhamedi) ta zbritëm librin (Kuranin) e vërtetë që është vërtetues i librave të mëparshëm dhe garantues i tyre. Gjyko, pra, mes tyre me atë që Allahu e zbriti, e mos pëlqej epshet e tyre e të largohesh nga e vërteta që të erdhi. Për secilin prej jush, Ne caktoam ligj e program (të posaçëm në çështje e të veprimit). Sikur të donte Allahu, do t’ju bënte një popull (në fe e shariat), por deshi t’ju sprovtoj në atë që iu dha juve, andaj ju (besimtarë) përpiqu për punë të mira. Kthimi i të gjithë juve është te Allahu, e ai do t’ju njoftoj me atë që kundërshtoheshi. (*El Maide*, 48). Poashtu thotë “Secili (popull) ka një anë, të cilës ai i kthehet, ju shpejtoni kah punët e mbara, kudo që të jeni Allahu ka për t’ju tubuar të gjithëve, Allahu ka fuqi për çdo send”. (*El Bekare*, 148). Mungesa e diversitetit dhe zbatimit të një sistemi ideologjik në fund të fundit mund të shpie drejt fashizmit dhe autoritarizmit.

6) Një gjë duhet kuptuar mirë, dallimin mes dialogut dhe monologut për të pasur një dialog efektiv. Sepse dëshira për të dominuar dialogun shpie në monolog. Secilës palë në dialog duhet të ketë hapësirë të barabartë për të prezantuar pikëpamjet e vet. Dialogu mund të marr kuptimin e saktë vetëm atëherë kur bëhet në frymën e vërtetë demokratike duke respektuar, njohur të drejtat e të gjithë pjesëmarrësve në dialog

8) Në fund duhet të kuptojmë se realizimi i një dialogu efektiv është i mundur jo vetëm atëherë arrijmë të dëgjojmë këndvështrimin e tjetrit por të kuptohet dhe vlerësohet saktë në kontekstin e dhënë.

Nëse këto rregulla gjejnë zbatueshmëri në terren në dialogun ndërfaqetor dhe ndërkulturor, atëherë rezultati do të jetë mjaft inkurajues. Asnjë vend sot nuk mund të mburret më krenarin e të qenurit rigoroz një besimor apo një kulturor. Zhvillimi i hovshëm ekonomik dhe komunikimi shpejt ka krijuar diversitet tek grupe të ndryshme fetare e kulturore kudo në botë të kenë qëndrime të përafërta ose të njëjtë në mendime. Disa grupe do të jenë mazhoranc në numër, kurse të tjerët minoritet. Apo mund të ndodh edhe e kundërta që disa minoritete mund të bashkohen e të përbëjnë shumicën siç mund të ndodh në Kanada në një të ardhme të afërm. Mozaiku i modeleve të shoqërisë mund të mbaj bukurinë e saj vetëm në harmoni. Plasja e një konflikti mund të çoj në zbeheje të këtij mozaiku për shkak të rritjes së pakënaqësisë dhe tendosjes së marrëdhënieve ndëretnike.⁶⁴

⁶³Azzam Temimi/ Xhon L. Esposito, *Islam and secularism in the Middle East*, përktheu nga anglishtja Bujar Hoxha, Logos –A, 2010, Shkup, f.110.

⁶⁴ Asgar Ali Engineer, <http://andromeda.rutgers.edu>.

Bota myslimane mund të krijojë një gjallëri të re qytetëimore, nëse elitat intelektuale, ekonomike dhe politike mund të riformulojnë qëndrueshmërinë e pasurisë historike të civilizimit islam për realizimin e një aktivizimi efikas në arenën sociale, ekonomike dhe politik. Rendi i ditës i ri politik i botës myslimane si një kundërpërgjigje Rendit të Ri Botëror hipokrit, duhet të mbështetet nga produktiviteti intelektual, efikasiteti ekonomik dhe dinamizmi social. Një gjallëri e tillë qytetëimore jo vetëm që do të sigurojë një zgjidhje për botën myslimane, por ajo do të sigurojë një alternativë për të gjithë njerëzimin.⁶⁵

Për fund dialogu konsiston në ngritjen e bashkëjetesës dhe harmonisë e tolerancës mes kulturave e feve të ndryshme. Bashkërisht mund ta përballojnë çdo problem, çdo sfidë e çfarëdo rrafshi qoftë. Ky është dialogu real i jetës, dialog që paraqet jetës të përbashkët ku mjetet e komunikimit masiv do të fokusoheshin në respektim dhe mbjelljen e dashurisë, respektin dhe avancimin e së drejtës qytetare për njerëzit e një vendi.

Konluzione

1. Feja, [kultura dhe mediet të mos shndërrohen në forca që çojnë drejt konflikteve dhe ndarjeve](#).
2. Dialogu ndërkulturor, vetëm kontribuon drejt mirëkuptimit të faktit se pavarësisht veçantive tona, ndajmë vlera pozitive dhe ballafaqohemi me sfida të ngjashme"
3. Mediet forcojnë ndikimin e religjionit dhe kulturës që të kenë një lidhje të pashkëputshme mes popujve.
4. Luajtja e një roli tepër aktiv dhe efektiv që mos të lejohet ndarja e botës në mes "Perëndimit dhe të tjerët", ashtu siç ka bërë Samuel Huntigtoni në librin e tij "The Clash of Civilizations" (Përplasja e qytetërimeve).
5. Mediet mund të ndikojnë në përmirësimin e jetës së njerëzve dhe në vendosjen e paqes dhe sigurisë. Ata mund të ngrenë lart moralin dhe spiritualitetin në mesin e njerëzve dhe t'i kënaqin njerëzit.

⁶⁵ Ahmet Davutoglu, *Trasnsformimi qytetërimor dhe bota muslimane*, Logos-A, Shkup, 2005, f.232.

TË JESH PERSONAZH I VEPRËS MIGJENIANE

DR. ROVENA (VATA) MIKELI- Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë

Abstract

To be a character of Migjene's work means to be separated from him, both mentally and spiritually. Migjeni was the psychologist of suffering souls. He dared a lot when he built such characters in his literary work. Migjeni also dared a lot when he wrote the story: "Cubit's Kiss", where he analyzes in detail the emotional "explosion" and the physical desire to have sex at the age of 17, Dila, the character created by Migjeni.

Migjeni dared when he built the character of Nushi, who grew up under the censorship of his authoritarian parents and his traditional principles. As the character of Nushi, Migjeni has created many other characters.

Migjene's characters are grown up in a miniature environment. At her sister's wedding ceremony, Nushi also feels the threat of her marriage, as they marry her to a man she did not love and suddenly, she falls in love with her husband's servant. the character of Nushi realizes that he is surrounded by a suffocating environment, because of some rotten mindsets of a society, which 'flourished' at the expense of human beings, who were completely defenseless.

Keywords: Woman, mountain woman, beggar, misery, desire, experience

Abstrakt:

Të jesh personazh i veprës migjeniane do të thotë të zbërthehesh prej tij, si nga ana mendore dhe nga ajo shpirtërore. Migjeni ishte psikologu i shpirtit të vuajtur. Ai guxoi shumë kur ndërtoi personazhe të tilla në veprën e tij letrare. Migjeni guxoi shumë edhe kur shkroi tregimin: "Puthja e Cubit", ku analizon në detaje "shpërthimin" emocional dhe dëshirën fizike për të kryer marrëdhënie në moshën 17 vjeçare, Dila, personazhi i krijuar prej Migjenit.

Migjeni guxoi kur ndërtoi personazhin e Nushit, i rritur nën censurën e prindërit autoritar dhe parimeve të tij tradicionale. Si personazhi i Nushit, Migjeni ka krijuar sa e sa personazhe të tjera.

Personazhet e Migjenit janë të rritur në një mjedis si në miniaturë. Në ceremoninë e martesës të së motrës, Nushi ndjen edhe pengun e martesës së saj, pasi e martojnë me një njeri, të cilin nuk e dashuronte dhe krejt papritur, ajo bie në dashuri me shërbëtorin e burrit të saj. personazhi i Nushit kupton se është i rrethuar nga një ambient mbytës, për hatër të disa mendësive të kalburës të një shoqërie, e cila 'lulëzonte' në kurriz të qenieve njerëzore, të cilat ishin krejtësisht të pambrojtura.

Fjalë kyçe: Grua, malsorja, lypsi, mjerim, dëshirë, përjetim

"Neve nuk na duhen kryevepra botnore, na duhen shkrimtarë që të dinë me pasqyrue realitetin që jetojmë, që e shohin jetën pa perde, pa frikë" (Migjeni, Vepra:2002).

I cilësuar si 'uragan' ardhja e tij në letërsinë shqipe, Migjeni ishte autori, i cili ua hoqi mbulesën plagëve sociale, të cilat kishin pushtuar jetesën e banorëve të Shqipërisë së Veriut. Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe, ishte, si ardhja e Jezuesit në zemrat e besimtarëve katolikë. Pra Migjeni ishte gur i çmuar në letërsinë shqipe, "i cili... nderonte Shkodrën, Shqipërinë, Ballkanin dhe Evropën" (Zeqo, Moikom:2011)

"Proza e Migjenit shquhet për tematikën e vet të gjerë. Një vend të madh në prozën e Migjenit zë jeta e fshatit shqiptar të asaj kohe, sidomos e fshatit malësor". (Sinani, Shaban:2019)

Migjeni erdhi në letërsinë shqipe si 'shpërthim' vullkanik dhe u shua si 'lëkundje tërmeti', nga sëmundja e shekullit e asaj kohe, TBC-ja, që mundi fizikisht shkrimtarin verior, por që la trashëgimi, të pashlyer në historinë e letërsisë shqipe.

Migjeni ishte njëkohësisht edhe parashikuesi edhe viktimja, i cili i nënshtrohej krejt natyrshëm asaj që parashtronte në krijimet e tij. Pra krijimet e Migjenit ishin një fat i parathënë prej tij.

Migjeni është i jashtëzakonshëm në letërsinë shqipe për nga origjinaliteti i trajtesave të fenomeneve dhe krijimit të personazheve të tij të pavdekshme në kohë, ku me plot bindje mund të themi se personazhet e Migjenit janë të pavdekshëm njëllor si kryeveprat botërore.

Migjeni ishte një vëzhgues i hollësishëm i plagëve sociale, ku gjenin terren veprimi personazhet që vet ai i krijonte, e më pas, Migjeni këto personazhe i fuste në spektrin e studimit psikoanalitik. Vetë Migjeni në vargjet e tij, do shprehej kështu:

... “Unë vuej bashkë me fëmijën të cilit prindi nuk ia blen lodrën,

-Vuej bashkë me të riun që digjet në erotizëm,

-Vuej me pesëdhjetëvjeçarin që mbytet në apatinë e jetës,

-Vuej me plakun që dridhet nga frika e vdekjes,

-Vuej me bujkun që lufton me tokën,

-Vuej me punëtorin të cilit hekuri e ndrydh...” (Migjeni, Vepra:2002)

Migjeni ishte shumë i ndjeshëm ndaj fenomeneve sociale, ndaj padrejtësive njerëzore dhe mbi të gjitha ndaj mjerimit ekstrem, siç edhe shprehet Bojka në letërën tjetër drejtuar Olgës, motrat e Migjenit, ku shkruan se ai vuante për të gjitha padrejtësitë shoqërore, por në asnjë moment nuk u bë pesimist. Migjeni me qeshjen e tij optimiste në buzë kërkonte një buzëqeshje të re, kërkonte njeriun e ri, kërkonte “Mbinjeriun” të zgjohej nga fryma e shekujve, por ai vullnetet që thërret di t’i mbysë dhe u drejtohet:

–“O vullnete të ndrydhuna...

–O vullnete të shtypuna...” (Migjeni, Vepra:2002)

Sipas studiuesit Moikom Zeqo, i cili shprehet se Migjeni jetonte të gjitha shqetësimet që nga ato më të parëndësishmet, e deri të ato që ngriheshin e bëheshin problem i madh, që të shkatërronin jetën (Idrizi, Rinush:1992)

Pena migjeniane mbetet e faktuar, përmes dy gjinive që autori shkroi, poezisë dhe prozës, ku ligjërimi i tij, mund të krahasohet jo më pak, veçse me letërsinë e përbotshme.

Migjeni, para së gjithash, i takon vetvetes, ndërsa vlerat e personalitetit dhe individualitetit të tij krijues janë të zbatueshme në çështjen kombëtare (Raifi:Mensur:1979)

Migjeni zbuloi në letërsinë e tij, jo vetëm realitetin, por si një psikolog i detajeve, i shtjelloi ato *një për një*, duke i identifikuar si fenomene sociale, si humbje identiteti, si dhimbje shpirtërore, si mungesë dashurie. Migjeni krijoi në letërsinë shqipe personazhe të cilat identifikohen lehtësisht si personazhe migjeniane.

Çdo lexim i ri i veprës së Migjenit na ofron rrafshë të reja kuptimore, nënshtresa të pazbuluara të vlerave ideore të botës së cilës i referohen personazhet e tij, që janë të ndërlidhura sa me kohën e vet, aq edhe me perioda të mëvonshme historike dhe kulturore. (Kryeziu, Resmie:2004)

Në thelb të prozës së tij, Migjeni trajtoi *Njeriun*, duke dyshuar në qenien e tij, duke e parë të dyzuar personalitetin njerëzor, ku mjafton të kujtojmë shprehjen: *De jure u ba Sokrat e de facto ishte derr* (Migjeni, Vepra:2002)

Ky ishte koncepti i Migjenit për *Njeriun*, ku sipas Migjenit, *Njeriu* vetë është në dilemë se cilën alternativë të zgjidhi, atë të Sokratit apo të derrit.

Migjeni, përmes këtij tregimi bën thirrje, që në fund të fundit, *Njeriu* duhet të ruajë dinjitetin e tij njerëzor përpara botës, por prapë së prapë, *Njeriu* nuk mund të dalë jashtë kornizës së tij të mendimit dhe të veprimit.

Kaiherë njeriu nuk mund të mshehi cilsinat e derrit dhe na paraqitet ashtu siç asht (Migjeni, Vepra:2002)

Sipas studiuesit të veprës së Migjenit Koço Bihiku, i cili shprehet kështu: *Migjeni goditi te Sokrati me forcë hipokrizinë si cen të dëmshëm të natyrës njerëzore* (Bihiku, Koço:2004)

Migjeni trajtoi lakuriqësinë e realitetit, e mbi këtë realitet krijoi personazhe migjeniane, të cilat identifikojnë plagë, plagë dhe vetëm plagë sociale dhe shpirtërore.

Krijimtaria e Migjenit është materie e gjallë dhe e pavdekshme e kulturës shqiptare. Spikat si një nga thesaret më të mëdha kombëtare (Zeqo, Moikom:2011)

Personazhe të tilla Migjeni ndërtoi kryesisht në novelat e tij, siç janë: “Novelat e qytetit të veriut”. Këto novela Migjeni i kishte përfunduar në fundin e vitit 1936, por dritën e botimit e panë në vitin 1944, pra pas vdekjes së tij.

Studiuesja Nathalie Piégay-Gros në veprën e saj: *Poetika e intertekstualitetit* shprehet kështu: *Nga referenca që një personazh mund t’i bëjë një vepre, rrëfimi duke vënë në skenë leximet e këtij personazhi, saktëson për shembull psikologjinë, hijet dhe përndjekjet e tij, por gjithashtu dhe diturinë, aftësinë kulturore dhe nga vetë këtej, në një këndvështrim sociologjik, përkatësinë e tij ndaj një mjedisi të dhënë* (Piégay-Gros, Nathalie:2011)

Personazhet e lentës së Migjenit kanë një pikë të përbashkët, pasi gjallojnë në një mjedis të përbashkët. Personazhet e cilat i kanë sytë nga *qielli* dhe nga *lypja*, nga ku janë krijuar personazhet vetëm me emra, pasi si mbiemër pronor kanë Migjenin, si janë:

1- Malsorja te tregimi: “A do qymyr, zotni?”

Malsorja e Migjenit.

“E malsorja fillon të shqetësohet për kthimin në malsi. Shikon diellin, si gjithnjë po afrohet nga perëndimi. Si ka për t’u kthye në malsi nëpër terr? Me të vërtetë, ajo nuk dron prej lugetënve dhe bubazhelave, por... t’ishite plakë, nuk do të kishte aspak frigë, por... Kujtohet si nja dy tri herësh i janë vu mbrapa do njerëz, dhe së pari nuk dinte se ç’lypshin prej saj...” (Migjeni, Vepra:2002)

2- Luli te tregimi: “Luli i vocërr”.

Luli i Migjenit, i cili simbolizonte mjerimin, skamjen dhe varfërinë ekstreme. Migjeni, përmes personazhit të Lulit dhe jo vetëm, i thur poemë mjerimit dhe brenda fjalës mjerim jep edhe disa prej derivateve më tronditëse të shekullit që ka jetuar vetë shkrimtari, si në rastet:

Mjerimi=kafshatë, mjerimi=vulë, mjerimi=fëmijë i pjekur, mjerimi=flaka e dëshirave, mjerimi=dashuri epshore, mjerimi=dritë syri, mjerimi=faqe e lustrime, mjerimi=njollë e pashlyeshme, etj. Ja pra si këndon Migjeni këngën e tij të mjerimit, ai vuan bashkë me të dhe nuk lë fenomen pa prekur brenda tij.

“Kur Luli hyn n’oborr të shkollës, buza i qeshet nga pak, po askujt asnjë fjalë s’i thotë. Ecën ngadalë, tue shikue djathas e majtas, por gjithnjë tue ecë, derisa të mrrijë në cak të vet. Aty te dera e ruginës shkollore shumë i pëlqen të qëndrojë. Aty asht caku i tij, i pruar me rrezet e ngrohta të diellit në këto ditë të vjeshtës. Mbështetet Luli për mur, grushtet e vegjël i shtie ndër xhepa, hundën picërrake të kuqun nga të ftohtit e mëngjesit ia sjell diellit dhe... shikon. Gjaja që ma tepër ia tërhjek vretën janë çizmet, që i kanë të veshun disa shokë të tij. Sa të bukra janë! Si shkëlqejnë! – mendon Luli dhe pa dashje i shkojnë syt ndër tollumbat e veta, nëpër të cilat shifen fare mirë të pesë gishtat e kamave të zbathura” (Migjeni, Vepra:2002)

3- Lypsi te tregimi: “Zoti të dashtë”.

Lypsi i Migjenit.

“Lypsit medoemos i duhet me marrë vesht. E len atë derë, msyn të dytën, të tretën, të katërtën, e kështu me radhë, të gjitha dyert e asaj rruge. Kjo rrugë sot për sot asht fusha e veprimt të tij. Nesër asht ndoj rrugë tjetër. Fushat e veprimt të qytetarit tonë janë të ndryshme”. (Migjeni, Vepra:2002)

4- Dila te tregimi: “Puthja e Cubit.

Dila e Migjenit.

Migjeni lulet që çelin në stinën e pranverës nuk ua shkurton kohën për t’i futur në çadrën dimërore, e cila në këtë rast nuk i mbron, por i vyshk, njëlloj si entuziazmin e moshës tek personazhi i Diles, e cila sapo ka vlerësuar vitet që ka kaluar dhe po bëhet e vetëdijshme për moshën e saj.

“Sa fort Dila që i ndjen të 17 vjetët në vete! Kur në të kapërthymit e dëshirës, ven shplakët nën krye dhe ma fort shtrihet, ndjen si ndër veshë dhe ndër thimtha i rreh gjaku me rrjedhe të forta dhe e ban me i ndie edhe me dishrue ma tepër” (Migjeni, Vepra:2002)

5- Nushi te tregimi: “Studenti në shtëpi”.

Nushi i Migjenit.

Nushi është personazh i dyzuar, i cili bie në kundërshtim me ndërgjegjen e tij. Leksionet e Nushit para së motrës ngjallin ndjenja të bukura me synimin për t’i vrarë sapo të kalojë nga njëra dhomë në tjetrën. Agia qan, por i fsheh lotët, vuan, por e fsheh vuajtjen, gëzohet, por veç faktit se e fsheh dashurinë e saj, ajo do t’ia mohojë vetes, do ta vrasë këtë kënaqësi që ndjen në fshehtësi. Agia është pak a shumë vet Migjeni. Ajo i nënshtrohet një metamorfoze morali, Nushi i nënshtrohet një metamorfoze intelektual, sikurse ndodh edhe te kafka, ndërsa babai i tyre i nënshtrohet një metamorfoze të sojit tjetër, ai kthehet nga përbindshëm në këngëtar që çirret, e përmes kësaj del se:-

... i ashtuquajturi ideali familjar asht mshtetun n’interes (Migjeni, Vepra:2002)

“Unë jam pa moral, koncepti i em menduar – mos me thanë ideologjik – nuk pajtohet me moralin, të cilin mue kjo shoqni ma imponon. Por unë e marr moralin e saj për sy e faqe, nsa mbrapa ia loz lojën kur të due. Kështu si unë ia lozin lojën shoqnis me qindra veta në vendin tonë. Prandaj, shoqni, po deshe të mos lozin në kurriz tand, ndrrro format. Hiqi brageshat”. (Migjeni, Vepra:2002)

Në këtë korpus personazhesh dhe te Nushi kryesisht paralajmërohet vdekje, por vdekje s’ka. Nushi s’mund të vdiste. Ai ishte edukuar në perëndim.

6- Lukja te tregimi: “Historia e njërës nga ato”.

Lukja e Migjenit.

Erotika e çmendur jepet me një fuqi të natyrshme tek personazhet e tregimit “Historia e njënës nga ato”, pasi ato janë shumë, ose të shprehemi ndryshme, janë shumë nga ato, të cilat kanë një jetë, një krevat, kanë të njëjtët dashnor, kanë të njëjtat brenga dhe dhimbje, kanë një shpirt. Migjeni shpesh e bën Luken hyjneshë, e cila paraqitet si një ikonë apo statujë mes zotnive dhe studentëve si një tregtare, e cila nuk di t’i bëjë reklamë mallit të vet:

“Studentat hutoheshin, iu merrte fjala në gojë, shikofshin shoqi-shoqin, skuqeshin në fytyrë dhe niseshin të kthehen. Atëherë Lukja plaste gazit, qeshej me gjithë zemër dhe i merrte për dore n’odë të saj. kanjëherë ziheshej me ta, pse ndonjeni nga ata ia puthte krahun e zhveshun, e kapte ose e ledhatonte për fytyrë, ashtu si ka të drejtë të kapi gruen e vet vetëm burri që ka vullnet të prifti ose te hoxha” (Migjeni, Vepra:2002)

Lukja bën tregti të ndryrë me vetëdije, ndërsa shoqëria e shtyn, e detyron dhe vdekjen ajo do ta kishte ose nga uria, mjerimi, skamja, sikurse motrat dhe vëllezërit në Malsi ose do të çmendej apo të vdiste nën fuqinë epshore të një qyteti të madh, ku vendosi të jetonte. Pra Migjeni personazheve të tregimit “Historia e njënës nga ato” u jep vetëm dy zgjidhje:

Ose kështu...

Ose ashtu... (Migjeni, Vepra:2002).

Personazhi i Lukes e vënë në mes të këtyre dy zgjidhjeve, nuk kishte rrugë të mesme. Lukja vendos të pranojë mes dy vdekjesh atë më të largëtën, karrierën e një prostitute të pa përvojë dhe madje-madje krejtësisht naive. Ajo ishte përëndeshë e hirit të saj që nuk arrin kurrë ta zotërojë. Por Lukja diçka vlerëson kur i dhemb në shpirt dhe i kujtohet se është femër dhe si e tillë gëzon instinktin prodhues, por i kujtohet vonë se pikërisht këtë instinkt e ka lidh me interesa materiale.

Ndoshta dhe ajo donte që të prodhojë, si prodhon nana-tokë dhe çdo krijesë tjetër (Migjeni, Vepra:2002)

Lukja ndjen dhimbje dhe trishtim. Migjeni e ndërtoi personazhin e Lukes idhshëm, e ngurosi ankthshëm dhe e gdhendi trishtueshëm, bashkë me karrierën e saj, për ta bërë pjesëtare të një çmendine, që di t’i humbë të çmendurit dhe Lukja.. Luken e ndjek pas karriera e saj.

....Kurvës së dikurshme kush i ep lëmoshë?!... (Migjeni, Vepra:2002)

7- Lili te tregimi: “Bukën tonë të përditshme falna sot”.

Lili i Migjenit.

“Buukë!Buukë për Lilin! Hee.. do bukë? Kur të t’apin bukën, ke për të kërkue tlyn, mandej mish e mbasandaj ke për të kërkue shtëpi me diell..

Hee-jo! S’duhet mësue bota njashtu. Jo! S’ka bukë!

Bukë! Aman! Vdiq Lili!” (Migjeni, Vepra:2002)

Migjeni konceptin e varfërisë me pasurinë e shqyrton me raportin e lypsit me zotninë. Shprehja: *Zotni, zotni, të lutem, zotni, ma fal ndoj send* e përsëritur mbi 5 herë në tregimin: “Zoti të dhashtë”, vjen si kambanë e mjerimit.

Kjo shprehje thotë Migjeni është refreni i qytetit tem, as kush tjetër më bukur se banorët e varfër të këtij qyteti, nuk mund ta thonë këtë refren, ku më pas Migjeni shton: Kët melodi mund ta këndojnë vetëm trotuaret e qytetit tem, e ta dëgjojnë vetëm qytetarët tonë (Migjeni, Vepra:2002)

Pra zbritja e malësore në qytet, do të thotë që Migjeni ishte i pari shkrimtar shqiptar, i cili zbriti letërsinë nga fshati në qytet.

Migjeni kulmin në krijimin e personazheve të tij e arriti me novelën “A do qymyr, zotni”. Ku tipikja malësorja bukuroshe do të shesë “qymyr” në qytet, pra “qymyr”=“zjarr” dhe vihet në pikëpyetje çmimi i qymyrit, ku mes çmimit dhe vetë “qymyrit, sikurse mes malësore dhe djaloshit, që do të “blejë” lind një ndjenjë e shpejtë, diçka në prag të aventurës.

“Njeriun që sa at qymyr fisnike

Malësorja sillet. E njef e pyet (Migjeni, Vepra:2002)

Ka shitë edhe njëherë qymyrin dhe i thotë:

Tetë lekë?

Jo, shtrenjt e ke... Më ke idhnue atë ditë,-i thotë lehtë malësore dhe shikon djathas e majtas (Migjeni, Vepra:2002)

Malësorja kuqet, qeshet, sikurse do të qeshet qymyri.

Më ngroh zemrën e ngrime të kësaj bote të vorfshme në oxhakun e djaloshit që blen (Migjeni, Vepra:2002)

Kurse akademiku Shaban Sinani në lidhje me prozën e Migjenit ka këtë mendim: Proza e Migjenit shquhet për tematikën e vet të gjerë. Një vend të madh në prozën e Migjenit zë jeta e fshatit shqiptar të asaj kohe, sidomos e fshatit malësor (Sinani, Shaban:2019)

Pra sipas mendimit tonë, Migjeni është modernisti pa diskutim më i rëndësishëm i letërsisë shqipe dhe letërsia e tij është padyshim shumë qytetare.

“Ky shkrimtar ka ndryshuar letërsinë shqipe dhe nuk mund të harrohet. Të gjithë do të rikthehemi drejt Migjenit jo thjesht për ta kuptuar atë, por më shumë për të kuptuar veten tonë. Migjeni është letërsi e së ardhmes” (Zeqo, Moikom:2011)

Njerëzimi, ky shpikës i kohërave, më shumë shkatërrues se ndërtues i qytetërimeve, është në krize, si nga ana morale, kulturore dhe ekonomike.

“Njerzia kundër njerzisë, domethanë lufta në vetvete, me një fjalë tjetër: revolucion!”. (Migjeni, Vepra:2002)

Njerëzimi nuk kishte më frymëzim, ishte i bërë akull, ku egërsia njerëzore ndaj njëri-tjetrit ishte si shprehja: “Njeriu për njeriu është ujë”.

Përfundime:

E kemi thënë dhe po e përsërisim edhe në këtë rast studimi se çdo shkrimtar dashje pa dashje është produkt i realitetit, ku është lindur dhe rritur, madje shpesh ndodh të thuhet se realiteti, rrethanat, dashuria dhe tmerr i sëmundjeve e bëjnë njeriun shkrimtar të talentuar dhe të mirëqenë. Po t'i kthehemi studimit në fjalë këto situata që sipër përmendëm janë shumë të prekshme në veprën e Migjenit. Personazhet e krijuara prej tij janë një galeri situatash dhe rrethanash katastrofike.

Përfundimet e tregimeve migjeniane nuk ofrojnë zgjidhje, as me komentet plotësuese, që autori shton në fund të tyre. Edhe në rastet kur Migjeni ndërhyr, ato vetëm sa e shtojnë dilemën, kështu që autori hap alternativat, si në rastet: “Sokrat i vucjtun – apo derr i kënaqun?”, “Ose... – Ose”, etj.

Personazhet e krijuar prej lentës së Migjenit janë figura të mjerimit të thellë ekonomik dhe shpirtëror, ato vuajnë nga mungesa e dashurisë, por kjo nuk do të thotë, se personazhet e tij nuk e duan jetën, pasi vdesin pikërisht, duke dashuruar jetën.

Parë në tërësi këto novela kanë një fije të përbashkët lidhëse. Personazhet e krijuar prej Migjenit, gjallojnë në të njëjtin ambient, ku tematika kryesore e autorit është trajtimi i fenomenit të gruas, kryesisht fenomeni i malësorës, që zbret nga fshati në qytet.

Zbritja e gruas dhe jo vetëm e saj në qytet, ku shkrimtari bën çmos ta sjell atë ashtu siç ishte së bashku, me gjitha lakuriqësinë e saj, me vetminë e saj dhe mbi të gjitha me mjerimin dhe skamjen e pakufishme.

Personazhet e krijuar prej Migjenit thyjnë caqe të çdo natyre dhe kategorie, të cilat synojnë të bashkohen, të ribashkohen, përmes dashurisë duke mos përfillur psikologjinë e thashethemeve ku ato jetojnë.

Migjeni përmes personazheve të tij u këndon faktorëve që e lodhin dhe nuk u gjen dot shpjegimin. Kënga e personazheve të tij deformohet nga pesha e mjerimit dhe nga forca e kanunit. Këto kanë qenë dy faktorë shtypës të jetës, krijimtarisë (penës) migjeniane dhe realitetit të asaj kohe.

Personazhi i Lukes në fund ndahet me “burrin”, Nushi poroset të motrën të mos mërzitët për faktin se ajo është shtatzënë dhe i bën keq fëmijës, ndonëse mendja e tij punon në fshehtësi për të zbuluar se i kujt është fëmija, Luli hy nën kurorën e martesës së zotnisë së tij, murgësia zhvishej në mendime para Hyjit.

Bibliografia:

(Bihiku, Koço:2004), *Krijimtaria letrare e Migjenit*, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Shtëpia Botuese “Mësonjëtorja”, Tiranë.

(Idrizi, Rinush:1992), *Migjeni*, Shtëpia Botuese Enciklopedike, Tiranë, 1992, f. 141.

(Kryeziu, Resmie:2004), *Migjeni dhe avangarda*, botuar botuar në: “Fenomeni i avangardës në letërsinë shqipe” (Aktet e seminarit shkencor), Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Shtëpia Botuese “Arbëria”, Tiranë, 2004, f. 36.

(Migjeni, Vepra:2002), Shtëpia Botuese “Cetis Tirana”, Slloveni.

(Piégay-Gros, Nathalie:2011), *Poetika e intertekstualitetit*, Shtëpia Botuese “Parnas”, Prishtinë, 2011, f. 107.

(Raifi, Mensur:1979), *Fan S. Noli dhe Migjeni*, Shtëpia Botuese “Rilindja”, Prishtinë.

(Sinani, Shaban:2019), *Migjeni dhe Shkrimet - Monografi*, Shtëpia botuese dhe studio letrare “Naimi”, Tiranë.

(Sinani, Shaban:2019), *Migjeni dhe Shkrimet - Monografi*, Shtëpia botuese dhe studio letrare “Naimi”, Tiranë, 2019, f. 322.

(Zeqo, Moikim:2011), *Migjeni, arkitekti i nëndheshëm i qiellit*, Shtëpia Botuese “Erik”, Tiranë.

ELASTOGRAFIJA DOJKE-INDIKACIJE I MOGUĆNOSTI:

Dr Jasmin Nuković,- OB Novi Pazar
Također, prikupljena su saznanja o komunikacijskom procesu u organizacijama i njegovim osnovnim karakteristikama (usmena, kontaktna, pismena i elektronska komunikacija). Prikupljene informacije iz literature i

posmatranje procesa u kompaniji Prevent-Safety prikazale su i formalnu komunikaciju u organizacijama. Saznanja o problemima u komunikaciji i način njihovog prevladavanja jasno ukazuju da još uvijek nije osmišljen savršen model, vjerovatno nikad neće ni biti zbog mnoštva faktora koji mogu uticati na iskrivljenje informacije/poruke. Svi prikupljeni podaci ukazuju da su definirani osnovni elementi komunikacije u organizacijama čime je potvrđena prva pomoćna hipoteza.

Već duže vrijeme pokušava se jasno definirati model komunikacije koji bi opisao strukturu komunikacijskog procesa. Naučni model komuniciranja definisali su Šanon i Viver koji su kroz koncept statističke transmisije signala šematizovan opis komunikacije. Nakon njih lingvisti i komunikolozi pokušavaju poboljšati ili predložiti nove modele komunikacije (Osgod, Šram, Njukom...). Oni definiraju strukturu komunikacijskog procesa koji počinje izvorom (generiranje poruke) koji potom se enkodira i u vidu signala putem komunikacijskog kanala proslijeđuje do dekodera (koji enkodirani signal dekodira) i proslijeđuje ka destinaciji. U novije vrijeme pojavljuju se i kritičari (Akmajian) koji tvrdi da modeli nisu objasnili ništa suštinsko u procesu komuniciranja među ljudima u organizaciji. Također, istraživanjem je utvrđeno da u organizacijama postoje konflikti te da imaju tri pogleda na konflikt ; Tradicionalni pogled, konflikt kao ljudski odnos i konflikt kao interaktivni odnos. U pogledu vrste konflikata oni mogu biti ; Disfunkcionalan-nizak, Funkcionalna-optimalan i Disfunkcionalan-visok. Ukoliko menadžer želi uspješno da kontroliše i rješava konflikte (sukobe) u organizaciji, potrebno je da na temelju analiza razlikuje tehnike ponašanja, kao što su: konkurentnost, saradnju, izbjegavanje, prilagođavanje i kompromis. Ovo su ujedno i stilovi za rješavanje nefunkcionalnih konflikata, jer je cilj i misija svakog menadžera da ostvari optimalan nivo konfliktne situacije u organizaciji, kako bi se uspjeh ostvario.

Ovim je potvrđena i druga pomoćna hipoteza : Analizom modela komuniciranja, komunikacijskog toka u organizaciji, značaja efektivne komunikacije, konflikata u organizaciji i stilova rješavanja jasno se vidi struktura komuniciranja u kompanijama. Kako su pomoćne hipoteze postavljene i potvrđene s ciljem potvrđivanja radne hipoteze ista je potvrđena. Naučno utemeljenim spoznajama o pojmu komunikacije moguće je jasno utvrditi strukturu komunikacije u kompanijama kao i osnovne elemente komunikacije.

Literatura

Knjige i publikacije

1. Prof. dr. Dževad Šehić, Doc. dr. Zijada Rahimić, Ekonoski fakultet Sarajevo, Sarajevo, 2009. god.
2. Michael J. Rouse, Sandra Rouse, Poslovne komunikacije, MASMEDIA, Zagreb 2005. god.
3. Maja Žitinski, KULTURA POSLOVNOGA KOMUNICIRANJA, Sveučilište u Dubrovniku 2010. god.
4. Fuad Kovač, MA, Komunikologija Skripta.
5. Maja Lamza – Maronić, Jerko Glavaš, Poslovno komuniciranje, Sveučilište J. J. Strossmayera u Osijeku, Osijek 2008. god.
6. Aleksandar Bogdanić, Komunikologija, Komunikološki fakultet u Banja Luci, Banja Luka 2005. god.

GJURMË TË HEBRENJËVE NË RAJONIN E VUSHTRRISË

Mr.sc. Jeton Sallahu - Vushtrri, Republika e Kosovës

Abstract

Study paper entitled “Traces of Jews in the Vushtrri region”, includes the presence of the Jewish ethnos in the Vushtrri region through time. All this explains their acceptance on Albanian soil by the majority population, so the Albanian one, thus reveals at the same time a value of the Albanians, we are talking about accepting variety, and that latter corresponds strongly with the very essence of the European Union.

In fact, the aforementioned region has been enriched with other nationalities, including the Jews. However, today it is difficult to find in this region the presence of the Jewish ethnos, but in the not-so-distant past, they had been on these sides, especially during World War II, being welcomed by the Albanian people, and the latter, although endangered by German forces, had kept Jewish families in their homes.

It is interesting to elaborate on the activity of a Couple of Doctors, that one of them was of the Jewish-male ethnos, while for women we do not know what ethnality belonged to, who had behaved correctly with the Albanian population, while working in the Vushtrri region.

Keywords: Traces of the Jews, Vushtrri Region, Albanians, Diversity, European Union.

Abstrakt

Punimi studimor i titulluar “Gjurmë të hebrenjëve në rajonin e Vushtrrisë”, ngërthen në vete praninë e etnosit hebre në rajonin e Vushtrrisë nëpër kohë. E gjithë kjo shpjegon edhe pranimin e tyre në truallin shqiptar nga popullata shumicë, pra ajo shqiptare, kështojshëm shpërfaqë njëkohëshëm edhe një vlerë të shqiptarëve, fjalën e kemi për pranimin e larushisë, e që kjo e fundit korrespondon fort edhe me vet thelbin e ekzistencës së Bashkimit Evropian.

Ç’është e vërteta, rajoni i sipërpërmendur ka qenë i pasuruar edhe me të tjera kombësi, përfshirë këtu edhe hebrenjtë. Megjithatë, sot është vështirë të gjejmë në këtë rajon prani të etnosit hebre, porse në të kaluarën jo të largët, ata kishin qenë në këto anë, veçanarisht gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke u mirëpritur nga populli shqiptar, e ky i fundit edhe pse i rrezikuar nga forcat gjermane, i kishte ruajtur familjet hebrenje në shtëpitë e tyre.

Është interesant elaborimi i veprimtarisë edhe të një çifti doktorësh, që njeri prej tyre ishte i etnosit hebre-burri, gjersa për gruanë nuk kemi dijeni çfarë etnonacionaliteti i përkiste, të cilët kishin pasur sjellje korrekte me popullatën shqiptare, gjersa punonin në rajonin e Vushtrrisë.

Fjalët çelës: Gjurmë të hebrenjëve, Rajoni i Vushtrrisë, Shqiptarët, Diversiteti, Bashkimi Evropian.⁷⁶

⁷⁶ Abstrakti në gjuhën shqipe është botuar më parë, por jo edhe punimi.

Abstrakti në gjuhën shqipe është botuar në *Book of abstracts* rrjedhur nga konferenca *International Conference, The Perspective of Integration of the Western Balkans into the EU*, (organizuar nga Kolegji AAB, Prishtinë, 2021), p.40.

Prania e etnosit hebre në truallin shqiptar gjatë historisë⁷⁷

Trualli i sotëm i Republikës së Kosovës/Dardanisë antike, përfshirë edhe rajonin e Vushtrisë brenda saj, nga aspekti gjeografik bënë pjesë në qendër të Gadishullit Ballkanik, ndaj me të drejtë studiuesi Zef Mirdita në një punim studimor të tij të titulluar *Ekonomia dhe marrëdhëniet shoqërore në Kosovë në parahistori e deri në antikën e vonë*, thoshte se pozita gjeografike e kësaj treve ka mundësuar që prej kohërave të lashta të vënte ndikime e kryqëzime kulturash të ndryshme, bile duke mos përjashtuar këtu as format e ndryshme ekonomike,⁷⁸ e që edhe komunikacioni në këtë rast ka luajtur një rol të rëndësishëm.⁷⁹ Do të thotë, kjo ka mundësuar jetesën e njerëzve në këto anë qysh në parahistori dhe në periudhat e mëvonshme. Në këtë kuptim, si popullatë e dalur me identitet të krijuar e të dalluar nga të tjerët e që jetonte në antikitet në këto hapësira gjeografike, ishte popullata iliro-dardane, e cila tashmë pranohet në shkencë se është paraardhësja e popullatës së sotme shqiptare. Popullata në fjalë e kohës së antikitetit, siç na e provon studiuesja Edi Shukriu në një studim të saj të titulluar *Shteti i Dardanisë*, kishte krijuar edhe shtetin e mëvetësishëm, Shtetin apo Mbretërinë Dardane, shtet ky që për disa shekuj zhvilloj jetë të pavarur, dhe ishte edhe më i madh territorialisht se Shteti i Kosovës së sotme, siç ka sjellur rezultate për këtë studiuesja Exhlale Dobruna-Saliu përmes punimit të saj të titulluar *Rreth çështjes së ndarjes administrative të Dardanisë në kohën romake*,⁸⁰ gjersa në shekullin e I p.l.k. humbi mëvetësinë e saj pas luftërave të zhvilluara me perandorinë e fuqishme të kohës, fjalën e kemi për Perandorinë Romake, megjithatë, identiteti dardan nuk u tjetërsua, përkundrazi, ai i mbijetoi shekujve, kjo mund të provohet edhe nga ndikimi që kishte ai në emërtimin e njesisë administrative-politike romake, Provincës së Dardanisë.⁸¹ Por, krahas identitetit dominant iliro-dardano-arbnesho-shqiptar, gjatë shekujve në këto anë, kanë jetuar edhe identitete të tjera pakicore, e ndër këto identitete ishte edhe ai hebre, përkundrazi edhe do të thellohem më shumë në këtë trajtesë.

Diku në shekujt e parë të mijëvjeçarit të I, nëse bazohemi tek libri *Rescue in Albania one hundred percent of jews in Albania rescued from Holocaust* të autorit Harvey Sarnier, arkeologët kishin gjetur mbetje të një **sinagoge** në Dardani,⁸² çka tregon për një prezencë të hershme të etnosit hebre në këto anë. Megjithatë, ekzistojnë edhe indikacione të tjera që qojnë shekuj më herët pikëtakimin midis popullatës iliroarbneshore dhe asaj hebreje.⁸³

⁷⁷ Populli shqiptar, gjatë historisë nuk është identifikuar vetëm me emrin *shqiptar*, por ne në titullim përdorim përmbledhtas vetëm atë.

⁷⁸ Zef Mirdita, *Ekonomia dhe marrëdhëniet shoqërore në Kosovë në parahistori e deri në antikën e vonë* në revistën shkencore *Përparimi* 2 (Viti XXIX, Prishtinë, 1983), p.247.

⁷⁹ Mark Krasniqi, *Komunikacioni i vjetër në Kosovë-Metohi* në revistën kulturore *Përparimi* 7-8 (Vjeti II, Prishtinë, korrik-gusht 1957), p.472.

⁸⁰ Exhlale Dobruna-Saliu. *Rreth çështjes së ndarjes administrative të Dardanisë në kohën romake* në përmbledhsin e kumtesave nga konferenca vjetore kombëtare e shkencës *Java e shkencës 2011* (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Departamenti i Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë, korrik 2011), p.p.185-195.

⁸¹ Edi Shukriu, *Shteti i Dardanisë* në revistën *Kosova* 22/23 (Instituti i Historisë, Prishtinë, 2003), p.9.

⁸² Harvey Sarnier, *Rescue in Albania one hundred percent of jews in Albania rescued from Holocaust* (Brunswick press Cathedral City, California, 1997), p.9.

⁸³ Qazim Namani, *Dorëshkrim të dërguar me titullim Migrimet e para hebreje në Gadishullin Ballkanik* (Prishtinë, 2021).

Tutje, studiuesi Atanasije Urosevic në studimin e tij të titulluar *Kosovo*, gjersa fliste për *varrezat ilire*, ai sikur i gërshetonte edhe *varrezat hebreje* në një katund në lindje të Janjevës ?!⁸⁴ Megjithatë, mund të themi se edhe gjatë shekujve të mesjetës, kontaktet midis hebrenjëve njëren anë dhe iliro-arbërorëve në anën tjetër kanë ekzistuar. Kështu, diku rreth **vitet 1170, historiani hebre Beniamini i Tudelës**, gjersa jepte njoftime për hebrenjtë e Ballkanit, thoshte se disa banorë që jetonin në disa vise në malet shqiptare, të cilët nuk ishin të krishterë, fëmijëve të tyre u vinin emra me preardhje hebreje, kjo për faktin se rrjedhnin prej hebrenjëve, e pra edhe i vlerësonin vëllëzër.⁸⁵ Këtej, kah fundi i epokës së mesjetës dhe fillimi i kohës së re, numri i hebrenjëve ka shkuar me gjasë duke u rritur në truallin arbnesho/arnauto-shqiptar, kjo për faktin se çifti mbretëror spanjoll, Ferdinandi dhe Isabela (fundi shekullit XV, e që vazhdoi si dukuri edhe në shekujt vijues, J.S.), në entuziazëm të rritjes së ndikimit të forcës së tyre në Gadishullin Iberik, pastaj rolin në ekspeditat në zbulimet gjeografike, intensifikuan dëbimin e hebrenjëve, dhe myslimanëve të etnoseve të ndryshme, shembull ky që edhe sovran i portugez, Manueli I, e ndoqi. Kjo do të thotë, se Perandoria Osmane, ku tashmë teritoret arbneshoarnauto-shqiptare ishin në kuadër të saj, (megjithëse për një kohë jo të shkurtër, populli arbnesho-shqiptar kishte rezistuar për të mbrojtur truallin e vet...), i mirëpriti hebrenjtë dhe natyrisht myslimanët⁸⁶ e etnoseve të ndryshme. Këtej, ata do të gjejmë të përmendur nëpër burime se ata ishin të pranishëm edhe në rajonin e Vushtrisë/Vuçitërnës, fjala vjen, nëse bazohemi tek Regjistri Kadastral i viteve 1544-1545, pra, shekulli i XVI, aty duke u bërë fjalë për **Sanxhakun e Vuçitërnës, përmendën 6 shtëpi me hebrenjë. Madje, në një dokument, agallarët e bejlerët e Vuçitërnës**, Prishtinës, Shkupit, Prizrenit dhe qyteteve të tjera, përmendën se ishin ankuar tek sulltanit rreth veshjës së hebrenjëve, më saktësisht, rreth veshjës së këtyre të fundit njëjtëshmërisht me myslimanët, do të thotë rrobat e shtrenjëta prej cohe, e që ajo nuk ishte e bollëshme në treg, pra ishte në mungesë, ngase hebrenjtë e pasur i blenin ato, dhe kjo zvogëlonte mundësitë për blerjen e tyre nga të tjerët, më saktë, nga myslimanët.⁸⁷ Nga kjo e dhënë kuptojmë se pavarësisht se në Shtetin Osman hebrenjtë ishin të mirëpritur, megjithatë, popujt që i takonin fesë islame, ishin më të privilegjuar, ndaj edhe këta t'fundit ishin ankuar.

Në shekujt vijues, hebrenjtë vazhdojnë të zihen në gojë nëpër dokumente, si fjala vjen në shekullin e XVII, respektivisht në **Defterin e Manastirit të viteve 1621-1623**, gjersa flitej për qytetin e Manastirit që banohej kryesisht me arnaut/shqiptarë mysliman, porse aty jetonin edhe popullsi të përziera, e pra edhe hebrenjtë. Madje, këto popullsi edhe bashkëpunonin. Ja po e paraqesim një rast ilustrues, që ndërlidhet me dukurinë e huasë. Këtej, Muhamedi kishte marrë borxh 3 akça nga hebreu Selamon, e edhe ky i fundit kishte dëshmuar se do i jepte 3 akçat atij t'parit.⁸⁸

⁸⁴ Atanasije Urosevic, *Kosovo* (Akademia Serbe e Shkencave dhe e Arteve, Beograd, 1965), p.p.19-21.

⁸⁵ Ferit Duka, *Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare studime dhe dokumente* (UET Press, Tiranë, 2009), p.107.

⁸⁶ Ardian Muhaj, *Historia e shpëtimit të hebrenjeve në Shqipëri nuk fillon në Luftën e Dytë Botërore* marrë në *kulturatv.com* (parë për herë të fundit më 27.03.2021). Për më shumë, shih i njëjti autor, në librin *Nga Ballkani në Mesdhe shqiptarët prej mesjetës në agimin e kohës së re* (Tiranë, 2019).

⁸⁷ Emin Pllana, *Vuçitërna me rrethinë nën sundimin osman shekulli XV-XVII* në revisten *Vjetar/Godisnjak XVI-XVII* (Arkivi i Kosovës-Arhiv Kosova, Prishtinë, 1983), p.p.27-42.

⁸⁸ Agron Islami, Ayten Ardel, *Defterët e kadiut osman-sixhilet një dokument i rëndësishëm për historishkrimin e jetës sociale dhe ekonomike të qyteteve shqiptare në shek.15-19-shembulli i Manastirit* në *Kumtesat I shkencat gjuhësore, kulturore dhe historike Java e shkencës* (Ministria e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, Departamenti i Shkencës dhe i Teknologjisë, Prishtinë, 2013), p.p.487-491.

Tutje, në shekujt e mëvonshëm, edhe në **qytetin e Vlorës**, veçanarisht, kishte jo pak hebrenjë, për këtë n'a dëshmon studiuesi Ferit Duka me punimin e tij studimor të titulluar *Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare*.⁸⁹ Pastaj, prezencën e hebrenjëve në shekullin e XIX, mund ta gjejmë edhe në qytete të tjera, si në Shkup, Preshevë, Prizren, Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë, **Vushtrri/Vuçitërnë**, e të tjera.⁹⁰ Interesant është të përmendim faktin se në **Mitrovicë**, që është afër gjeografikisht me Vushtrrinë/Vuçitërnën, hebrenjtë mbanin dyqane manufakturale dhe koloniale, siç duket, kjo ka ndodhur në fillim të shekullit të XX, gjersa kishte pasur lëvizjeje të disa familjeve të hebrenjëve, nga Prishtina, kjo për faktin se në Mitrovicë gjallonin larushi të zejeve.⁹¹ Kështu, gjatë Luftës së Parë Botërore, gjersa kishte pasur shtrirje ndikimi Perandoria Austro-Hungareze, në rajonin e Mitrovicës⁹², Vuçitërnës/Vushtrrisë e në disa pjesë të tjera, u kishte lejuar popujve shkollimin në gjuhën amëtare, këtej edhe shqiptarët paten mundësi të i hapin shkollat në gjuhën shqipe. Këtej, siç duket në këtë kohë, punonte në këto anë një mësimdhënës i gjuhës gjermane e që ishte me origjinë hebreje, fjalën e kemi për **Viktor Kossuton**, kështu së paku mendon studiuesi Limon Rushiti.⁹³ Tutje, gjatë Luftës së Dytë Botërore, por, dhe disa vite para saj, nazistët gjerman kishin shfaqur brutalitetin çnjerëzor, këtu në rend të parë kundër hebrenjëve.⁹⁴ Kështu, edhe në Vuçitërnë/Vushtrri, gjatë viteve të luftës së sapopërmendur, nazistët, apo agjentët nën dërkativat e tyre, e kishin pushkatuar 20 vjeçaren nga Mitrovica, e cila ishte me origjinë hebreje, fjala është për **Melinda Rubenen**, kështu së paku thuhet në një punim të studiuesit Emin Pllana.⁹⁵ Megjithatë, gjatë kësaj kohe, hebrenjtë kanë gjetur strehim te shumë familje shqiptare.

Sjellja “hipokratike” e doktorit hebre Masis Kudjanit me vushtrriasit

Ç’prej kohësh është folur e shkruar se *Historia është mësuese e jetës*. Nëse i analizojmë rrjedhën e ngjarjeve të zhvilluara gjatë historisë, e shohim se postulati i sapopërmendur vështirë se mund të rrëzohet. Këtu në rend të parë mund të referohemi nga *udhëzimet që na kanë lënë autorët antikë*, sikurse fjala vjen, Tukididi, që ky i fundit kujdesej që në veprën e vet,

⁸⁹ Ferit Duka, *opcit*.

⁹⁰ Emin Pllana, *Rregullimi administrativ dhe popullsia e Kosovës mes viteve 1839-1875* në revistën *Vjetar/Godisnjak XXI-XXII* (Arkivi i Kosovës-Arhiv Kosova, Prishtinë, 1986), p.p.35-57; Interesant për këtë çështje është edhe **Elaborati për Vilajetin e Kosovës i vitit 1883**, shkruar nga ushtaraku austrohungarez, Oskar Melceri, për më shumë shih: Faik Mehmeti, *Oskar Melceri, elaborat për Vilajetin e Kosovës 1883* në revistën *Vjetar XXV-XXVI* (Arkivi Kombëtar i Kosovës, Prishtinë, 2001), p.p.139-150.

⁹¹ Grup autorësh, *Mitrovica me rrethina* (Instituti i Historisë së Kosovës në Prishtinë, Instituti i Historisë në Bashkëkohore në Beograd, Këshilli për Botimin e Monografive në Mitrovicë, Mitrovicë, 1979), p.p.80-81.

⁹² Në një dokument të botuar nga studiuesi Jashar Rexhepagiqi, që shpjegonte popullatën në Komunën e Mitrovicës, përmend praninë e 63 herenjëve, për më shumë, shih punimin *Shkollat dhe arësimi në Kosovë gjatë Luftës së Parë Botërore* në revistën *Jehona 10* (Viti X, Shkup, 1971), p.p.63-94.

⁹³ Limon Rushiti, *Gjendja ekonomike dhe politike në Kosovë gjatë Luftës së Parë Botërore* në revistën *Kosova 15* (Instituti i Historisë së Kosovës/Institut za Istoriju Kosova, Prishtinë, 1986), p.p.87-104.

⁹⁴ Danica Ristić, *Hitleri në prizmen e Çerçilit* në revistën *Jehona 10* (Vjeti i VII, Shkup, 1969), p.p.76-88.

⁹⁵ Emin Pllana, *PKJ në Vuçitërnë dhe rrethinë më 1919-1945* në revistën *Vjetar/Godisnjak XVIII-XIX* (Arkivi i Kosovës-Arhiv Kosova, Prishtinë, 1984), p.p.153-181.

Lufta e Peloponezit mos të fuste asnjë fakt të pakontrolluar⁹⁶, apo Lukiani, i cili thoshte se për të shkruar histori, duhet mos mbajtur anë, dhe të vendosët vetëm e vërteta, siç mund të gjejmë tek libri *Vepra të zgjedhura*⁹⁷, e ngjajshëm edhe te veprat e disa autorëve të tjerë. Megjithatë, nëpër periudha të ndryshme të historisë, ka pasur raste tek disa popuj e disa vende, historia është shfrytëzuar për interesa të tyre dhe në dëm të popujve dhe vendeve të tjera. Kjo do të thotë se në kësilloj rastesh, historia është keqpërdorur. Sidoqoftë, nëse marim për bazë, *udhëzimet e autorëve në fillim të përmendur*, vërtet mësojmë shumë gjëra/ngjarje nga e kaluara e të cilat gjëra/ngjarje, kanë përcaktuar edhe ndodhitë e mëvonshme. Këtej, para se të flasim për **doktorin hebre Masis Kudjanin**, që kishte punuar edhe në Vushttri me rrethinë, apo që kishte punuar në Vushttri me rrethinë e ndoshta edhe gjetiu?!, sikur e do rendi të sqarojmë se kush ishte Hipokrati, prej nga rodhi një pjesë e nëntitullit të këtij shkrimit, pra, *sjellja hipokratike*! Veprimtaria e Hipokratit dallohet në fushën e mjekësisë. Njeriu që mendohet se vinte nga ishulli Kos, dhe se jetoi gjatë shekujve V-IV para lindjes së krishtit (jo në të gjitha vitet e shekujve të përmendur), vërtetoi se sëmundjen e shkakton mjedisi ku jeton njeriu, ngase për kohën që po flasim, tek heleno-grekët dhe jo vetëm tek ata, mendohej se hyjnitë kishin fuqi shkaktimi dhe shërimi të sëmundjeve. Me fjalë të tjera, Hipokrati, thoshte se sëmundja ishte tokësore, sikurse edhe shërimi i saj, ndaj edhe me të drejtë, atë e vlerësojnë si vënësi i themeleve të mjekësisë shkencore. Kështu, ishte krijuar edhe një tekst jo i gjatë që duhej të e respektonin të gjithë doktorët pas-hipokratianë, e që kishte të bënte me përgjegjësinë e tyre ndaj pacientëve, duke iu shërbyer të gjithë atyre pa dallim dhe duke respektuar besueshmërinë. Ky tekst njihet me emrin *Betimi i Hipokratit*, megjithëse nuk dihet me saktësi nëse atë e shënoi doktori në fjalë, apo ndokush nga pasardhësit e tij⁹⁸. Sidoqoftë, ky *betim*, kjo *sjellje*, është trashëguar si parim deri në ditët e sotme. Këtej, këtë parim, e aplikonte edhe doktori me origjinë hebreje, e që vepronte në Vushttri me rrethinë, Masis Kudjan. Në fakt, për të kemi hasur para një kohe në një material të pabotuar të historianit të vyeshëm, Bedri Xhemës⁹⁹. Tani vetvetiu shtrohet pyetja, pse është me rendësi të i vëmë ca rreshta shkrimi për një doktor, që thjeshtë kishte respektuar punën e tij?! Rendësia e punës së doktorit në fjalë, nuk qëndron vetëm në atë sa për të evidentuar rolin e doktorëve për popullatën e Vushttrisë me rrethinë, apo për të evidentuar origjinën e një doktori të huaj, në rajonin që posa zëmë në gojë e që banohej e banohej me shqiptarë, pa përjashtuar edhe ndonjë popullsi pakicë në këto anë, por rendësia qëndron në atë se evidenton se në dy-tre dekadat e para të pas Luftës së Dytë Botërore, përkundër asaj se Kosova dominohej me shqiptarë, këta të fundit nuk ishin të barabartë në ish shtetin e atëhershëm, pra në Jugosllavi, do të thotë ata ishin të diskriminuar pothuajse në të gjitha fushat e jetës, përfshirë edhe në atë të mjekësisë. Prandaj, *sjellja* korrekte, apo *hipokratike* e ndonjë doktori me popullatën shqiptare, ishte “lajm”!

⁹⁶ Shih *parathënien* nga Todi Dhama, nga libri i Tuqididit *Lufta e peloponezit* (shqipëruar nga greqishtja Sotir Papakristo, Rilindja, Prishtinë, 1988), p.p.3-15.

⁹⁷ Lukiani, *Vepra të zgjedhura* (përktheu nga origjinali Bujar Doko, Naim Frashëri, Tiranë, 1979), p.p.455-466.

⁹⁸ Për më shumë, shih librin e Jon Balchin *100 shkencëtarët që ndryshuan botën* (përkthyer në gjuhën shqipe nga Latif Ajrullai, Albas, 2017), kurse ne marrë nga www.portalishkollor.al *Hipokrati, sot njihet si babai i mjekësisë* (parë për herë të fundit në muajin gusht të vitit 2020).

⁹⁹ Bedri Xhema, *Material i pabotuar* dhe ende i paemëruar titulli i tij përfundimisht, e që i kushtohet Gjytetit/Dubovcit.

Megjithatë, nga të dhënat që kemi nxjerrë nga terreni¹⁰⁰, apo të dhënat që kemi nxjerrë nga *libri amzë* në Spitalin e Vushtrrisë¹⁰¹, kemi kuptuar se doktorë të huaj (jo shqiptar, jo serb), përveç Kudjanit, dhe shoqes së tij (kësaj të fundit nuk ia dimë etnonacionalitetin, e as emrin, megjithëse disa të dhëna që kemi nxjerrur nga ish anëtarja e organizatës “Kosova Jewish Organization”, Artina Hamitaga, kuptojmë se Masis Kudjani me të shoqen tani jeton në qytetin e Shkupit, dhe emri i saj është **Alisa**¹⁰², por nuk e dimë a është e njejtë grua?!), kishin punuar edhe doktorë të tjerë, e që ndonjeri ndër ta, kishte qenë korrekt në punë, sikurse në ndonjë rast nuk përjashtohet mundësia edhe ndonjë doktor serb të kishte pasur sjellje racionale. Sidoqoftë, nga pala serbe, jo pak nga ta, **kishin sjellje prej arrogance ndaj popullatës shqiptare** të rajonit të Vushtrrisë, dhe pikërisht këtu del në pah korrektësia e doktorit me origjinë hebreje, Kudjanit, madje edhe shoqes së tij.¹⁰³ Për këtë na dëshmojnë edhe të dhënat e mbledhura nga terreni, prej të cilave kuptuam se gjithëherë ka qarkulluar mendimi se **ishte një mjek i mirë jahudi**.¹⁰⁴ Siç dihet, hebrenjët, njihen me emra identifikues të ndryshëm, përfshirë edhe me emërtimet e zëna në gojë (hebre, jahudi), apo edhe me emërtime të tjera, si fjala vjen, çifut, e të tjerë. Prandaj, përmendja nga popullata vushtriase e termit *jahudi*, *çifut*, është i barabartë me termin *hebre*.

Kudjani, gjatë punës së tij në Spitalin e Vushtrrisë, së bashku me të shoqen e tij, përveç që sillej korrekt me pacientët shqiptarë, ai me disa nga ta, kishte pasur raste bisedimi edhe për çështjen e statusit të shqiptarëve, duke shprehur edhe keqardhjen e tij për diskriminimin që iu bëhej shqiptarëve. Njashtu, ai njëkohësisht kishte shprehur edhe simpatinë e tij që kishte për kulturën shqiptare e të cilën e vlerësonte shumë lartë, sikurse që e vlerësonte poaq edhe kulturën hebreje, madje thoshte se këta dy popuj (shqiptarët dhe hebrenjët, respektivisht kultura e tyre), kanë edhe pika të përbashkëta.¹⁰⁵ Këtu mund të kishte qenë fjala edhe për ekzistimin e jetëgjatshëm të kulturave në fjalë, pastaj, sakrificën e dy popujëve gjatë historisë, kontaktet e këtyre dy popujëve, veçanarisht, strehimin që u kishin siguruar hebrenjëve shqiptarët në shtëpitë e tyre gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke mos i dorëzuar tek gjermanët

¹⁰⁰ Këtu po i përmendim disa të moshuar që i kemi intervistuar, e që kishin të bëjnë me mjekësinë në rajonin e Vushtrrisë. Së pari, ish doktori, tani rreth 80 vjeç, Shyqyri Sylja, tregon se ka pasur doktorë të huaj në Vushtri, gjersa për vete thoshte se ishte ndër doktorët më të vjetër në Kosovë. Tutje, vizituam edhe një ish doktor tjetër, tani rreth 75 vjeç, Nezir Selimin, porse nga ai nuk mundëm të nxjerrim shumë material me ndonjë rëndësi. Tutje, me rekomandimin e mjekut Sylja, vizituam ish teknikun e medicinës, i lindur më 1930, i cili u shua pak muajë më parë, fjala është për Hysen Spancen., prej të cilit morëm material më së shumti. Zotëri Spanca përveçse kishte punuar në Vushtri, shkurtas kishte punuar edhe në katundin Dubovc, e që për atje udhëtonte në këmbë, heraherës udhëtonte me kamioneten që barte çmyrë-minierë. Madje, ai kishte punuar edhe në katundin Prelluzhë, që udhëtonte me *Pajton* të paguar nga shteti, nga Vushtria për në tren, dhe përmes këtij të fundit shkonte në Prelluzhë. Ai, tregonte se në Vushtri kishin punuar doktorë të huaj (Vushtri, më 14.12.2019).

¹⁰¹ Në *Librin amzë*, në Spitalin e Vushtrrisë, sot i njohur me emrin “Sheikh Zayed”, me dy punonjëse kërkuam mjekun që e kemi në trajtim, megjithëse atë nuk e hasëm në librin në fjalë, aty hetuam se kishte doktorë të huaj (Vushtri, më 13.12.2019).

¹⁰² Të dhënat janë marrë nga ish anëtarja e organizatës “Kosova Jewish Organization”, Artina Hamitaga (më 02.04.2021).

¹⁰³ Intervistë me historianin Bedri Xhema (Vushtri, më 07.12.2019).

¹⁰⁴ Të dhëna të marra nga banorët e Vushtrrisë, si fjala vjen, nga Mahmut Qirezi, tash e disa vite në pension (më 29.07.2020).

¹⁰⁵ Intervistë, *opcit*.

(përbashto ndonjë rast të izoluar!), ndaj edhe gjatë kësaj kohe ka pasur rritjeje të pranisë së etnonacionalitetit hebre në truallin shqiptar, gjersa në shumë vende të tjera, numri i këtij nacionaliteti zvogëlohej.

Një rast ilustrues për këtë na jep edhe libri i autorit që kishte lindur në Athinë të Greqisë, Jorgos Margaritis, i titulluar *Bashkëpatriotë të padëshiruar, të dhëna mbi shkatërrimin e minoriteteve të Greqisë*, në të cilin libër prezentohej numri i madh i hebrenjëve të vrarë në Evropë, përfshirë edhe në Greqi. Madje autori, vrasjen dhe dëbimin nuk e prezenton vetëm të grekëve dhe shumë të tjerëve ndaj hebrenjëve, por e prezenton edhe vrasjen e dëbimet e shqiptarëve nga Çamëria (Çamët) nga grekët, kështuqë, *qytetërimi evropian*, thotë ai, *nuk duhet kërkuar tek grekët, por tek shqiptarët, ngase Shteti Shqiptar, pas Luftës së Dytë Botërore, kishte mundësi të vepronte ngajshëm me minoritetin grek, siç vepruan grekët me çamët, por ata nuk vepruan njëjloj, nuk vranë as nuk dëbuan minoritetin grek nga Shqipëria Shtetërore, ja pra pse qytetërimi duhet të kërkohej tek pala tjetër, pra tek shqiptarët.*¹⁰⁶

Doktori të cilin e kemi në trajtim, kishte punuar edhe në katundin Gjytet/Dubovc të Vushtrrisë. Në fakt, atje doktorët (shumica serbë) shkonin një apo dy herë në javë, kjo dhe për shkakun se atje ishte përgatitur ambulanca, ngase punohej edhe në minierë, sikurse gatitej *kolonia* për kolonët sllavë.¹⁰⁷ Gjersa numri i doktorëve shqiptarë do të filloj të rritej vetëm kah fillimi i viteve të 70-ta të shekullit që lëmë pas, ngase deri atëherë numri i tyre ishte tejjet modest!

Nga që u tha, mund të konkludojmë se në Vushtri me rrethinë, krahas popullatës shqiptare që ka jetuar përherë, dhe që ishte shumicë përherë, e që vazhdon të jetë e tillë, kanë jetuar edhe etnonacionalitete të tjera, eduke përfshirë këtu edhe hebrenjtë. Këtej, njohja e kontributit të personaliteteve të ndryshme nga këto etnonacionalitete, në rastin tonë të atij me origjinë hebreje, është i rëndësishëm për të kuptuar ndikimin e tyre, në këtë rast, sjelljen korrekte të një doktori me pacientët e tyre, e veçanarisht sjelljen korrekte të tij ndaj popullatës shqiptare.

Disa gjurmë të tjera të hebrenjëve në rajonin e Vushtrrisë

Në rajonin e Vushtrrisë, ekzistojnë edhe disa gjurmë të tjera që provojnë praninë e etnosit hebre gjatë historisë. Këtej, në librin e shkruarit Tihomir Gjergjoviqit të titulluar *Pored Toplice*, gjejmë të dhëna se në **Kodrinën Svaraçak jo larg katundit Samadrexhë/Lumkuq** (Vushtri, J.S.) **kishte pasur varre hebreje**, siç kishin qenë edhe ato në Fushën e Jelenës në rrethin e Moravës, Te Bovani në rrethin e Aleksandrovcit dhe Varret e Masuricës në Mal të Zi¹⁰⁸. Pastaj, në **Varrezat e katundit Çeltinë/Novolan, afër katundit Vërri/Vërnice, të Komunës së Vushtrrisë, një banor nga katundi i fundit i përmendur, thoshte se aty ndodhën dy varre me simbole dielli, të dy personave me origjinë hebreje.**¹⁰⁹

Megjithatë, këtu nevojitet një sqarim. Fjalën e kemi në atë se ekzistenca e simboleve të diellit në varreza, nuk do të thotë se automatikisht se ato janë varre të hebrenjëve, ngase edhe tek popullata shqiptare simbolet e diellit, dhe

¹⁰⁶ Për më shumë, shih Jorgos Margaritis, *Bashkëpatriotë të padëshiruar, të dhëna mbi shkatërrimin e minoriteteve të Greqisë, çamët, hebrenjtë* (Shqipëruar nga origjinali Maklena Nika, Bota shqiptare, Tiranë, 2009), p.p.112-147.

¹⁰⁷ Intervistë, *opcit*.

¹⁰⁸ Ivana Ivançiq, *Në Kosovë, nga Sharri nëpër Kosovë, në Zveçan* (Beograd, 1903), p.132.

¹⁰⁹ Jeton Sallahu, *Çështje nga historia e Vushtrrisë me rrethinë, pjesa e dytë* (Faik Konica, Prishtinë, 2019), p.31.

simbolet e tjera pagane, ishin të pranishme kahmotshëm, ndaj edhe çështja e varrezave që i kemi në trajtim, duhet të shterohet së studiuar, e mandej të nxjerrim një konkluzion përfundimtar se cilës kulturë i përkisnin ato varre. Sidoqoftë, fakti që një banor që gjallonte jo larg varrezave dhe mendonte se ekzistojnë dhe dy varre të herbrenjëve, është interesant. Në këtë drejtim, është me interes të përmendim edhe një rast tjetër, atë se në **Xhaminë e Gazi Alibeut në qytetin e Vushtrrisë, ekzistonte dikur një simbol në formë ylli gjashtëkëndësh, që tradicionalisht vlerësohet si simbol hebre, e të cilin e kishte larguar nga aty kujdestari vullnetar i asaj xhamie, Muharrem Zekiqi. Këtë e kishte bërë para luftës së fundit të zhvilluar në Kosovë.**¹¹⁰ Megjithatë, siç e thamë edhe në rastin paraprak, simbolet e ndryshme me karakter të dikurshëm pagan, duke mos përjashtuar as yllin gjashtëkëndësh, kanë qenë pjesë edhe e kulturës shqiptare, përçka në një punim tjetër kemi folur më zgjerimisht, andaj edhe simboli i hoçur nga xhamia në fjalë, nuk duhet përjashtuari menjëhershëm nga kjo logjikë.¹¹¹

Ekziston edhe një toponim në **katundin Gjytet/Dubovc të Vushtrrisë**, e që ndërlidhet me këtë çështje, fjalën e kemi për toponimin **Vorret e Jahudive**. Madje, këto varre kishin pas ekzistuar deri pas Luftës së Dytë Botërore, kështu mësimdhënësi i asaj ane, Nuhi Sadiku, kishte thënë se *gurët e varreve të jahudive* kishin qenë në formë sëndeku, të futur në dhe pjerrtas përsëgjati, dhe të tilla madje kishin qenë edhe dhjetra sosh. Ngajshëm si zotëri Sadiku, mendonin edhe banorët e tjerë, sikurse fjala vjen, Riza Sadiku, Shefqet Beqiri, e të tjerë.¹¹²

Tutje, në qytetin e Mitrovicës, punonin **disa doktorë me origjinë hebreje**, për këtë dhe doktorët e tjerë johebre të asaj ane, momentalisht është duke hulumtuar mjeku Bajram Preteni. Në mesin e tyre, ishte dalluar edhe një doktor tejet profesionist, humanist i madh, që vizitonte të sëmurët, që jo rrallëherë pacientëve të tij nuk u merrte para për vizitat që i bënin, madje kishte raste se u dhuronte edhe para nga xhepi për ti blerë barnat, për këtë doktor kishte njohuri studiuesi Pajazit Hajzeri, porse nuk ia dinte sigurshëm emrin.¹¹³ Por, neve kuptuam nga një tjetër burim, se fjala është për doktorin **Nehemia Shenfajnin**.¹¹⁴ Kjo do të thotë se edhe shumë qytetar nga rajoni i Vushtrrisë janë mjekuar tek докторi Shenfaj dhe të tjerë koleg e kolege të tij, ngase Mitrovica me Vushtrrinë janë afër gjeografikisht njëra me tjetrën, apo anasjelltas, edhe doktorët nga Mitrovica me gjasa kanë kryer punë profesionale ndonjëherë edhe në rajonin e Vushtrrisë. Madje, një person me emrin **Nauhemije Shenfaj nga Mitrovica**, që nuk e dijmë me siguri se a është i njejtë person me atë që posa folëm më lartë, e gjejmë në një material të pabotuar tek përmendet, se ai, midis dy luftërave botërore, kishte luajtur rol në funksionimin e xehrorëve të magnezit, fjalën e kemi për ndërmarrjen “Drenica”. Njashtu, ekzistonte edhe ndërmarrja tjetër e quajtur “Goleshi”,

¹¹⁰ Ismet Bolukemin, *Monumentet e trashigimisë kulturore të Vushtrrisë* (Prishtinë, 2019), p.23. Ndryshe, libri përveç që është punuar në gjuhën shqipe, ai është punuar edhe në gjuhën turke, për më shumë shih, *Viçitrin kulturë miras eserleri*.

¹¹¹ Ibid; Zotëri Bylykëmini e kishte hasur yllin gjashtëkëndësh edhe në flamurin e aziatikëve Karamanlinjë, familje nga të cilët në kohën e osmanlinjëve, mund të kenë qenë të pranishëm edhe në Vushtri.

¹¹² Jeton Sallahu, Burim Rexhepi, Bedri Xhema, Zahir Kastrati, *Çështje nga historia e Vushtrrisë me rrethinë deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, pjesa e parë* (Faik Konica, Prishtinë, 2017), p.166.

¹¹³ Të dhëna të marra nga studiuesi Pajazit Hajzeri, përçka i jemi falënderues (Mitrovicë, 29.08.2020).

¹¹⁴ Të dhënat për karakteristikat e mjekut hebre Nehemia Shenfaj na u dhuruan nga докторi Bajram Preteni, përçka i jemi falënderues (Mitrovicë, 03.09.2020).

e të cilat të dyja sëbashku gjeografikisht ndodhën në krahinën e Drenicës, porse administrativisht ndonjëherë ndërlidheshin edhe me Komunën e Vushtrrisë, në fakt kjo vlenë më shumë për ndërmarrjen “Drenica”.¹¹⁵

Duke pasur parasysh gjithë ç’u tha deri këtu, sikur mund të vijmë në përfundim se hebrenjtë kanë qenë të pranishëm në truallin shqiptar gjatë historisë, kjo do të thotë se as rajoni i Vushtrrisë nuk bënë përjashtim. Atëherë, kjo tregon njëkohësisht edhe një vlerë të shqiptarëve, atë se ky popull nuk ka pasur e as nuk ka gjë kundër gjallimit të popujve të tjerë, madje, ai jo vetëm pranon ata, por, është i prirur të bashkëjetoj me ta miqësisht, e në rast nevojë edhe ti dal në ndihmë, siç ishte rasti gjatë Luftës së Dytë Botërore. Këtëj, Shteti i Kosovës, duke qenë formuar nga faktori vendës dhe me ndihmen e atij ndërkombëtar, ka krijuar ligjshmëri të pasur rreth respektimit të të drejtave të minoriteteve dhe të kombësive të tjera më të imëta, madje në këtë aspekt, jo pak njohës të kësaj fushe, kanë konkluduar se **Republika e Kosovës është model**. E kur të kemi parasysh faktin se Shteti i Kosovës dhe Shteti i Izraelit pak kohë më parë kanë njohur njëra tjetrën, kjo hap një shteg të ri të bashkëpunimit të këtyre dy vendeve, po aq sa të gjetjeve të gjurmëve të tjera të bashkëpunimit të këtyre dy popujve gjatë historisë, shqiptarëve dhe hebrenjëve.

Për të përfunduar, duke pasur parasysh se baza e krijimit të Bashkimit Evropian është **pranimi i diversiteteve**, mund të themi me plotë gojë se shtetet, Kosova dhe Shqipëria, në radhë të parë, përmbushin kënaqshëm kriterin e pranimit të dallueshmërisë, ndaj edhe nevojitet nga ana e Unionit që për këto dy vende të bëjë hapa më të shpejtë integrujes. Kjo gjë, njëkohësisht, do ta thellonte mëtej paqen në vendet e Ballkanit dhe jo vetëm.

To conclude, bearing in mind that the basis of the creation of the European Union is the **acceptance of diversities**, we can say with full mouth that the states, Kosova and Albania, in the first place, satisfactorily fulfill the criterion of acceptance of distinctiveness, so it is also necessary from the of the Union to take faster integration steps for these two countries. This thing, at the same time, would further deepen the peace in the Balkan countries and not only.

¹¹⁵ Bedri Xhema, *Material...* opcit.

Burimet dhe literatura

I. Burimet e pabotuara

- Institucione

1. Komuna e Vushtrrisë, [2019], Vushtri.
2. Spitali “Sheikh Zayed”, [2019], Libri amzë, Vushtri.

- Organizata

1. “Kosova Jewish Organization”, [2021], Prishtinë.

- Materiale shkrimore

1. Hajzeri, Pajazit, [2020], Materiale rreth një doktori hebre, Mitrovicë.
2. Namani, Qazim, [2021], Dorëshkrim i titulluar Migrimet e para hebreje në Gadishullin Ballkanik, Prishtinë.
3. Preteni, Bajram, [2020], Materiale rreth doktorit hebre Nehemia Shenfaj, Mitrovicë.
4. Qirezi, Mahmut, [2020], Materiale rreth doktorit jahudi, Vushtri.
5. Xhema, Bedri, [2019], Material i pabotuar dhe i paemërtuar që i kushtohet Gjytetit/Dubovcit, Vushtri.

- Intervista

1. Selimi, Nezir, [2019], Vushtri.
2. Spanca, Hysen, [2019], Vushtri.
3. Sylja, Shyqyri, [2019], Vushtri.
4. Xhema, Bedri, [2019], Vushtri.

II. Burimet e botuara

-Literatura

1. Bolukemin, Ismet, [2019], Monumentet e trashigimisë kulturore të Vushtrrisë, Prishtinë.
2. Duka, Ferit, [2009], Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare, Tiranë.
3. Grup autorësh, [1979], Mitrovica me rrethina, Mitrovicë.
4. Ivançiq, Ivana, [1903], Në Kosovë, nga Sharri nëpër Kosovë, në Zveçan, Beograd.

5. Lukiani, [1979], Vepra të zgjedhura, Tiranë.
6. Margaritis, Jorgos, [2009], Bashkëpatriotë të padëshiruar, të dhëna mbi shkatërrimin e minoriteteve të Greqisë, çamët, hebrenjtë, Tiranë.
7. Sarnier, Harvey, [1997], Rescue in Albania one hundred percent of jews in Albania rescued from Holocaust, California.
8. Sallahu Jeton, Rexhepi Burim, Xhema Bedri, Kastrati Zahir, [2017], Çështje nga historia e Vushtrrisë me rrethinë deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, pjesa e parë, Prishtinë.
9. Sallahu, Jeton, [2019], Çështje nga historia e Vushtrrisë me rrethinë, pjesa e dytë, Prishtinë.
10. Sallahu, Jeton, [2021], Abstrakti, Gjurmë të hebrenjëve në rajonin e Vushtrrisë në “Book of abstracts”, Prishtinë.
11. Tuqididi, [1988], Lufta e Peloponezit, Prishtinë.
12. Uroseviç, Atanasije, [1965], Kosovo, Beograd.

- Revistat dhe përmbledhset nga konferencat shkencore

1. Dobruna Exhlale-Saliu, [2011], Rreth çështjes së ndarjes administrative të Dardanisë në kohën romake në përmbledhsin “Java e shkencës”, Prishtinë.
2. Islami Agron, Ardel Ayten, [2013], Defterët e kadiut osman-sixhilet një dokument i rendësishëm për historishkrimin e jetës sociale të qyteteve shqiptare të shek.15-19-shembulli i Manastirit në përmbledhsin “Java e shkencës”, Prishtinë.
3. Krasniqi, Mark, [1957], Komunikacioni i vjetër në Kosovë-Metohi në revisten “Përparimi”, 7-8, Prishtinë.
4. Mirdita, Zef, [1983], Ekonomia dhe marrëdhëniet shoqërore në Kosovë në parahistori e deri në antikën e vonë në revisten “Përparimi”, 2, Prishtinë.
5. Mehmeti, Faik, [2001], Oskar Merceli, elaborat për Vilajetin e Kosovës 1883 në revisten “Vjetar” XXV-XXVI, Prishtinë.
6. Pllana, Emin, [1983], Vuçitërna me rrethinë nën sundimin osman shekulli XV-XVII në revisten “Vjetar”, XVI-XVII, Prishtinë.
7. Pllana, Emin, [1986], Rregullimi administrativ dhe popullsia e Kosovës mes viteve 1839-1875 në revisten “Vjetar”, XXI-XXII, Prishtinë.
8. Pllana, Emin, [1984], PKJ në Vuçitërnë dhe rrethinë më 1919-1945 në revisten “Vjetar”, XVIII-XIX, Prishtinë.
9. Rexhepagiqi, Jashar, [1971], Shkollat dhe arësimi në Kosovë gjatë Luftës së Parë Botërore në revisten “Jehona”, 10, Shkup.

10. Ristiq, Danica, [1969], Hitleri në prizmën e Çerçilit në revisten “Jehona”, 10, Shkup.
11. Rushiti, Limon, [1986], Gjendja ekonomike dhe politike në Kosovë gjatë Luftës së Parë Botërore në revisten “Kosova”, 15, Prishtinë.
12. Shukriu, Edi, [2003], Shteti i Dardanisë në revisten “Kosova”, 22-23, Prishtinë.

- Interneti

1. Muhaj, Ardian, Historia e shpëtimit të hebrenjeve në Shqipëri nuk fillon në Luftën e Dytë Botërore, marrë në “kulturatv.com”.
2. Hipokrati sot njihet si babai i mjekësisë, marrë nga www.portalishkollor.al.

HISTORIKU I LUNDRIMIT NË LIQENIN E SHKODRËS

Hajrullah Hajdari

Abstrakt

Liçeni i Shkodrës është për shumë çka unik dhe liçeni më i madh në Ballkan. Nëpërmjet lumit Buna ruan kontaktin me detin Adriatik, pavarësisht nga zinxhiri i maleve të larta që e rrethojnë. Dy të tretat (2/3) e liçenit të Shkodrës i përket Malit të Zi, ndërsa një e treta (1/3) Republikës së Shqipërisë. Mendohet se ka origjinë tektonike-karstike. Për shkak të karakteristikave të tij liçeni është quajtur "Balta" e më vonë edhe "Blato". Gjatë shekujve liçeni i Shkodrës ishte në pronësi të ilirëve, romakëve, bizantinëve, serbëve e malazezëve, venedikasve, turqve e të tjerëve dhe normalisht nga të njëjtin është shfrytëzuar.

Liçenit të Shkodrës, sidomos për banorët që jetonin në brigjet e tij, që në lashtësi konsiderohej si burim i jetës. Përveçqë liçeni shërbente për peshkim, i tërë transporti i mallrave dhe njëzëve bëhej mbi ujë sidomos deri kur filluan të ndërtohen rrugët tokësore.

*Në liçenin e Shkodrës kanë qarkulluar tipe të ndryshme të mjeteve lundruese: **Lundra, lundrica, takja dhe suli.***

Lundrimi në liçenin e Shkodrës është i vjetër sa edhe sa vet liçeni. Ilirët si banorë të parë të zonave për rreth e rrotul liçenit lundronin nëpër liçenin e Shkodrës me mjetet primitive lundruese të kohës. Kushtet normale për shfrytëzimin e liçenit për nevojat ekonomike të banorëve u krijuan me nënshkrimin e marrëveshje për armëpushim në mes Malit të Zi dhe Turqisë në vitin 1862. Liçeni i Shkodrës ishte më rëndësi jetike për Malin e Zi sepse Shkodra ishte qendra kryesore për furnizim të malazezëve me artikuj ushqimor dhe industrial. Nga ana tjetër si në Shkodër po ashtu edhe në Cetinë ishin të vendosura përfaqësit diplomatike të shumë shteteve sidomos të Fuqive të Mëdha Evropiane. Nisur nga kjo, pa pritur shumë, Mali i Zi filloi organizimin e lundrimit të organizuar në mes të Shkodrës dhe Rijekës.

Dallojmë tri faza të zhvillimit të lundrimit në liçenin e Shkodrës: 1. Lundrimi para Kongresit të Berlinit, 2. Lundrimi pas Kongresit të Berlinit dhe 3. Lundrimi gjatë shtetit Jugosllav.

Mendohet se lundrimi i organizuar në relacionin Rijeka Crnojeviq – Shkodër filloi në vitin 1885. Deri në vitin 1948 anijet lundronin disa herë në javë në relacionin Rijeka Crnojeviq – Shkodër dhe anasjelltas me ndalim në Muriq, Sjerç, Ostros dhe Skje. (Krajë). Pas viti 1948 komunikacioni me Shkodrën ndërpritet. Përfundimisht nga viti 1981 lundrimi i organizuar i transportimit të njerzëve dhe mallrave në liçenin e Shkodrës, pas 96 viteve, u ndërpre dhe i takon të kaluarës.

FJALËT KYÇE: *Liçeni i Shkodrës, lundrimi, Rijeka Crnojeviq, Vir Pazar, Muriq, Sjerç, Ostros, Skje, Krajë, Shkodër, lundra, lundricë, sulë, avulllore, anije.*

Abstract

Lake Shkodra is for many reasons unique and the largest lake in the Balkans. Through the Buna River, it maintains contact with the Adriatic Sea, despite the chain of high mountains that surround it. Two thirds (2/3) of Lake Shkodra belong to Montenegro, while one third (1/3) belongs to the Republic of Albania. It is thought to have a tectonic-karst origin. Because of its characteristics, the lake was called "Balta" and later "Blato". Over the centuries, the lake of Shkodra was owned by the Illyrians, Romans, Byzantines, Serbians and Montenegrins, Venetians, Turks and others and was normally used by them.

Lake Shkodra, especially for the residents who lived on its shores, which in ancient times was considered a source of life. In addition to the fact that the lake was used for fishing, all the transportation of goods and people was done on water, especially until land roads were built.

*In Shkodra lake, various types of watercraft have circulated: **Lundra, lundrica, takja and suli.***

Sailing on the lake of Shkodra is as old as the lake itself. The Illyrians, as the first inhabitants of the areas around the lake, navigated through the lake of Shkodra with the primitive navigational tools of the time. The normal conditions for the use of the lake for the economic needs of the inhabitants were created with the signing of the armistice agreement between Montenegro and Turkey in 1862. Lake Shkodra was of vital importance for Montenegro because Shkodra was the main supply center for the Montenegrins. with food and industrial items. On the other hand, both in Shkodër and in Cetina, the diplomatic representatives of many countries, especially of the Great European Powers,

were stationed. Based on this, without waiting long, Montenegro started organizing the organized cruise between Shkodra and Rijeka.

We distinguish three phases of the development of sailing in Lake Shkodra: 1. Sailing before the Berlin Congress, 2. Sailing after the Berlin Congress and 3. Sailing during the Yugoslav state.

It is thought that organized sailing on the Rijeka Crnojevic - Shkodër route began in 1885. Until 1948, ships sailed several times a week on the Rijeka Crnojevic - Shkodër route and vice versa with stops in Muric, Sjerç, Ostros and Skje. (Kraje). After 1948, communication with Shkodra was interrupted. Finally, from 1981, the organized navigation of transporting people and goods in the lake of Shkodra, after 96 years, was stopped and belongs to the past.

KEY WORDS: Lake Shkodra, sailing, Rijeka Crnojevic, Vir Pazar, Muric, Sjerç, Ostros, Skje, Kraje, Shkodër, boat, boat, seal, steamer, ship.

Mbi origjinën e liqenit të Shkodrës

Mbi origjinën e liqenit të Shkodrës ekzistojnë mendime të ndryshme. Mendohet se ka origjinë tektonike-karstike dhe bën pjesë në liqenet poligjenë. Disa studiues mendojnë se liqeni ka qenë gji i detit Adriatik. Më vonë me krijimin e malit Rumia gjiri është ndarë nga deti dhe shndërruar në liqen. Në krijimin e tij, liqeni ka qenë i cektë dhe e quanin moçal apo baltë dhe për këtë arsye në lashtësi është quajtur “Palus Labeatis”. Historiani romak Tit Livi po ashtu e quan moçal, e duke u bazuar në faktin se për rreth liqenit të Shkodrës jetonte fisi i Labeateve e quan “Labeatide palude”.¹¹⁶ Emrin “Balta” për liqenin e Shkodrës për herë të parë e gjejmë në dorëshkrimet e pop Duklaninit¹¹⁷ e kjo dëshmon se rreth e rrotull të këtij liqeni, që në lashtësi kanë jetuar shqiptarët. Ndërkaq, në kristovulat e mbretit Vladislav shenohet si “Blato” (1234).¹¹⁸

Liqeni kufizohet, në verilindje me Bjeshkët e Nemura, në jug e juglindje me malet Tarabash, Rumia dhe Sutorman, ndërsa në veri shtrihet Rrafshira e Zetës. Në nivel të ultët të ujit sipërfaqja e liqenit është 369,74 km katror prej të cilave Shqiperisë i takojnë 2/5 ose 147,72 km, ndërsa pjesa tjetër (3/5) i takojnë Malit të Zi. Pjesa më e madhe e sipërfaqës së liqenit të Shkodrës gjendet 6 m mbi nivelin e detit, ndërsa një pjesë e fundit të tij është edhe në nivelin e detit, kështu që thellësia mesatare më e madhe është 7 m. ndërsa në disa vende të ashaquajtura “syena” thellësia arrinë deri në 44m. Liqeni është i gjatë 44 km. ndërsa gjërësia rreth 12,5 km.¹¹⁹ Në liqenin e Shkodrës, kryesisht në pjesën që i takon Malit të Zi, ekzistojnë rreth 50 ujdhesa të vogla apo të mëdhe. Në disa prej tyre, që në Mesjetë, janë ndërtuar objekte të ndryshme sakrale dhe përbëjnë një pjesë të historisë dhe kulturës tonë, ndonëse sot ato janë zaptuar nga Kisha Ortodokse Serbe.

- Fillet e lundrimit

Gjatë shekujve liqeni i Shkodrës ishte në pronësi të ilirëve, romakëve, bizantinëve, serbëve e malazezëve, venedikasve, turqve e të tjerëve. Ka dëshmi të shkruara se në kohërat më të hershme nëpër liqenin e Shkodrës kanë lundruar mjetet lundruese bizantine dhe venedikase (galija) apo veloret turke (otomane) kryesisht të vogla të cilat kanë mundur të hynin në liqen nga lumi Buna.

Shënimet e para të shkruara për lundrimin në liqenin e Shkodrës, datojnë që në vitin 167 para erës së re (sipas Tit Livit)¹²⁰, kur mbreti ilir Genci, i cili në atë kohë sundonte në këto vise, gjatë luftës së dytë iliro-romake, kishte lundruar nëpër liqenin e Shkodrës. Pra, lundrimi në liqenin e Shkodrës është po aq i vjetër sa edhe vetë liqeni.

Marijan Bolica, duke e përshkruar Sanxhakun e Shkodrës, 1614, shkruan se piratët ulqinakë, pas okupimit të Shkodrës dhe rrethinës së saj nga turqit më 1474, hynë në liqen nëpër mes Bunës më lundra dhe fregata.

Duhet theksuar se pas rënjes së Zetës (1499) deri në vitin 1862 e veçanërisht deri në Kongresin e Berlinit (1878), afër 380 vite, malazezët nuk patën mundësi të shfrytëzonin liqenin normalish, sepse liqeni mbikqyrej nga forcat turke. Ndërkaqë, banorët shqiptarë, që jetonin në brigjet e liqenit lundronin pa ndonjë kufizim të veçantë. Shfrytëzimi i liqenit për malazezët, përveç se ka qenë i rrezikshëm ka qenë edhe vend i konfliktëve të përgjakshme me turqit, sepse malazezët nuk kanë luftuar vetëm për t'u liruar nga okupuesi, por edhe për përvetësimin e tërësishëm të liqenit të Shkodrës, nëpër mes të cilit tentonin daljen në det. Vlladika (Peshkopi) Danillo Petroviqi, në vitin 1717¹²¹

¹¹⁶ Tit Livije, XLIV, fq.37

¹¹⁷ F.Šišić, Ljetopis popa Dukljanina, Beograd, Zagreb, 1928, fq.330,455

¹¹⁸ Jovi[evi] A. Skadarsko jezero I ribolov na njemu, SKA, knj.7, SEZ, knj. XIII, Beograd 1909, fq.163

¹¹⁹ Ippen Theodor, Scutari und die Nordalbanische Kilstenebene, Sarajevo, 1907, fq.6

¹²⁰ Tit Livije, vepër e përmendur, fq.31

¹²¹ Mijušković S. Prvi brodovi pod crnogorskom zastavo, zapisiknj. XII, 1956, dok.318

kishte kërkuar nga autoritetet veneciane që ta zaptonin liqenin e Shkodrës dhe për këtë dëshirë të tyre kërkoj dy galije me nga gjashtëmbdhjetë (16) rrema. Pasi kjo kërkesë nuk u realizua, vlladika Petar I tentoi që këtë ëndërr të tyre ta realizojë me ndihmën e Rusisë cariste. Ai në vitin 1778 dërgoi Nikolla Davidoviqin që t'i propozonte carit Aleksandri i I që të zaptohej Shkodra dhe liqeni i Shkodrës. Megjithatë, e gjithë kjo dëshirë dhe aktivitet i malazezëve për të mbizotëruar me liqenin e Shkodrës do të mbetet i paarritshëm deri në Kongresin e Berlinit.

Shqiptarët mjetet e lundrimit shpeshherë i kanë përdorur edhe si mjete mbrojtëse nga okupatorët e ndryshëm. Është e njohur ndihma e shkodranëve, ulqinakëve e kranjanëve të cilët me mjetet lundruese u erdhën në ndihmë popullsisë së Muriqit, Shestanit apo Oso Kukës në luftën e Vraninës (1861,1862) duke luftuar kundër malazezëve. Dy vite më vonë, malazezët kishin bërë plan për të sulmuar, grabitur e plaçkitur përseri Krajën. Rrenoja e kishës së Marashnikut ishin mbushur me malazezë të cilët pritnin momentin për të sulmuar e plaçkitë Blacën e Boboshtin e fshatrat tjerë të Krajës. Mbrojtja më e mirë ishte nga uji sepse sikur të lejoheshin malazezët të dilnin në tokë, mbrojtja do të ishte më e vështirë. Për këtë qëllim e sjellin me lundër nga Shkodra trimin Adem Boboshti i cili u vërsul fuqishëm ndaj malazezëve të fortifikuar në kishë. Gojdhënat thonë se ai me shpatën e tij preu shumë prej tyre, një pjesë për të shpetuar u hodhën në liqen nga të cilët shumica u mbytën. Ndërkaq, vet malazezët në muret e kishës kanë vëndosur një pllakë përkujtimore ku janë të shënuar vetëm 3 persona të cilët, sipas tyre, kanë rënë trimërisht në mbrojtjen e Marashnikut!

Liqenin të Shkodrës, sidomos për banorët që jetonin në brigjet e tij, që në lashtësi konsiderohej si burim i jetës. Përveçqë liqeni shërbente për peshkim, i tërë transporti i mallrave dhe njerëzve bëhej mbi ujë sidomos deri kur filluan të ndërtohen rrugët tokësore. Për banorët e fshatrave të Shestanit, Muriqit, Boboshtit, Martiqit, Arbneshtit e Skjes mjeti i lundrimit ishte shumë i domosdoshëm ashtu si ishte gomari, kali apo qerre në fshatrat e tokës . Duhet theksuar se edhe fshatrat e tjera të Krajës si Ostrosi, Kështënja, Ftjani e Ljarja e kanë shfrytëzuar liqenin për transportin e njerëzve dhe mallrave.

- **Tipet e ndryshme të mjeteve lundruese**

Në liqenin e Shkodrës kanë qarkulluar tipe të ndryshme të mjeteve lundruese. Ilirët në brigjet e liqenit të Shkodrës ndërtonin e meremetonin mjetet e tyre të lundrimit. Përmendet se mbreti ilir Genci, i kishte ndërtuar përnjëherë 54 lembe¹²². Lembe ilire kishte fund të rrafshtë, i cektë dhe mund të lundronte edhe në cekina. Lemba ka mund të transportoj deri në 50 njerëz çka na bënë të mendojmë se marina ilire ka mund të transportoj deri në 10.000 ushtarë.¹²³

Fillimisht banorët lokal për lundrim kanë përdorur mjete primitive lundrimi. Mendohet se mjeti i parë lundrues ka qenë trapi. Ai ishte mjet i thjeshtë lundrimi, i ndërtuar zakonisht me trungje të lehtë mbi të cilat mbërthehen dërrasa që formojnë një tërësi të gjerë. Ky mjet lundrues ishte shumë i papërshtatshëm sidomos kur bënte mot i keq dhe frynte erë e madhe. Banorët kishin nevojë për mjet lundrues më të qëndrueshëm sepse kishin nevojë për transportin e prodhimeve bujqësore, mallrave e sidomos për transportimin e bagëtive në livadhe dhe për këtë arsye filloi ndërtimi i mjeteve lundruese të tipit që disa edhe sot lundrojnë në liqenin e Shkodrës.

Na janë të njohura këto tipe të mjeteve lundruese: **Lundra, lundrica, takja dhe suli**. Dallojnë nga njëra tjetra për nga gjatësia, gjërësi, lartësia dhe fuqia bartëse.

Këto mjete lundruese kryesisht ndërtoheshin nga dërrasat dhe fundi i tyre është nga një pjesë dhe i rrafshtë. Për ndërtimin e tyre përdorëshin drunjtë që rriteshin në brigjet e liqenit, sidomos gështënja, mani, faleta por edhe lisi. Me zhvillimin e tregtisë dhe hapjes së rrugëve tokësore për fundin e mjeteve lundruese përdorej druri i çamit (bredhit) pasi është më i rezistueshëm nga uji. Të gjitha mjetet e përmendura lundruese vesheshin në levizje me ndihmën e rremave nderësa më vonë u paraqiten edhe lundrat me vela. Velat, ndonëse më rrallë i përdornin edhe sulet. Në gjysmën e dytë të shekullit XX, sidomos sulet, vehen në lëvizje me motor të quajtura “penta” me 4 KF . Nga tipet e përmendura të mjeteve lundruese në liqenin e Shkodrës, i ka rezistuar kohës vetëm suli, i cili kryesisht sot shërben vetëm për peshkim. Mjetet tjera i takojnë të kaluarës.

Për ndërtimin e mjeteve lundruese në liqenin e Shkodrës nuk ka pasur puntori të organizuara apo fabrika. Ato ndërtoheshin nga mjeshtrat lokal të Shirokës, Krajës e më vonë edhe të Ceklinjanëve.

Sidoqoftë, këto mjete primitive lundruese kanë luajtur rol të rëndësishëm në jetën ekonomike të banorëve për gjatë bregut të liqenit të Shkodrës por edhe në mbrojtjen e nga sulmet e sunduesëve e zaptuesëve të ndryshëm ndër shekuj, sidomos nga sulmet, grabitjet dhe plaçkitjet e malazezëve.

¹²² Tit Livije, vepër e përmendur;

¹²³ Slobodan Čukić, Skadarsko jezero u svjetlu otkrića ostataka ilirskih bodova u Hutovom blatu (Montenegrina- arkelologija)

- **Historiku i lundrimit**

Siç dihet, fshatrat buzë liqenit të Shkodrës, nga Shkodra deri në Vraninë, apo nga Hani i Hotit deri në Planicë kanë qenë dhe janë të banuar kryesisht me shqiptarë, çka nënkupton se pjesa më e madhe e shfrytëzuesëve të liqenit që nga koha e Ilirisë e deri më sot kanë qenë shqiptarët. Megjithatë historiografia shqiptare kësaj çështje më rëndësi për jetën e banorëve të këtyre zonave nuk i ka kushtuar kujdes të duhur. Nga studiuesit shqiptar për lundrimin apo historikun e lundrimit në liqenin e Shkodrës kemi shumë pak punime apo studime të mirëfillta. Madje, edhe në ato punime të pakta, për pjesën e liqenit që i takon Malit të Zi përdorin terminologjinë sllave. Kështu përsëherë në “Gazeta Telegraf” në rubrikën “kulturë” më 20 qershor 2017, autori duke folur për formën, madhësinë dhe thellësinë e liqenit shpjegon se “pasi nuk disponojmë me literaturë të autorëve shqiptarë, emrat e ishujve e gadishujve do t’i shkruajmë në gjuhën sllave”!

Ndërkaq, historiografia malazeze lundrimit në liqenin e Shkodrës i ka kushtuar kujdes të veçantë dhe janë publikuar shumë punime shkencore për tërë sipërfaqën e liqenit, pa marrë parasysh se ai takon Malit të Zi apo Shqipërisë!

- **Lundrimi para Kongresit të Berlinit**

Mjetet lundruese në liqenin e Shkodrës kanë shërbyer jo vetëm për peshkim, transportimin e njerëzve dhe mallrave por edhe për qëllime luftarake. Malazezët kryesisht deri në vitin 1862, mjetet lundruese i kanë përdorur për qëllime luftarake me qëllim të vënjes nën kontroll nga ana e tyre, pra për të zaptuar liqeni në tërësi me qëllimin përfundimtar zaptimin e ëndrrës së tyre Shkodrën. Ndërkaq, shqiptarët mjetet lundruese i kanë përdorur për tu mbrojtur nga sulmet dhe grabitjet e malazezëve. Në këtë punim do të flasim vetëm për lundrimin e organizuar dhe mjetet lundruese të përdorura për transportimin e njerëzve dhe mallrave.

Lundrimi në liqenin e Shkodrës është i vjetër sa edhe sa vet liqeni. Ilirët si banorë të parë të zonave për rreth e rrotul liqenit lundronin nëpër liqenin e Shkodrës me mjetet primitive lundruese të kohës. Mbreti ilir Genci për lundrim kishte përdorur mjetet e quajtura “lembe”.¹²⁴ Edhe Balshajt¹²⁵, me galijat e tyre që i blenin në Venedik apo Raguzë, një kohë të gjatë kanë lundruar nëpër liqenin e Shkodrës, por nuk ka pasur transport të organizuar. Gjatë sundimit të Republikës së Venedikut në këto troje po ashtu nuk ka pasur transport të organizuar të njerëzve dhe mallrave. Pas rënjes së shtetit të Zetës (1499) liqeni dhe shfrytëzimi i tij kaloi në duar të Perandorisë Osmane. Perandoria Osmane, pothuajse liqenin e përdornin për qëllimet ushtarake e shumë pak për nevojat e transportit për nevojat e banorëve. Në këtë kohë lundrimi për banorët ishte i vështirësuar dhe i rrezikshëm ngase malazezët vazhdimisht sulmonin avulloret turke që qarkullonin nëpër liqen. Për shkak të sulmeve të shpeshta të malazezëve, në anën e Shestanit dhe Krajës, buzë liqenit u ndërtuan kulla mbrojtëse, në të cilat ditë e natë jepej kujdestari. Kullat u ndërtuan në vaun e Gjuraçit, Muriqit, Maçilukës, Boboshtit, Sjerçit, vanit të Fikut, Shitarit, Arbneshtit dhe Skjes.¹²⁶ Për shkaqe sigurie, kur në vitin 1858 anglezi Wingfield duhej të shkonte nga Shkodra në Cetinë, nëpërmes Rijeka Crnojeviqit,¹²⁷ së pari iu desht të kërkojë lenjen e pashës në Shkodër e pastaj t’i lajmërohet begut, komandantit të ishullit të Lesendrës. Nga Shkodra u nisë me një lundër me 4 rrema nën përcjelljen e një zezaku. Pastaj begu e lejoi që të shkojë në ishullin e Vraninës. Nga Vranina deri në Rijekë shkoi me një sulë, ku rremaxhitë ishin femra.¹²⁸

Kushtet normale për shfrytëzimin e liqenit për nevojat ekonomike të banorëve u krijuan me nënshkrimin e marrëveshje për armëpushim në mes Malit të Zi dhe Turqisë në vitin 1862. Pavle Rovinski konstaton se lundrat që princi Nikolla u kishte blerë 11 vëllazërive të Ceklinjanëve¹²⁹ shërbenin për transportin e mallrave në relacionin Rijeka -Shkodër, Sinjac-Shkodër dhe Planicë-Shkodër, pasi Shkodra ishte qendra kryesore tregtare e Shqipërisë Veriore dhe Malit të Zi. Ky lloj lundrimi ishte i vështirë dhe merrte shumë kohë pasi lundrat leviznin me fuqin njerzore (me rrema). Megjithatë një lundër malazeze gjatë vitit 1863, çdo të shtundë kryente shërbimin postar dhe transportin e mallrave nga Shkodra për Rijekë nga se i gjithë furnizimi i familjes princore bëhej në Shkodër. Me paraqitjen e avullorëve (anije me avull) u krijuan kushtet për zhvillimin e transportit për qëllime ekonomike. Konsulli malazez në Shkodër, P. Pejoviq, më 25 janar 1871 i dërgon princit Nikolla kushtet dhe tarifat e një vaporri që do të vinte njëherë në javë në Rijekë por pa përmendur emrin e anijes.¹³⁰ Më 19 shkurt 1872, gazeta “Crnogorac” nr.7 shkruan se “ një

¹²⁴ Po aty.

¹²⁵ Ljubić Šime, Listine IV, 92

¹²⁶ A. Jovičević – M. Strugar, Slike iz prošlosti Cekljina, fq. 241

¹²⁷ Rijeka Crnojeviq është emër zyrtar i këtij vendbanimi të vogël por vendasit dhe shqiptarët, shkodranët, kranjanët

e quanin Rijekë, prandaj në vazhdim të këtij punimi edhe unë do ta shkruaj Rijekë.

¹²⁸ Dinko Franetović – Bure, Historija pomorstva i ribarstva Crne Gore do 1918, fq. 50, Titograd, 1960.

¹²⁹ Rovinski Pavle, Crnagora, Sanktpereburg, tomi II, fq. 50;

¹³⁰ M. Djurović, Trgovački kapital u Crnoj Gori u drugoj polovini XIX i početkom XX vijeka, Cetinje, 1958, fq. 50.

“vaporr” turk kishte operuar në liqenin e Shkodrës”. Ky “vaporr” mund të ishte anija e parë që për qëllime ekonomike lundronte në liqenin e Shkodrës. Tani më turqit posedonin disa avulllore si “Bojana” (1858), “Ishkodrah” dhe “Podgorizza”.

Ndërkaq, banorët e Krajës dhe Shirokës mjetet lundruese i përdornin pothuajse pa pengesa sepse jeta dhe ekonomia e tyre ishte e lidhur kryesisht me Shkodrën e jo me Cetinën.

- **Lundrimi pas Kongresit të Berlinit**

Në Kongresin e Berlinit, 1878, Mali i Zi fitoi të drejtën e lundrimit në liqenin e Shkodrës dhe lumit Buna si dhe daljes në detin Adriatik. Liqeni i Shkodrës ishte më rëndësi jetike për Malin e Zi sepse Shkodra ishte qendra kryesore për furnizim të malazezëve me artikuj ushqimor dhe industrial¹³¹. Nga ana tjetër si në Shkodër po ashtu edhe në Cetinë ishin të vëndosura përfaqësit diplomatike të shumë shteteve sidomos të Fuqive të Mëdha Evropiane. Nisur nga kjo, pa pritur shumë, Mali i Zi filloi organizimin e lundrimit të organizuar në mes të Shkodrës dhe Rijekës .

Anija (avullorja) e parë që nisi lundrimin në mes Shkodrës dhe Rijekës ishte “Slavljanin” i cili fillimisht bënte bartjen e postës diplomatike¹³² si dhe të delegacioneve sidomos të anëtarëve të Komisionit për vëndosjen e kufijëve në mes Malit të Zi dhe Shqipërisë. Kjo avulllore punoi deri në vitin 1885 kur Mali i Zi bleu në Venedik avulloren “Žabljak” ex “Eraclea”¹³³ i cili arriti në Rijekë më 8 nëntor 1885. Më 10 nëntor 1885 kjo avulllore nisi qarkullimin e parë të rregullt të njerëzve dhe mallrave në liqenin e Shkodrës. Ai qarkullonte dy herë në javë në relacionin Rijekë - Vir Pazar-Planicë-Shkodër (bante postën) ndërsa njëherë në javë në relacionin Rijekë-Vir Pazar-Planicë sipas orari të shtypur Drejtoria e Shoqatës Malazeze të avullorëve¹³⁴, po atë ditë në Cetinë. Kjo avulllore punoi deri në vitin 1889. Në vitin 1886 në Angli u ble avullorja “Danica” i cil arriti në Tivar më 22 korrik 1886. Në vitin 1887 kjo avulllore zavëndësoi avulloren “Žabljak” po në të njëjtin relacion, të dielen dhe të mërkurën Shkodër –Rijekë dhe çdo të martë dhe të shtundë Rijekë-Shkodër. Për herë të parë anijet e udhëtarëve ndalojnë edhe në portin e improvizuar në Sjerç-Krajë¹³⁵. Sipas orarit të nëntorit të vitit 1886 nisja nga Sjerçi, të dielen ishte në 13,45, të martën 14,45, të mërkurën 11,45, të shtundën në ora 2,45 ndërsa arrinte në Sjerç të dielën në 11,30, të martën në 2,15, të mërkurën 11,30 dhe të shtundën në 14,15. Sipas orarit të udhëtimit, udhëtimi nga Shkodra deri në Sjerç zgjate plotë 3 orë e 30 minuta ndërsa deri në Viri 4 orë e 15 minuta. Avullorja “Danica” lundroi në liqenin e Shkodrës deri në vitin 1918 kur ushtria austro-hungareze e fundosi në afërsi të Vir Pazarit.¹³⁶

Lundrimi në liqenin e Shkodrës po rritej dhe po bëhej gjithnjë e më i nevojshëm, kështu që u paraqit nevoja për formimin e një subjekti ekonomik i cili do të angazhohej në organizimin dhe zhvillimin e komunikacionit ujor në Mal të Zi. Kështu, më 6 nëntor 1887 ishte mbajur Kuvendi themelues i shoqatës akcionare “Shoqata e Previligjuar e avulloreve (paraanije) të Principatës Malazeze”.¹³⁷ Ministria e Punëve të Brëndshme aprovoi statutin e kësaj shoqërie më 26 nëntor 1887. Regjistrimi i shoqërisë u bë në Gjyqin e Madh në Cetinë¹³⁸ Shoqëria kishte për detyrë të mbante lundrimin e rregullt në det, liqenin e Shkodrës dhe Bunë. Mirëpo akcionerët nuk arijten të grumbullonin mjetet e nevojshme për funksionimin e shoqatës shoqëria shpërndahet më 10 gusht 1888.¹³⁹

Nga viti 1902-1905 lundrimi në liqenin e Shkodrës organizohet nga shoqata “ The Anglo-Montenegrin trading company LTD” me seli në Podgoricë.¹⁴⁰ Për lundrim në liqenin e Shkodrës kjo shoqatë përdori anijet “Danica”, “Undine”, “Lastavica” “Obod”¹⁴¹ dhe “Galeb”. Duhet përmendur se anijet “Lastavica” dhe “Obod” u blen nga Drejtoria e Përgjithshme e Postës Malazeze, sepse “Danica” shpeshherë prishej dhe transportimi i postës ishte i parregullt.¹⁴² Para se të likuidohej kja shoqatë për lundrim përdori anijet e marra me qira “Principe di Piemonte”, “Mafalda”¹⁴³ dhe “Jolanda”. Ndërkaq, prej vitit 1905-1916 lundrimin në liqenin e Shkodrës e organizoi firma italiane

¹³¹ Zapisi, 1941, knj. XXV, 173-174.

¹³² DACG, MUD, 1879, dok. 675, 944, 989; po ashtu Dac, MUD, 1880, dok. 446.

¹³³ Rada Adžić,

¹³⁴ Gazeta “Glas Crnogoraca” nr. 44/10 nëntor 1885; DAC; MUD, 1885, dok. 897.

¹³⁵ Po aty, nr. 45/14 nëntor 1886

¹³⁶ Rada Adžić, Plovidba i ribolov na Skadarskom jezeru, 2017. Autorja është bashkëpunëtoare profesionale për trashëgimi kulturore-historike në JPNPCG (Ndërmarrja Publike Parqet Nacionale të Malit të Zi).

¹³⁷ Gazeta “Glas Crnogoraca” nr. 42-18 tetor 1887, nr. 45-8 nëntor 1887, nr. 48-29 nëntor 1887.

¹³⁸ DAC, MUD, 1887, dok. 825/26 shtator 1887.

¹³⁹ Po aty, nr. 38/18 shtator 1888.

¹⁴⁰ Radmila Adžić, vepër e cituar

¹⁴¹ DAC, MUD, 1905, dok. 1790.

¹⁴² Dinko Franetović, vepër e cituar, fq. 175.

¹⁴³ DAC, MUD, 1905, dok. 2673.

“Compagnia di Antivari”¹⁴⁴ (Shoqëria e Tivarit). Lundrimi me anijet e kësaj shoqërie “Antivari”, “Danica”, “Drin”, “Nettuno”, “Obod”, “Vranjina”, “Vir” dhe “Oka”¹⁴⁵ bëhej në relacionin Rijekë-Vir-Pazar dhe Vir Pazar-Planicë-Shkodër, por këto avullore më nuk ndalonin në Sjerç-Krajë. Kjo shoqëri në vitin 1914, në Venedik ndërtoi anijen motorike “Zeta” dhe më 1915 anijen motorike “Llovqen” për për shkak të luftës ato nuk arrijtën në liqenin e Shkodrës.

Gjatë luftimeve ballkanike komunikacioni ujqor në liqenin e Shkodrës u ndërpre. Ndërkaq, gjatë viti 1916-1918, kur Mali i Zi u okupua nga Austro-Hungaria e cila i konfiskoi të gjitha anijet që lundronin në liqenin e Shkodrës. Pas tërheqjes ushtria austro-hungareze të gjitha anijet që lundronin në liqenin e Shkodrës i fundosi apo i shkatroi.¹⁴⁶

Lundrimin në liqenin e Shkodrës gjatë viteve 1918-1920 e organizuan francezet me anijet e mbetura të shoqërisë “Shoqëria e Tivarit”, pasi së bashku me italianet për këto vite e mbajtën të okupuar liqenin e Shkodrës. Në periudhë kohore anijet që lundronin në relacionin Shkodër – Rijekë dhe anasjelltas ndalonin edhe në Sjerç-Krajë. Lundrimin në liqenin e Shkodrës nga viti 1920-1923 e organizoi marina ushtarake e Mbretërisë SKS-së, ndërsa nga viti 1923-1925 lundrimi bëhej me anijet “Soko” dhe “Vila” të pronarit Petar Lekiqit nga Vir Pazar. Por këto dy anije të vogla nuk i plotësonin nevojat e transportit në linjen Shkodër-Rijeka Crnojeviq kështu që autoritetet portale i ndaluan lundrimin në këtë relacion.

- **Lundrimi pas krijimit të shtetit jugosllav**

Në vitin 1922 në Cetinë, banka Serbo-Shqiptare¹⁴⁷ themelon shoqërinë “Lundrimi Adriatik-Shkodër” me seli në Lipovik. Ka disponuar me avulloret “Zeta” (Liqeni), “Skenderbeg”¹⁴⁸ dhe “Bojana” (Shkodra) dhe anijet motorike “Rumija” dhe “Soko”. Këto anije nga viti 1922-1928 qarkullonin për çdo ditë në relacionin Rijeka Crnojeviq-Vir Pazar-Planicë-Ostros (Sjerç)-Shkodër dhe anasjelltas¹⁴⁹. Pra përsëri anijet ndalojnë Krajë. Në vitin 1928 e tërë pasuria e kësaj shoqërie blehet nga Sh.A. “Boka” nga Kotorri e cila vazhdon të mbante lundrimin në relacionin Rijeka Crnojeviq-Shkodër me dy ndalesa në Krajë, Ostros (sigurisht Sjerç) dhe Skje.

Në vitin 1934, SH.A. “Boka” shndërrohet në Sh.A. “Zetska Plovidba”. Për lundrim në liqenin e Shkodrës përdorte anijet “Zeta”, “Skenderbeg”, “Soko”, “Rumija”, “Budva” dhe dy lundra motorike “Sveti Nikola” dhe “Sveti Djordje”.¹⁵⁰ Për çdo ditë dy anije bënin transportimin e pasagjerëve ndërsa lundrat bënin transportimin e mallrave.

Në periudhën 1941-1945, në liqen nuk ka pasur komunikacion të rregullt as të njerëzve e as të mallrave. Nga viti 1945-1948 komunikacioni në liqenin e Shkodrës është zhvilluar në të njëjtat linje si edhe më parë, por për shkaqe politike në vitin 1948 ndërpritet linja Rijeka-Crnojeviq-Shkodër kështu që stacioni fundit ishte Skjeja. Në vitin 1947 në liqenin e Shkodrës lundrojnë anijet e sipërmarrjes “Llovqen” e cila dispononte me anijet “Grahovac”, “Mogren” dhe “Jeremija”¹⁵¹. Sipas Svetozar Razhnatoviqit, në Krajë ndërtohen edhe dy mole: Muriq dhe Ostros, kështu që në Krajë anijet ndalojnë në Muriq, Sjerç, Ostros dhe Skje. Në vitin 1957 themelohet sipërmarrja “Galeb” me seli në Rijeka Crnojeviq. Kjo sipërmarrje vazhdon lundrimin me të njëjtat anije deri në vitin 1960 kur flotës së saj i shton edhe anijet “Vir Pazar” dhe “Rijeka Crnojeviq” dhe kështu kushtet e udhëtimit përmirësohen dukshëm.

Më ndërtimin e hekurudhës dhe rrugës automobilistike Tivar-Podgoricë filloi të zvoglohet numri i udhtarëve dhe sasisë së mallrave, kështu që së pari u ndërpre linja Vir Pazar-Planicë, por se shpejti edhe linja Rijeka Crnojeviq-Skje do të dobësohet dhe ndërprite. Ndërmarrja “Galeb” në vitin 1981 shkoi në likuidim dhe të gjitha mjetet lundruese iu dhanë sipërmarrjes së peshkimit “Ribarstvo” në Rijeka Crnojeviq.

Me likuidimin e sipërmarrjes “Galeb”, pas 96 viteve ndërpritet linja e rregullt e transportimit të njerëzve dhe mallrave në liqenin e Shkodrës dhe tani më i takon të së kaluarës.

Ndërprerja e transportimit të njerëzve dhe mallrave në liqenin e Shkodrës pati ndikim negativ në jetën e banorëve të Krajës, veçanërisht të banorëve që jetonin buzë këtij liqeni. Kushtet e jetës u vështirësuan dukshëm sepse as komunikacioni rrugor nuk ishte i organizuar. Ndërprerja e lundrimit të organizuar në liqenin e Shkodrës ndikoi dukshëm në boshatisjen e Krajës dhe emigrimin në vendet për rreth (Ulqin e Tivar) e veçanërisht në vendet tjera të Evropës, Amerikës por edhe të Australis

¹⁴⁴ Dinko Franetovic, vepër e cituar, fq.184.

¹⁴⁵ Po aty, fq.186

¹⁴⁶ Radmila Adžić, vepër e cituar

¹⁴⁷ Zbornik radova sa medjunarodnog naučnog skupa održanog na Cetinje, 21,22 i 23 juna 1990

¹⁴⁸ Anija (avullorja) “Skenderbeg” të cilën e përdornin okupuesit italian dhe qarkullonte në linjen Shkodër-Rijekë, më 12 shkurt 1942, në ora 7,40, në udhëtim për Rijekë, në ngushticën Basa-Lisinj, rrembehet nga batalioni partizan “Carev Laz”. Pasi i morren të gjitha plaçkat, anijen e e dërguan në vendin e quajtur “Crna Glavica” ku të padamtuar e fundosin. (Istorijski zapisi 4-6/1951).

¹⁴⁹ Radmila Adžić, vepër e cituar.

¹⁵⁰ Po aty.

¹⁵¹ Po aty.

FINANCIAL ANALYSIS IN THE PROGRESS OF ECONOMIC UNITS

Prof.Dr Fatbardha Molla –University,,Luigj Gurakuqi Shkoder

Abstract

There are many reasons why a careful analysis of the financial statements of the economic entity is needed. Financial statements are statements that are used for many reasons. They are prepared to be used by different groups of users; shareholders, short-term and long-term creditors, potential investors, state agencies and managers, etc. These different groups make different decisions from each other; such as whether to make an investment (potential shareholder) or lend (potential creditor), whether there is an opportunity to improve the company's performance (manager) or whether an economic entity is complying with the legal rules of the state (government agencies). and multiple forecasts. Each of these decisions requires different information and therefore also different analyzes in accordance with the interests of users. financial statements following each other are not clear without financial and comparative analysis.. Users of financial statements may be interested in seeing the progress of a company compared to:

- a. standard objectives set by the unit
- b. other companies in the same industry. or sector
- c. other opportunities to invest in the sector with better financial performance

Keywords (financial analysis, economic entity, profitability, accounting, liquidity, capital structure, overview, balance sheet)

Abstract

Ka shumë arsye përse duhet një analizë e kujdesshme të pasqyrave financiare të njësisë ekonomike .Pasqyrat financiare janë pasqyra të cilat përdoren për arsye të shumta. Ata përgatiten për të përdorur nga grupe të ndryshme përdoruesish ; aksionerët, kreditorët afatshkurter dhe afatgjatë, investitorët potencial, agjensitë shtetërore dhe drejtuesit etj . Këto grupe të ndryshme marrin vendime të ndryshme nga njëri - tjetri; si psh, të bëjnë një investim (aksioner potencial) apo të japin hua (kreditor potencial), apo ekziston një mundësi për të përmirësuar performancën e kompanisë (drejtuesi) apo nëse një njësi ekonomike është duke respektuar rregullat ligjore të shtetit (agjensitë qeveritare).dhe parashikime të shumta .Secili nga këto vendime kërkon informacion të ndryshëm dhe si rrjedhojë edhe një analizë të ndryshme në përputhje me interesat e përdoruesve ..Lidhja ndërmjet zërave në pasqyrën e të ardhurave dhe bilancit ose në të dyja si dhe lidhja ndërmjet shumëve të pasqyrave financiare pasuese të njëra tjetres nuk janë të qarta pa analizën financiare dhe krahasuese ..Përdoruesit e pasqyrave financiare mund të jenë të interesuar për të parë progresin e një kompanie në krahasim me :

- a. objektivat standarte të paravendosur nga njësi
- b. kompanitë e tjera të së njëjtes industri. apo sektor
- c. mundësitë e tjera për të investuar në sektor me performancë më të mirë financiare

Keywords (analiza financiare , njesi ekonomike , rentabilitet , kontabilitet , likuiditet , structure kapitali ,pasqyre , bilanci kontabel)

1. Qëllimi i temës

Roli i analizes financiare është shumë i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm në procesin e marrjes se vendimeve nga drejtimi i veprimtarisë së njësive ekonomike. Puna e kontabilistit nuk perfundon me hartimin dhe ndertimin e pasqyrave financiare baze por ky informacion duhet te perpunohet dhe analizohet nga teknikat e analizes financiare . Pa analizen financiare ne nuk mund te kuptojme pikat e forta dhe pikat e dobeta te ne aktivitetin e nje njesie ekonomike . Jane analizat financiare si treguesit e rentabilitetit , te struktures se kapitalit , te likuiditetit te perfitueshmerise etj qe ndihmojne drejtimin ne marrjen e vendimeve .

2. Objektivat e temës

Nisur nga roli i rëndësishëm i analizes financiare së veprimtarisë së njësive ekonomike objektivat e temës janë ;

Të tregojë lidhjet e ngushta të analizes dhe drejtimit te njesise .

Të njohë drejtuesit me informacionin e nevojshëm që jep analiza .Të ndihmojë perdoruesit e informacionit financiar që të lexojnë informacionin që del nga pasqyrat financiare dhe ta përpunojnë në funksion të vendimmarrjes .Të kuptojnë se për të qenë të sukseshëm ata nuk duhet të drejtojnë vetëm me intuitë por duhet të njohin dhe përdorin me efektivitet informacionin që ofron kontabiliteti dhe perpunimin e tij permes analizes .Për tu përballur me konkurrencën duhet që informacioni kontabël të jetë i shtadartizuar i analizuar e i perpunuar për këtë menaxherët duhet ti drejtohen analisteve dhe profesionistëve .

3. Metodologjia

Metodologjia është zgjedhur në përputhje me qëllimin e studimit , i cili ka të beje me studimin e rolit te analizes ne drejtimin e njesise Çdo kapitull është plotësuar me analiza si analiza matematikore , me analiza fianciare me analizim pyetsorësh dhe rekomandime përkatëse nga realiteti shqiptar. Analiza të tilla nxjerrin rendesinë e informacionit kontabël te analizuar ne drejtimin e njësive ekonomike .Nisur nga fakti që roli i analizës vjen gjithnje në rritje është e nevojshme shfrytëzimi i një literature të gjerë të vendit dhe asaj botërore .Kjo literaturë është plotësuar me informacionin e grumbulluar nga intervistat që janë realizuar me subjektet e njesive ekonomike. Pjesa më e madhe e pyetësorëve janë plotësuar me anë te intervistave ballë për ballë duke kerkuar shpjegim të mëtejshëm të disa përgjigjeve .Informacioni i grumbulluar eshte perpunuar , analizuar dhe jane dhene përfundimet dhe rekomandimet perkatese .

4. Analiza e raporteve

Pjesa më e madhe e njerezve të cilët analizojnë pasqyrat financiare janë të interesuar të investojnë të marrin hua, të menaxhojnë apo të marrin vendime në lidhje me respektimin e rregullave ligjore.

Në financimin e njësive ekonomike një rol të rëndësishëm ka analiza financiare .Analistët e kredisë përfshirë oficerët e kredisë bankare dhe analistët e bonove që analizojnë raportet për të siguruar aftësinë e shoqërisë për të paguar borxhet e saj. Analistët e letrave me vlere që janë të interesuar për perspektivën e shoqërisë në lidhje me efikasitetin riskun dhe zhvillimin. Krahasset mund të jenë të vështira sepse njësitet përdorin praktika të ndryshme kontabile, metodat e vlerësimit të inventareve dhe amortizimit mund të ndikojnë në pasqyrat financiare dhe si rrjedhim të çrregullojë krahasimin midis shoqërive Gjithashtu nëse një shoqëri merr me qira një përqindje të konsiderueshme të aktiveve të saj të prodhimit atëherë aktivet e saj do të duken në nivel të ulët krahasuar me shitjet sepse aktivet e marra me qira zakonisht nuk paraqiten në bilanc. Në të njëjtën kohë, detyrimet që lidhen me qiranë mund të mos tregohen si borxh. Si rrjedhim, marrja me qira mund të përmirësojë në mënyrë artificiale si treguesit e qarkullimit ashtu edhe raportin e borxhit. Megjithatë kontabiliteti ka ndërmarrë hapa për ta zbutur këtë problem. Është vështirë të përgjithësohet nëse një raport është “i mirë” apo “i keq”. Për shembull një raport i lartë korent mund të tregojë një pozicion të fortë likuiditeti, që është mirë, ose para të tepërta që është keq sepse paratë e tepërta në bankë janë aktive jo përfituese. Në të njëjtën mënyrë, raporti i lartë i qarkullimit të aktiveve të qëndrueshme, qarkulluese mund të tregojë nëse një shoqëri që i përdor aktivet e saj efektivisht ose një shoqëri është nën kapitalin normal dhe nuk mund të blejë aktive të mjaftueshme.

Shoqëria mund të ketë disa raporte që duken të “mira” ose performance e mirë financiare ose njësi me tregues që duken “të keqja” duke e bërë të vështirë të themi nëse shoqëria është në ekuilibër, e fortë apo e dobët. Megjithatë, për të analizuar efektin neto të një grupi raportesh mund të përdoren procedurat statistikore. Shumë banka dhe njësi financiare përdorin procedurën e tillë për të analizuar raportet financiare të shoqërisë dhe më pas i klasifikojmë ato sipas problemeve financiare që mund të kenë.

Analiza e raporteve është e dobishme, por analistët duhet t’i kenë parasysh problemet e mësipërme dhe të bëjnë rregullimet e nevojshme. Analiza e raporteve e bërë në mënyrë mekanike, pa menduar dhe pa bërë rregullimet është e rrezikshme, e përdorur me inteligjencë dhe me gjykim të mirë ajo mund të sigurojë drejtime të dobishme për veprimtarinë operative të shoqërisë.

Disa probleme që lidhen me analizën financiare si praktika të ndryshme financiare dhe sipas sektoreve e vështirsojnë përgjithsimin e rezultateve .

Shumë shoqëri të mëdha operojnë në industri të ndryshme dhe për shoqëri të tilla është vështirë të sigurosh një grup tipik mesataresh industriale. Si rrjedhim analiza e raporteve është më e përdorshme për shoqëri të vogla me gamë të vogël produktesh sesa për ato të mëdha dhe shumë të diversifikuara. Shumë shoqëri duan të jenë më të suksesshme se mesatarja e industrisë kështu që krahasimi me performancën e mesatares nuk është i mirë. Si synim një nivel performancë më i lartë, është më mirë të fokusoheni tek raportet e lidhësit të industrisë. Inflacioni mund ta ketë çrregulluar mjaft bilancin vlerat e rregjistruara janë ndonjëherë shumë larg vlerës së vërtetë.

Për më tepër, përderisa inflacioni ndikon drejtpërdrejt si në amortizim ashtu edhe në koston e inventarit ai ndikon rrjedhimisht dhe në fitime. Kështu që analiza e raporteve të një shoqërie me vetveten gjatë një periudhe kohe ose krahasimi me një njesi të një moshe të ndryshme, duhet të interpretohet me kujdes. Faktorët stinorë mund ta çrregullojnë analizën e raporteve. Ndikimi i tyre mund të zbutet duke përdorur mesataren mujore të inventareve dhe të llogarive të arkëtueshme kur llogarisim raportet e qarkullimit. Shoqëritë mund të përdorin teknika mbulimi për t'i bërë pasqyrat financiare të tyre të duken më të forta.. Për shembull një ndërtues nga Tirana merr një borxh për 2 vjet me 29 dhjetor dhe i mban paratë për disa ditë dhe më pas e shlyen borxhin me 2 janar të vitit pasardhës, pas 4 ditësh. Kjo ndihmon në përmirësimin e raportit korent dhe të shpejtë dhe bën që bilanci i tij i vitit të duket në rregull. Sidoqoftë përmirësimi është vetëm sipërfaqësor, kozmetik, vetëm një javë më vonë bilanci kthehet përsëri në nivelet e tij të vjetër.

Raportet e analizës financiare përdoren shumë për vlerësimin e gjendjes financiare në bizneset e vogla, ku burimet që sigurojnë të dhëna të gatshme krahasuese për madhësi të ndryshme biznesesh, janë lehtësisht të disponueshme. Kur një biznes i vogël aplikon për kredi, bankieri në radhe të parë duhet të bëjë parashikimin lidhur me mundësinë e shlyerjes së borxhit nga shoqëria. Gjatë këtij parashikimi bankieri duhet t'i kushtojë vëmendje treguesve të likuiditetit dhe atyre që lejojnë parashikimin e ecurisë së rentabilitetit të shoqërisë në të ardhmen. Bankat janë të gatshme të japin kredi për klientet e rinj, kur shansi që këta të fundit të shlyejnë borxhin brenda një kohe të caktuar dhe të jenë klientë të qëndrueshëm të bankës, është i lartë. Në këtë rast, si lidhjet afatshkurtra bankë-biznes ashtu edhe ato afatgjate janë me interes për bankat. Njëkohësisht perceptimet e bankiereve për biznesin janë të rëndësishme për pronarin manaxher, sepse ka shumë mundësi që banka të bëhet financuesi kryesor i aktiviteteve të biznesit. Problemi i parë që mund të hasë një bankier në këtë rast është se ndryshe nga shoqëritë e mëdha, pasqyrat financiare të shoqërive të vogla nuk janë të audituara nga shoqëritë përkatëse audituese. Një tjetër problem paraqet fakti se pasqyrat financiare mund të mos jenë përgatitur në mënyrë periodike. Në qoftë se biznesi është i ri, atëherë të dhënat historike do t'i përkasin e shumta vitit të kaluar. Pasqyrat financiare mund të jenë përpiluar nga një i afërm i pronarit dhe jo nga një kontabilist ekspert.

Cilësia e dobët e të dhënave financiare mund përbëjë pengesë për vendosjen e marrëdhënieve midis bankës dhe biznesit të vogël. Kështu, një shoqërie të vogël nuk i akordohet kredi edhe pse realisht mund të jetë financiarisht e qëndrueshme. Pra, është në interes të pronarit që të dhënat financiare të jenë të besueshme edhe pse kjo mund të ketë kosto më të lartë. Për më tepër në qoftë se të dhënat janë të papërshtatshme për bankierin atëherë ato janë të papërshtatshme edhe për drejtimin e shoqërisë, sepse vendimarrja mbështetet në të dhënat e paqyrave financiare. Për një grup të dhënë raportesh një shoqëri e vogël ka risk më të lartë se një shoqëri e madhe. Shpesh shoqëritë e vogla prodhojnë një lloj produkti ose dhe i drejtohen një kategorie të vogël konsumatorësh. Ndërsa shoqëritë e mëdha të cilat i drejtohen si konsumatorit vendas ashtu edhe atij të huaj nuk janë kaq të ekspozuar ndaj një risku të tillë. E njëjta situatë mund të vërtetohet edhe për shoqëritë që prodhojnë vetëm një lloj produkti.

Zgjerimi i kredisë për një biznes të vogël, sidomos për shoqëritë ku rolin e manaxherit e luan pronari, shpesh përfshin edhe një risk tjetër që nuk has në shoqëritë e mëdha.

Kjo ka të bëjë me varësinë e drejtimit të biznesit nga një individ i vetëm. Është në interes të familjes dhe të kreditorëve që të hartohet një plan për drejtim të suksesshem dhe gjërat të bëhen të qarta para se të lindin këto probleme. Si përfundim, për të vlerësuar potencialin e një shoqërie të vogël për të qenë një kliente e rregullt dhe e qëndrueshme e bankës, analisti financiar duhet të shkojë përtej raporteve dhe të analizojë të ardhmen e produkteve të shoqërisë, konsumatorëve, drejtimit dhe tregut. Megjithatë analiza e raporteve financiare mbetet vetëm hapi i parë.

5. Raste studimore nga raportet financiare të disa bizneseve në qarkun e Shkodrës

Në e qarkun e Shkodrës kemi një sërë biznesesh të cilët kanë tregues të ndryshëm rentabiliteti. Duke krahasuar informacionin financiar kemi nxjerrë tregues të ndryshëm të rentabilitetit. Me poshte po japim në mënyrë të përbledhur dhe të grupuar bizneset kryesore që operojnë në qarkun e Shkodrës dhe të dhënat e tyre financiare në lidhje me ROE për sektore të ndryshëm që nga viti 2014-2019.

Biznesi 1 tabele 1¹⁵²

Tregtim të artikujve të ndryshëm

VITET	2014	2015	2016	2017	2018	2019
ROE	11.5%	11.5%	10.5%	10.4%	10.4%	10.1%

Biznesi 2

Prodhim Konfesionesh

VITET	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
ROE	3%	2%	2.9%	3.2%	5%	6.9%	4.2%

Biznesi 3

Tregti artikuj ushqimor me shumice

VITET	2014	2015	2016	2017	2018	2019
ROE	17.3%	16%	13.3%	14%	16.2%	18.3%

Biznesi 4

Artikuj industrial me shumice

¹⁵² Ky informacion është marre nga BKT (Banka Kombëtare Shkodër)

VITET	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
ROE	15.5%	19.8%	16.8%	15.2%	15.5%	13.9%	12.8%

Biznesi 5

Prodhim Druri

VITET	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
ROE	5.9%	9%	7.8%	3.9%	5.1%	6.9%	7.5%

Biznesi 6

Tregtim artikuj te ndryshem

VITET	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
ROE	11.7%	8.2%	11.1%	13.15%	17%	16.1%	14.8%

Biznesi me pak fitim prures eshte ai i konfesioneve i ndjekur nga biznesi i prodhimit te drurit. Te dhenat financiare te ketyre bizneseve jane thuajse standarte per periudhen nga viti 2014-2018, me nje luhate qe nuk i kalon 3%. Nese do te krahasojme biznesin e konfesioneve me bizneset e njesive te tjera per vitin 2018 do shohim se kthimi nga kapitali i vet per biznesin e konfesioneve eshte 5% .

Rëndësia dhe zbatimi i praktikave të kontabilitetit në njësitë ekonomike në qarkun e Shkodrës Njësitë ekonomike japin opinione të ndryshme në lidhje me të metat e informacionit kontabël. Sipas tyre këto të meta lidhen me:

- ✓ dokumentacionin justifikues jo të plotë;
- ✓ mosdisponimin e informacionit në kohën e duhur;
- ✓ paaftësia për të kuptuar informacionin financiar që disponohet;
- ✓ faktin që jo të gjithë janë në dijeni të informacionit kontabël në të njëjtën kohë;
- ✓ mosrregjistrimin saktë dhe sistematik të veprimeve kontabël.

Gjithashtu, ato shprehen se shtrembërimet më të mëdha të informacionit kontabël qëndrojnë në ndryshimin e shifrave reale të shpenzimeve dhe në fshehjen e të ardhurave për efekt të tatim-taksave. Bazuar tek analiza e pyetësorit informacioni i pasaktë kontabël ka impakt negativ në rezultatin financiar, pasi informacioni i pasaktë nxjerr në çdo kohë rezultat të pasaktë financiar, duke bërë kështu që të mos njihet gjëndja reale financiare e firmës në një moment të dhënë dhe si rezultat të kete efekt në analizen e pasqyrave financiare .

Konkluzione dhe Rekomandime

Nga studimi i bërë kam arritur në disa konkluzione:

Niveli i perceptuar i transparencës financiare në Shqipëri nuk inkurajon investimin e brendshëm dhe atë të huaj. Në përgjithësi, nivelet e ulëta të transparencës pengojnë njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme (SME) në marrjen e kredive nga sektori financiar formal. Kjo është e rëndësishme në kontekstin aktual të Shqipërisë, ku afro 92% e të gjitha njësive të biznesit janë njësi të vogla e të mesme. Për më tepër, në kushtet e mungesës së një informacioni financiar të besueshëm, aksionerët dhe palët e treta nuk arrijnë të njihen me rendimentin e stafit drejtues, dhe rrjedhimisht pengohet monitorimi mbi bazë tregu i kompanive dhe shpërndarja efektive e burimeve të pakëta.

Disponueshmëria e informacionit financiar të publikuar është shumë e kufizuar në Shqipëri. Kërkesat aktuale për depozitimin dhe publikimin e pasqyrave financiare nuk janë në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare të kësaj fushe.

Kuadri ligjor për raportimin financiar në Shqipëri karakterizohet nga një mungesë e përpunueshmërisë. Përveç kësaj, ligjet dhe rregulloret e shumta duhet t'iu komunikohen në mënyrë të mjaftueshme njësive ekonomike të cilat duhet t'i ndjekin dhe zbatojnë ato në mënyrë që të lehtësohet zbatueshmëria e ligjit.

Nevoja për kualifikim në të gjitha fushat e ekonomisë në lidhje me kontabilitetin dhe raportimin financiar është shumë e madhe. Niveli dhe cilësia e arsimimit dhe kualifikimit në procesin para dhe pas certifikimit të kontabilistëve është i pamjaftueshëm për të plotësuar nevojën ekzistuese për njohuri dhe eksperiencë.

Mekanizmat e monitorimit dhe zbatimit nuk janë efikase për të nxitur zbatimin e standarteve të kontabilitetit. Vihet re një zbatim i kufizuar i standarteve të kontabilitetit nga njësitë ekonomike. Arsyet e monitorimit dhe aktiviteteve joefikase të zbatimit përfshijnë autoritetin e paqartë ligjor, mungesën e kapacitetit apo autoritetit veprues/operacional, pamundësinë e njësive ekonomike për të plotësuar kërkesat e duhura për shkak të kapaciteteve të kufizuara, si dhe neglizhencën e autoriteteve në përmbushjen e këtij roli kaq të rëndësishëm.

Rekomandime:

Zbatimi i rekomandimeve të dhëna më poshtë është i një rëndësie të madhe për forcimin dhe përmirësimin e kuadrit të raportimit financiar me efekte pozitive në qëndrueshmërinë e sistemit financiar dhe rritjen ekonomike .

Forcimi i kuadrit statutor që drejton kontabilitetin dhe raportimin financiar.

- Krijimi i mekanizmave të monitorimit sistematik dhe zbatimit për të siguruar përpunueshmërinë me standartet e kontabilitetit me zhvillimin aktual të ekonomisë
- Përmirësimi i cilësisë së punës së kontabilistëve nëpërmjet përmirësimit të profesionit të kontabilistit .
- Rritja e numrit të profesionistëve kontabilistë të aftë për përgatitjen e pasqyrave financiare të një cilësie të lartë. Kjo do të përfshinte sigurimin e stimujve për të tërhequr në profesion studentët që mbarojnë me rezultate shumë të larta dhe rritjen e shkallës së njohjes së kualifikimeve.

References :

1. Ingrid Shuli ,Rezarta Perri Analiza e Pasqyrave Financiare 2016
2. Kontabiliteti Financiar i Avancuar, S.Dhamo, 2021
3. Halit Xhafa –Beshir Ciceri, Drejtimi financiar 1, Tiranë 2004
4. Magdalena Bregasi , Politika financiare e ndërmarrjes,2004
5. SKK 01 Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare

KONTRIBUTI I HAFIZ ALI RIZA ULQINAKUT NE KULTIVIMIN DHE RUAJTJEN E GJUHES SHQIPE

Prof. Dr. Fahrush Rexhepi- |Fakulteti I Shkencave Islame Prishtinë

Abstract

The Albanians, even though they were subjugated by the Ottoman Empire and embraced the Islamic religion, never agreed with that state, and were not assimilated by it with all the cultural, linguistic, ethnographic influences, etc., that were present during the Ottoman period.

The national culture and the Albanian language were preserved and cultivated by the most prominent personalities of the time, responsible for issues of the Islamic religion and Ottoman culture, near mosques and madrasahs in the Ottoman Turkish language. These creators, speaking in Albanian about the personality of Muhammad a.s. and his supporters, for their love, for language, for religion, for their people, history and country, powerfully awaken the love of the Albanian Islamic masses for greater freedom, for a more liberal religion, with Albanian claims.

During the history full of twists and turns, the country has often felt the need of intellectuals, religious people, later also theorists, who fought for the country's independence, then poets, and later politicians, until our century when a whole peiade of Islamic-Albanian leaders have stood at the head of the National Movement against the Slavic, Greek and Nazi-fascist occupation with rifle and pen in hand.¹⁵³ "For a union and solidarity at the level of the language community, the culture community, the market community and the country community" In fact, it is not too much to state, that to say, all the Albanian creators with the Ottoman Arabic alphabet, that we know until today, have worked in environments where the Albanian language and Albanian culture were extremely endangered by foreign languages and cultures, such as Slavic, Greek and others.¹⁵⁴

Religious and literary creators of the Albanian language, from the territory of Ulqin, such as Hafiz Ali Riza Ulqinaku, Mulla Isuf Kraja, etc., have made an important contribution.

Key words: Ali Riza Ulqinaku, Albanian language, literature, Beyte, Ottoman, alphabet, etc.

¹⁵³ Dr. Fahrush Rexhepi, Islamic Albanian periodical (first half of the 20th century), Pristina, 2013, p. 40.

¹⁵⁴ Dr. M. Pirraku, Albanian national culture until the League of Prizren, Pristina, 1989, p. 40.

Hafiz Ali Riza Ulqinaku;¹⁵⁵(1853-1913) është njëri ndër personalitetet e shquara kombëtare e fetare të gjysmës së shekullit XIX, do të thotë i periudhës së Rilindjes Kombëtare, autor i mevludit shqip dhe veprimtar i *Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, ishte një ndër figurat e shquara të *Rilindjes Kombëtare*. U lind në Ulqin, më 1853, apo sipas disa burimeve në vitin 1855, në familjen e një barkëtari, ku kreu edhe mësimet e para. Mësimet i kishte filluar në medresenë e Ulqinit, te myderrizi Sali efendi Hylja. Më vonë vazhdoi shkollimin në Shkodër dhe në Stamboll. Fillimisht punoi si imam dhe myfti në Ulqin. Pjesën më të madhe të jetës e kaloi në Lezhë, ku punoi myfti dhe myderriz. Vdiq në Shkodër në vitin 1913. Është varrosur në aborrin e xhamisë së Shaban efendisë, në Mahallë të Re. Varri i tij, sot nuk gjendet.¹⁵⁶

Hafiz Ali Riza Ulqinaku ishte poet i talentuar, përkthyes i shkëlqyeshëm, leksikograf i dalluar dhe alim i nderuar në rrethin ku jetoi dhe veproi. Që në moshë të re u mor me përkthime në gjuhën shqipe të veprave letrare moralizuese dhe mësimore. Ky krijues ka lënë vepra të botuara, dorëshkrime origjinale dhe përkthime. Më 1884 botoi një përmbledhje me tri vepra të veçanta: përkthimin shqip të veprës turke *“Huda Rabbim”*, mevludin të ndarë në katër kapituj, me gjithsej 634 vargje dhe një rrëfenjë të përbërë nga 804 vargje. Ndërsa në dorëshkrim ka lënë një abetare shqip, një fjalor i hartuar në vargje, një fjalor tjetër shqip-turqisht dhe një turqisht-shqip.¹⁵⁷

Vepra e tij më e njohur është përkthimi i Mevludit në gjuhën shqipe të autorit turk, Sylejman Qelebiut. Veprën *„Mevludi sherif”* e shqipëroi më 1873, të cilën e solli dorëshkrim. U botua në vitin 1885/86. Sipas dëshmisë së vet autorit¹⁵⁸, ky mevlud u përhap në të gjitha trevat veriore shqiptare të besimit Islam. Vepra kishte karakter patriotik, sepse me parathënien e saj potencojë domosdoshmëria e lëvrimin të gjuhës së pastër shqipe. Ai me dorën e vet shënon: *“Tue kanë n’Ulqin përpara emigrimit, përktheva e kompilova në gjuhën amtare t’emën qi është shqipja.”* *Mevludin e profetiti a.s.”*. Ai me krenari pohon: *“Atdheu e vendlindja e jonë është Ulqini...Gjuha e jonë është shqipja. Shkruaj e flas arabisht , turqisht e shqip”*.¹⁵⁹ Pastaj në parathënien e mevludit shënon: *“N’gjuhën shqipe kom qëllim unë me i tregue që kështu vllaznit sadopak me përfitue”*.¹⁶⁰

Pastaj vargjet: Nji vasile për me bë Aj Dhylxhelalë,

Me qerrem t’Vet mue gjynahet me m’i falë.

Dhe shefaat Aj Muhamed Mustafa.

¹⁵⁵ Po aty, f.269.

¹⁵⁶ Sutki Malohoxha, Bejtet nw krijimtarinw popullore tw Ulqinit...F. 280.

¹⁵⁷ Osman Muderrizi, *Letërsia shqipe me shkronja arabe*, 1954-IHGJ, shih edhe rev.

“Studime filologjike” Tiranë 1963/3,154-188,(cituar sipas dr.R.Zekaj, Zhvillimi i kulturës islame, f.269).

¹⁵⁸ SHETOS, Hafiz Ali Ulqinaku –autor i mevludit shqip, Kultura islame, Tiranë, 1940,nr.13-14.

¹⁵⁹ Revista, Zani i naltë,1937,nr.11, f.365.

¹⁶⁰ Faik Luli, Islam Dizdari, Nexhmi Bushati, Në Kujtim të brezave, Shkodër 1997, f.126.

Ktij gjyhnaqari Hafiz Ali Riza.¹⁶¹

Njerëzit që e njohën, si Hafiz Hasan Mavriqi, thonë se ka qenë bejtegji shumë i talentuar. Për të, Hafiz Hasani ka thënë: “Ka qenë i zoti, sidomos si shair. Letrën ka pas mujt me e ba me bejte”. Në poezinë “Shartet e imanit”, Hafiz Alia shkroi:

Zotit iman me i pru, gjashtë sharte janë,
Gjith muslimant për me i dijt, borgj e kanë.
Shart’i parë: një Zot ashtu, ikrar e ban,
Ashtu dhe tammam me zemër, bes’ me xan.

Në poezinë “Shartet e muslimanëve”, Hafiz Ali Riza Ulqinaku bënë një kombinim mes kushteve të imanit dhe të islamit:

Shartet e imanit gjasht, sikur u than,
Edhe pes të islamizmës bajmë’ bejanë:
Esh-hedun Lailahe il-lall-llah,
Shart’i par’ Muhammedyr-Resulall-llah.¹⁶²

Vargjet e ngritura shqip të Hafiz Ali Riza Ulqinakut dhe gjuha e tij, ndonëse përplot orientalizma, mundë të themi se paraqesin interes të posaçëm për studime letrare dhe gjuhësore, kurse përmbajtja moralizuese e tyre shërben dhe mundë të shërbej si udhëzim për sjelljet praktike të besimtarit islam.

Hafiz Aliu me aftësitë e tij krijuese letrare i kushtoi vargje edhe shkrimit të gjuhës shqipe:

Arnaudçe me qerem t’Zotit u lënisë,
Ish një gjuhë që kalem s’ish kullenisë.
Kushda qi ta venë hesap danji hata,
Mej goditë ai qi ta shofë i bajnë rixha.

¹⁶¹ Sutki Malohoxha, Bejtet nw krijimtarinw popullore tw Ulqinit...f. 280.

¹⁶² Po aty, f. 281.

Është fakt se bejtet janë në zhdukje e sipër. Ato që dëgjojnë sot në Ulqinë, kanë të bëjnë me lindje, fejesa, martesë, tregti, detari, me jetën familjare, me fenë e kështu me radhë. Ato ndahen në disa grupe sipas përmbajtjes që trajtojnë.¹⁶³

Të dhënat që u prezentuan në këtë punim, dëshmojnë për një shkallë të lartë të zhvillimit dhe kultivimit të letërsisë shqipe të pronivencës islame në Ulqin me një ndikim të madh në krijimtarinë letrare poetike popullore shqiptare të Ulqinit.

Hafiz Ali Riza Ulqinaku luftoi heroikisht kundër agresorit të Malit të zi dhe ushtrisë turke në mbrojtje të Ulqinit 1876-77 dhe më 1880 përkrah myderrizit të tij dhe patriotit të shquar, *Sali ef. Hyla*.¹⁶⁴

Pikërisht të shkruash shqip një vepër fetare e të luftosh kundër ushtrisë turke, kundër vëllezërve të të njëjtit besim është një akt që bëhet për motive atdhetare dhe politike kombëtare.

Në lëmin e arsimit hartoi një abetare shqipe, të shkruar me shkronja arabe. Abetarja nëpërmjet fjalëve jep edhe njohuri gramatikore për nxënës, për natyrën etj.¹⁶⁵

Në fushën letrare *Hafiz Aliu* u shqua për zhvillimin me cilësi të riteve fetare, për predikimet, për administrimin e shkollave fetare, për ngritjen e xhamisë në Lezhë më 1908, për komunikimin me besimtarët dhe për tolerancë dhe harmoni ndërfaqetare.

Shqiptarët edhe pse u nënshtroan nga perandoria osmane dhe e përqafuan fenë islame asnjëherë nuk u pajtuan me atë gjendje dhe nuk u asimiluan prej tij me gjithë rrezatimet kulturore, gjuhësore, etnografike etj., që ishin të pranishme gjatë periudhës osmane. Kulturën kombëtare dhe gjuhën shqipe e ruajtën dhe e kultivuan personalitete më të shquara të kohës, përgjegjës për çështje të fesë islame dhe të kulturës osmane, pranë xhamive, dhe medreseve në gjuhën osmane turke.

Këta krijues duke folur shqip për personalitetin e Muhamedit a.s. dhe të përkrahsve të tij për dashurinë e tyre, për gjuhën, për fenë, për popullin, historinë dhe vendin e tyre, në mënyrë të fuqishme ngjallin dashurinë e masave shqiptare islame për një liri më të madhe, për një fe më liberale me pretendime gjithë shqiptare

Gjatë historisë plot kthesa shpeshherë vendi ka ndjerë nevojën e intelektualëve, e hoxhallarëve, më vonë të teoricienëve, që kanë luftuar për pavarësin e vendit, më pas të poetëve dhe më vonë të politikanëve, e deri në shekullin tonë kur një plejadë e tërë prijësish islam-shqiptarë kanë qëndruar në krye të *Lëvizjes Kombëtare* kundër pushtimit sllav, atij grek dhe nazifashistë me pushkë e me penë në dorë.¹⁶⁶ “Për një bashkim e solidaritet në nivel të bashkësisë së gjuhës, të bashkësisë së kulturës, të bashkësisë së tregut dhe të bashkësisë së vendit” Madje, këtu,

¹⁶³ Po aty.

¹⁶⁴ Po aty, 123-124.

¹⁶⁵ Hafiz Ali Ulqinaku, Elif Baja, (“abetarja”), fotokopje në AQSH.

¹⁶⁶ Dr. Fahrush Rexhepi, Periodiku shqiptar islam (gjysma e parë e shekullit xx), Prishtinë, 2013, f. 40.

nuk është tepër të konstatohet se, të thuash, të gjithë krijuesit shqiptarë me alfabet arabo osman, që i njohim deri sot, kanë vepruar në mjediset, ku gjuha shqipe dhe kultura shqiptare ishin tepër të rrezikuara nga gjuhët dhe nga kulturat e huaja sllave, greke e të tjera.¹⁶⁷

Gjeopolitika bëhet e njohur gjatë kohëve të ndryshimit, krizës dhe luftës. Kjo ishte veçanërisht e dukshme gjatë procesit të shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik në fund të Luftës së Ftohtë, përmes të cilit studimi i gjeopolitikës u bë përsëri në modë pas gati gjysmëshekullit të neglizhimit. Gjatë stuhisë së shkaktuar nga erërat e ndryshimit në agim të epokës së pas Luftës së Ftohtë, oreksi i dijetarëve për gjeopolitikën u ringjall sërish. Fukuyama njoftoi fundin e historisë, dhe Huntington shpalli fillimin e përplasjes së qytetërimeve.

3. Gjeopolitika pas Luftës së Ftohtë

Fundi i Luftës së Ftohtë shënoi fundin e shumë gjërave, lindjen e shumë gjërave të reja dhe modifikimin e shumë të tjerëve. Çështjet që lidhen me globalizimin, kulturën dhe identitetin, të cilat kanë mbetur të ngrira në ftohtësinë e Luftës së Ftohtë për kaq shumë kohë, u kthyen në agjendën e lartë politike që nga fillimi i viteve 1990. Në të njëjtën kohë bota përjetoi proceset e integritit dhe fragmentimit; shumë prej tyre argumentuan për fundin e shteteve-kombeve dhe u zhdukën kufijtë territorialë, ndërsa shumë të tjerë argumentuan se ata po bëheshin më të fortë se kurrë. Megjithatë, njerëzit mbetën të kujdesshëm pasi stabiliteti dhe rregullat e njohura të botës së vjetër po zëvendësoheshin nga struktura kaotike e të ashtuquajturit "Rendi i Ri Botëror". Në të njëjtën kohë u zhvillua një zhvillim i madh teknologjik. Friedman, në paragrafin e mëposhtëm, përmbledh karakteristikat e të dy epokave në kundërshtim me njëri-tjetrin:

Nëse perspektiva përcaktuese e luftës së ftohtë ishte "ndarje", perspektiva përcaktuese e globalizimit është "integrimi".

¹⁹³ Dodds, Geopolitics: A Very Short Introduction, p. 210.

¹⁹⁴ Flint, Introduction to Geopolitics, p. 22.

¹⁹⁵ Brzezinski, The Grand Chessboard, p. 6.

Simboli i sistemit të Luftës së Ftohtë ishte një murë, i cili ndau të gjithë. Simboli i sistemit të globalizimit është një rrjet i gjërë botëror (World Wide Web), i cili bashkon të gjithë. Dokumenti përcaktues i sistemit të Luftës së Ftohtë ishte "Traktati". Dokumenti përcaktues i sistemit të globalizimit është "Marrëveshja" ... ndërkohë që matja përcaktuese e Luftës së Ftohtë ishte peshë - veçanërisht hedhja e peshave të raketave - dokumenti përcaktues i sistemit të globalizimit është shpejtësia e shpejtësisë së tregtisë, udhëtimit, komunikimit dhe inovacionit. ... në Luftën e Ftohtë, pyetja më e shpeshtë ishte: "Sa i madh është raketa juaj?" Në globalizimin, pyetja më e shpeshtë është "Sa shpejt është modemi juaj?" ... nëse ankthi përcaktues i Luftës së Ftohtë ishte frika e asgjësimit nga një armik që e dinit shumë mirë në një betejë botërore që ishte e fiksuar dhe e qëndrueshme, përcaktimi ankthi në globalizim është frika e një ndryshimi të shpejtë nga një armik që nuk mund ta shihni, prekni apo ndjeni - një ndjenjë që puna juaj, komuniteti ose vendi i punës mund të ndryshohet në çdo moment nga forca anonime ekonomike dhe teknologjike që janë asgjë tjetër veç stabilitetit.¹⁹⁶

Teksa armiku i vjetër e kishte humbur luftën, kërkimi për një armik të ri dhe krijimi i saj përcaktoi karakteristikën bazë gjeopolitike të epokës së pas Luftës së Ftohtë. Gjatë këtij procesi gjeografia vazhdoi të kishte rëndësi. Si Dodds e vë atë, përkundër pretendimeve të bëra në favor të formave gjithnjë e më të forta të globalizimit, rëndësia e territorit, kufijve ndërkombëtarë dhe pretendimet ndaj sovranitetit ka mbetur po aq e ngutshme sa kurrë.¹⁹⁷

Gjeopolitika papritmas ishte në mënyrë të qartë në axhendën e lartë përsëri, duke u bërë modë e re. Me pak fjalë, shkatërrimi i Bashkimit Sovjetik si një tjetër ideologjike ndryshoi bazën mbi të cilën u ndërtua gjeopolitika ideologjike e Luftës së Ftohtë. Pyetja e re që u ngrit ishte "Cila do të jetë baza për gjeopolitikën e re?" Një nga përgjigjet më të njohura për këtë pyetje ishte dhënë nga Samuel Huntington.

Huntington solli një pasqyrë "të re" për diskutimet që filluan në fund të Luftës së Ftohtë duke deklaruar se politika e epokës së re do të zhvillohet përgjatë linjave të civilizimit. Aspekti thelbësor dhe qendror i politikës globale, argumenton Huntington, është se burimet themelore të konfliktit do të jenë kulturore sesa ideologjike apo ekonomike. Me fjalë të tjera, përplasja e qytetërimeve do të përcaktonte politikën globale dhe linjat e grindjeve ndërmjet qytetërimeve do të ishin linjat e betejës të epokës së ardhshme.

Në artikullin e tij të titulluar "Përplasja e qytetërimeve"¹⁹⁸, Huntington jep një përmbledhje të shkurtër të historisë së konflikteve, e cila përbëhet nga katër periudha kryesore: para vitit 1789; pas vitit 1789; periudhën e Luftës së Ftohtë dhe epokën e pas Luftës së Ftohtë. Gjatë tre të parëve, konfliktet - qoftë ato midis princave, shteteve-kombeve, apo ideologjive - kishin ndodhur brenda qytetërimit perëndimor. Tipari dallues i katërt është se ajo shënon zhvendosjen e politikës ndërkombëtare përtej fazës së saj perëndimore. Kjo fazë e katërt përcaktohet nga ndërveprimi midis qytetërimeve perëndimore dhe jo perëndimore. Tre periudhat e para përfshinin edhe entitetet jo-perëndimore, megjithëse në këto periudha më të hershme ata ishin përfshirë si objekte në vend të subjekteve.

Ekzistojnë disa nivele / njësi identiteti dhe qytetërimi. Për Huntington, qytetërimi përbën atë më të lartë. Me fjalë të tjera, është grupimi / identiteti më i gjerë kulturor që përcakton kufijtë e një grupi. Mund të përbëhet nga një grup i madh njerëzish ose një i vogël; ajo gjithashtu mund të përfshijë nën-qytetërimet. Cilado madhësi që mund të jenë, argumenton ai, qytetërimet përbëjnë përcaktuesit kryesorë të historisë njerëzore dhe kështu të së ardhmes. Sipas tij, qytetërimet kryesore që formojnë politikën e së ardhmes do të përfshijnë perëndimorët, konfucianët, japonezët, islamikët, hinduët, sllavët ortodoksë, amerikanët latino-amerikanë dhe ndoshta afrikanët. Pas këtij diskutimi të shkurtër mbi identitetin dhe qytetërimin Huntington pyet pyetjen e tij vendimtare: Pse do të përplasen qytetërimet?

Ai argumenton se, para së gjithash, dallimet ndërmjet qytetërimeve nuk janë vetëm reale, por edhe themelore. Qytetërimet dhe kështu njerëzit dallohen nga njëri-tjetri nga historia, gjuha, kultura, tradita dhe feja. Feja, për Huntington, është më e rëndësishmja. Është një ndryshim që gjeneron dhe do të vazhdojë të gjenerojë politikë dhe konflikte. Së dyti, ndërsa bota bëhet gradualisht një vend më i vogël, ai argumenton se vetëdija qytetare dhe ndërgjegjësimi i njerëzve rriten dhe forcohen. Ky fakt bën linjat e gabimeve më të qarta dhe më qendrore.

¹⁹⁶ Thomas Friedman, *The Lexus and The Olive Tree*, New York: Knopf, 1999, pp. 8,9; 11 quoted in Timothy W. Luke, "Postmodern Geopolitics," in Agnew; Mitchell; Toal (eds.), *A Companion to Political Geography*, p. 22.

¹⁹⁷ Dodds, *Geopolitics: A Very Short Introduction*, p. 1.

¹⁹⁸ Samuel P. Huntington, "The Clash of Civilizations," in Toal; Dalby; Routledge (eds.), *The Geopolitics Reader*, pp.159-169.

Së treti, si rezultat i krizës së identitetit të sjellë nga globalizimi, shfaqet një boshllëk që në shumicën e vendeve është e mbushur me identitet fetar në një formë fundamentaliste. Ky ringjallje ofron një bazë të mirë për identitetin dhe angazhimin që tejkalon shtetet kombëtare dhe bashkon qytetërimet. Së katërti, qytetërimi perëndimor arriti kulmin e vet në drejtim të pushtetit në fund të Luftës së Ftohtë, por jo-perëndimorët do të kenë në të ardhmen një vullnet dhe dëshirë në rritje për t'u ballafaquar dhe sfiduar qytetërimin perëndimor në mënyra jo perëndimore. Fakti që identitetet dhe kulturat janë dhënë dhe kështu entitetet fikse përbëjnë arsyen e pestë për konfliktin civilizues. Ai argumenton se karakteristikat kulturore dhe dallimet janë më pak të paqëndrueshme dhe kështu të komprometohen dhe zgjidhen lehtë se sa ato politike dhe ekonomike (...) Në konfliktet mes civilizimeve, pyetja është "Çka jeni?" Ky është një dhënë që nuk mund të ndryshohet".¹⁹⁹

Ai gjithashtu pohon se regjionalizmi ekonomik po rritet dhe se kjo do të përforcojë ndërgjegjen qytetëruese. Një regjionalizëm i suksesshëm ekonomik kërkon një kulturë / bazë të përbashkët. Përplasja e qytetërimeve, për Huntington, zhvillohet në dy nivele: mikro dhe makro. Në mikro-nivel grupet fqinje hyjnë në luftë për kontrollin e territorit dhe njëri-tjetrit. Në shtetet makro-shtetërore nga qytetërimi të ndryshme konkurrojnë për fuqinë ushtarake dhe ekonomike. Me pak fjalë ai argumenton se boshti qendror i politikës botërore do të ishte konflikti midis Perëndimit dhe të tjerëve (restit).

Francis Fukuyama është një tjetër emër i njohur, i cili është bërë një nga dijetarët më të njohur të epokës së pas Luftës së Ftohtë, me artikullin e tij të famshëm dhe me librin që shpalli fundin e historisë.²⁰⁰ Fukuyama, duke shkruar në vitin 1989, pohoi se ajo që kishim dëshmuar nuk ishte vetëm fundi i Luftës së Ftohtë, por fundi i historisë. Shekulli i njëzetë për Fukuyamën në fund u kthye aty ku filloi: jo në fund të ideologjisë apo konvergjencës midis kapitalizmit dhe socializmit, por fitores së liberalizmit ekonomik dhe politik. Ajo që ai do të thotë në fund të historisë është pika përfundimtare e evolucionit ideologjik të njerëzimit dhe universalizimi i demokracisë liberale perëndimore si forma përfundimtare e qeverisjes njerëzore. Për Fukuyamën, fakti që liberalizmi ose idealet e Revolucionit Francez nuk po zbatohen në çdo cep të botës nuk përbën pengesë për shpalljen e fundit të historisë.

Siç pranohet nga vetë Fukuyama, retorika apo ideja e fundit të historisë, megjithatë, nuk është e re. Avokati më i njohur i saj është Marksi, i cili huazoi idenë nga Hegeli. Hegeli shpalli historinë në fund të vitit 1806, e cila shënoi humbjen e Napoleonit dhe fitoren e idealeve të Revolucionit Francez. Të dy Hegeli dhe Marx e konsideronin historinë si një proces dialektik me një fillim, një mes dhe një fund. Fukuyama, megjithëse analizon idetë e Hegelit, nuk kritikon ose nuk komenton mangësitë apo kontradiktat e të kuptuarit Hegel të historisë dialektike, pasi që nga historia logjike nuk mund të ketë një fund pasi ajo gjithmonë do të ketë tezën e saj anti. Pra, a nuk kanë anti-teza 1806 ose 1989? Fukuyama nuk e shtron pyetjen në atë mënyrë, por i trajton sfidat për liberalizmin dhe humbjen e tyre: mposhtjen e fashizmit dhe komunizmit si ideologji të gjalla në çdo nivel. Por a do të thotë fitorja e dikujt tjetër humbja e tjetrit, apo fakti që komunizmi dhe fashizmi e kanë humbur lojën do të thotë që liberalët me të vërtetë kanë fituar? Ai nuk pyet as nuk u përgjigjet këtyre pyetjeve.

Një tjetër argument i rëndësishëm i paraqitur nga Fukuyama është se pjesa e botës që ka arritur në fund të historisë është shumë më e zënë me ekonominë sesa me politikën. Kalimi i ideologjisë komuniste nënkupton rritjen e "marketizimit të përbashkët" të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe zvogëlimin e gjasave të konflikteve në shkallë të gjerë. Në "Reflektimet mbi Fundin e Historisë", Pesë vjet më vonë,²⁰¹ Fukuyama deklaroi se pohimi "fund i historisë" nuk është një deklaratë për gjendjen empirike të botës, por një argument normativ në lidhje me drejtësinë ose përshtatshmërinë e institucioneve liberale demokratike.

Përveç shkrimeve të Fukuyamës dhe Huntington, dy "intelektualë të tjerë në artin shtetëror" që tërhoqën vëmendjen në epokën e pas Luftës së Ftohtë ishin Zbigniew Brzezinski dhe Thomas Barnett.

Në librin e tij të titulluar "The Grand Chessboard", Brzezinski, i lindur në Poloni, i cili dikur shërbeu si këshilltar i politikës kombëtare të sigurisë të Presidentit Carter, trajtoi skenën botërore si një tabelë shahu dhe analizoi

¹⁹⁹ Huntington, "The Clash of Civilizations," p. 161.

²⁰⁰ Francis Fukuyama, "The End of History," in Toal; Dalby and Routledge (eds.), The Geopolitics Reader, pp. 114-124.

²⁰¹ Francis Fukuyama, "Reflections on the End of History: Five Years Later," History and Theory, Vol. 34, No. 2, 1995, p. 27

politikat që duhej ndjekur nga SHBA, siç ishte tani superfuqia e parë dhe e vërtetë e historisë. Kështu ai u përpoq të përcaktojë strategjinë e madhe për ruajtjen e pozicionit të jashtëzakonshëm të SHBA-së në botë me një fokus të veçantë në Euroazinë dhe që synonte hedhjen e "realiteteve" të bordit në të cilin do të luhej loja. Ai argumentoi se "Amerika është tani arbitri i Euroazisë, pa asnjë çështje të rëndësishme euro-aziatike zgjidhur pa pjesëmarrjen e Amerikës apo në kundërshtim me interesat e Amerikës".²⁰² Për të, ishte koha që Amerika të formulonte një gjeostrategji të integruar, gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë për të gjithë Eurazinë, "zemrën" e botës.

Thomas Barnett, në librin e tij më të mirë të New York Times: Harta e Re e Pentagonit: Lufta dhe Paqja në shekullin e njëzet e një kanë për qëllim krijimin e një strategjie "të re" për SHBA-të për të shpjeguar se si bota e re punon pas rënies së njërës nga superfuqitë.²⁰³ Ai gjithashtu e trajtoi botën si një fushë beteje të madhe dhe synonte të nxjerrë hartën e re për shtetasit e vendit të tij.

4. Përfundim

Ky punim ka për qëllim të sigurojë një ekzaminim historik të fushës së gjeopolitikës dhe një paraqitje të shkurtër të mendimit gjeopolitik Amerikan nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar teksteve të shekullit të nëntëmbëdhjetë, pasi këto tekste përbënin themelet e gjeopolitikës. Siç është ilustruar, etërit (fathers) gjeopolitikë ndanë disa ngjashmëri në lidhje me supozimet e tyre rreth gjeografisë dhe pushtetit. Një tjetër ngjashmëri që u treguan këtyre etërve gjeopolitikë ishte se ata punonin si teoricienë dhe praktikantë. Ata ishin njerëz që po përpiqeshin aktivisht të kontribuonin në zhvillimin e shteteve të tyre. Për më tepër, të gjitha shkrimet e tyre "kishin një kopje të ekspertizës dhe autoritetit". E fundit, por jo më pak e rëndësishme, ata i trajtuan argumentet e tyre gjeografike si rregulla natyrore dhe besonin se gjeopolitika ishte një shkencë objektive e bazuar në studimin e fenomeneve natyrore dhe ligjeve të natyrës.

Ky studim argumenton se në mënyrë që të arrihet një kuptim gjithëpërfshirës i historisë dhe teorisë së Marrëdhënieve Ndërkombëtare, duhet të trajtohen tekstet gjeopolitike të shekullit të nëntëmbëdhjetë si një ndër tekstet bazë të Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Fundi i Luftës së Ftohtë jo vetëm që shënoi ringjalljen e gjeopolitikës klasike, por edhe nxiti studime në fushën e "gjeopolitikës kritike", e cila tashmë ishte zhvilluar që nga viti 1980 si një nënfushë e gjeografisë politike.

Bibliografia

- Brzezinski, Zbigniew, *The Grand Chessboard*, New York: Basic Books, 1997.
- Defay, Alexandre, *Jeopolitik*, Ankara: Dost, 2005.
- Dodds, Klaus, "Cold War Geopolitics," in Agnew, John; Mitchell, Katharyne; Toal, Gerard (eds.), *A Companion to Political Geography*, Oxford: Blackwell, 2003, pp. 204-219.
- Dodds, Klaus, *Geopolitics: A Very Short Introduction*, New York: Oxford University Press, 2007.
- Flint, Colin, *Introduction to Geopolitics*, London: Routledge, 2006.
- Friedman, Thomas, *The Lexus and The Olive Tree*, New York: Knopf, 1999.
- Fukuyama, Francis, "Reflections on the End of History: Five Years Later," *History and Theory*, Vol. 34, No. 2, 1995, pp. 27-43.
- Fukuyama, Francis, "The End of History," in Toal, Gerard; Dalby, Simon; Peter Routledge (eds.), *The Geopolitics Reader*, London: Routledge, 1998, pp. 114-124.
- Hoffman, Stanley, "An American Social Science: International Relations," *Daedalus*, Vol. 106, No.3, 1977, pp. 41-60.
- Huntington, Samuel P. "The Clash of Civilizations," in Toal, Gerard; Dalby, Simon; Peter Routledge (eds.), *The Geopolitics Reader*, London: Routledge, 1998, pp.159-169.

²⁰² Brzezinski, *The Grand Chessboard*, 1997, p. 3.

²⁰³ Thomas P.M. Barnett, *The Pentagon's New Map: War and Peace in the Twenty-First Century*, London: Penguin, 2004.

Kearns, Gerry, "Imperial Geopolitics: Geopolitical Visions at the Dawn of the American Century," in Agnew, John; Mitchell, Katharyne; Toal, Gerard (eds.), *A Companion to Political Geography*, Oxford: Blackwell, 2003, pp. 173-187.

Kennan, George F., "The Sources of Soviet Conduct," 1947 in Toal, Gerard; Dalby, Simon; Routledge, Peter (eds.), *The Geopolitics Reader*, London: Routledge, 1998, pp.159-169.

Short, John Rennie, *An Introduction to Political Geography*, London: Routledge, 2003.

BIZNESET TURISTIKE DHE MIKROFINANCA NE SHQIPËRI

Prof.As.Dr. Ardita Boriçi -University of Shkodra “Luigj Gurakuqi”, Albania

Jetmir Muja, MBA University of Shkodra “Luigj Gurakuqi”, Albania

Albjona Selimi, MBA University of Shkodra “Luigj Gurakuqi”, Albania

Abstract

This study analyses the role of Microfinance Institutions (MFIs) financing in facilitating tourism development by discussing the link between microfinance and tourism enterprises. This paper identifies several obstacles tourism enterprises face in regards to microfinance. Tourism enterprises in Albania show high potential for business improvement and local and national institutions should take actions to help these businesses. Cooperation between public institutions, private institutions, MFIs and businesses can address several problems tourism enterprises face. This paper recommends that there is an urgent need for researchers to conduct studies to assess the role of MFIs financing in facilitating the tourism development especially in developing countries.

Hyrje

Koncepti i mikroekonomisë është një koncept i ri dhe ka fituar përdorim të gjërë vitet e fundit. Sipas Khan, Sajid dhe Rehman (2011) mikrofinanca është ofrimi i shërbimeve financiare të tilla si kursimi, huamarrja, remitancat, sigurimet dhe shërbimet jofinanciare si trajnime dhe marketing për të papunët, personat me të ardhura të ulëta të cilët nuk kanë pasur akses në shërbime të tilla. Këto shërbime zakonisht ofrohen nga institucionet mikrofinanciare (IMF) dhe targetojnë personat në vështirësi dhe të varfër. Qëllimi i mikrofinancës është të mbështesë prodhimin, të promovojë pronësinë e aseteve, të rrisë konsumin, të krijojë mundësi punësimi, të reduktojë riskun, duke ndikuar kështu rrjedhimisht në reduktimin e varfërisë tek klientët dhe të kontribuojë pozitivisht në përmirësimin e Produktit të brëndshëm bruto (PBB) (Magali, 2019).

Institucionet mikrofinanciare në vendet në zhvillim luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e aksesit për kredi, zhvillimin e një kulture kursimi për klientët dhe trajnimin e pronarëve të ndërmarrjeve të vogla e të mesme (SME) për çështje të ndryshme (Osoro & Muturi, 2013; Omondi & Jagongo, 2018). Për më tepër, IMF-të i shërbejnë grupeve të marzhinalizuara, të rinjve dhe grave të promovojnë rritjen dhe zhvillimin e biznesit të tyre më shumë sesa institucionet financiare të rregulluara formale (Magali, 2019; Seeku, Jaabi & Chandran, 2017). Nga ana tjetër, studime të ndryshme tregojnë lidhjen në mes institucioneve mikrofinanciare dhe bizneseve të cilat operojnë në industrinë e turizmit (Kola, Ceku, & Loca, 2019; Nagouda, 2022).

Turizmi rrit të ardhurat nga kurset e këmbimit, të ardhurat kombëtare dhe kontribuon në rritjen dhe zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar, nxit promovimin e vlerave ndër-kulturore duke sjellë performancë më të fortë globale (Sachs, 2015; Weaver, 2006; Choi & Sirakaya, 2005). Parë në këtë prizëm, është e rëndësishme të nxiten dhe mbështeten bizneset turistike, prandaj studimi synon të mbështesë përpjekjet për të diversifikuar opsionet e disponueshme të programeve të huadhënies me fokus turizmin. Rezultati i synuar është identifikimi dhe zhvillimi i shërbimeve financiare dhe jofinanciare që synojnë bizneset turistike.

Ndërmarrjet mikro dhe të vogla luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e vendit, pasi shumë biznese të suksesshme që ekzistojnë sot kanë nisur nga individë bazuar në ide kreative. Prandaj, mbështetja e këtyre ndërmarrjeve dhe ofrimi i shërbimeve financiare dhe jofinanciare të nevojshme për suksesin e tyre do të inkurajonte individë dhe investitorë të tjerë që kanë shpirt sipërmarrësi për të krijuar dhe zgjeruar bizneset e tyre. Në planin afatgjatë, kjo do të sjellë efekt pozitiv në ekonomi dhe komunitetet lokale në tërësi. Bizneset turistike në Shqipëri kanë dëshmuar aftësinë, efikasitetin dhe suksesin e tyre në përballjen me disa nga sfidat kryesore me të cilat përballlet fuqia punëtore në Shqipëri për shkak të qëndrueshmërisë së tyre, vetëpunësimit dhe shfrytëzimit më të ulët të kapitalit në krahasim me projektet në shkallë të gjërë. Këto biznese gjithashtu ofrojnë një platformë për zhvillimin e aftësive menaxheriale, teknike, prodhuese dhe aftësive të marketingut duke reduktuar në mënyrë indirekte presionin mbi sektorin publik për të ofruar mundësi punësimi të reja në tregun e punës.

Objektivat dhe metodologjia

Duke u mbështetur tek analiza cilesore, studimi synon të prezantojë një tablo të qartë rreth kërkesës dhe ofertës së institucioneve micofinanciare në shërbim të sektorit të turizmit. Qëllimi kryesor është diversifikimi i mundësive të huadhënies për bizneset turistike që operojnë në Shqipëri.

Metodologjia bazohet tek metoda cilësore, duke përdorur të dhënat primare (intervista me imf-oferta dhe bizneset turistike-kerkesa) dhe sekondare (artikuj, raporte, analiza).

Oferta-institucionet microfinanciare (imf-të)

Këtu paraqiten rezultatet dhe gjetjet kryesore të intervistave të kryera me imf-të, vëllimin e kredive të dhëna për ndërmarrjet mikro turistike nga imf-të e interesuara, kuadrin legjislativ që rregullon procesin e kreditimit dhe kontributin e imf-ve në zhvillimin dhe rritjen e mikrobizneseve turistike. imf-të janë të gatshme të japin kredi për aktivitetet turistike, por mungesa e programeve të specializuara dhe të diversifikuara të garancisë së kredisë, sigurimi i plotë i portofoleve të tyre të kredisë me një kosto të arsyeshme frenon dëshirën dhe vullnetin e tyre për të hyrë në këtë sektor të përceptuar me rrezik të lartë. Mungesa e të dhënave financiare dhe jofinanciare të besueshme dhe të sakta për mikro-ndërmarrjet turistike kufizon aftësinë e tyre për të matur tregun, duke zbuluar kështu mundësitë e humbura në tregun vendas. Disa imf pretendojnë se zyrtarët e tyre të kredisë nuk kanë informacion të mjaftueshëm mbi natyrën e mikrobizneseve turistike dhe si të vlerësojnë kërkesat e tyre për kredi. Disa nga imf-të nuk kanë një përkufizim standart për aktivitetet mikro turistike. Për shembull, restorantet ndonjëherë klasifikohen si aktivitet tregtar nga disa dhe si shërbim nga të tjerët. Shumica e imf-ve pohojnë se agjensitë qeveritare i kushtojnë më shumë vëmendje projekteve turistike në shkallë të gjërë. Gjithashtu imf-të kanë një division për zhvillimin e produktit, por produktet e huadhënies nuk janë të orientuara drejt një sektori/aktiviteti specifik ekonomik dhe për këtë arsye ato mund të aksesohen nga të gjitha bizneset, përfshirë turizmin. Analiza në seksionin vijues u përket dhjetë nga njëmbëdhjetë imf-të e intervistuar; një institucion refuzoi të jepte të dhënat e kërkuara.

Operacionet e imf-ve, garancitë e kredisë dhe politikat e kredisë. Gjatë vitit 2022, janë dorëzuar kërkesa mujore për kredi nga klientët, me një madhësi mesatare prej 457 mijë leke. Prej tyre 9.6 % e aplikimeve ishin për aktivitete turistike. Norma e miratimit të kredisë varioje nga 95% në 99%. Faktorët kritikë që imf-të marrin në konsideratë dhe fokusohen në vlerësimin e aplikimeve për kredi janë: aftësitë e huamarrësit për të shlyer këstet dhe interesin, fluksi pozitiv i parasë gjatë gjithë jetës së kredisë, faktorizimi në sezonalitet; aftësitë e huamarrësit për të ofruar garancitë/kolaterale të kërkuara; përvoja praktike dhe përkatëse/ekspertiza e huamarrësit për të menaxhuar në mënyrë efektive biznesin e tyre. Qëllimi i huasë është në përputhje me politikat e përcaktuara të kredisë. Pak nga imf-të e intervistuar miratojnë një qasje të centralizuar në funksionimin e tyre, ndërsa pjesa më e madhe ndjek një qasje të përzier të centralizuar/decentralizuar për vlerësimin dhe përpunimin e kërkesave për kredi. Në përgjithësi, marrja e një vendimi për kredinë kërkon një deri në pesë ditë pune, nga dita e paraqitjes së një aplikimi nga një huamarrës potencial deri në marrjen e vendimit përfundimtar të kredisë.

Kuadri legjislativ për imf-të. Ofrimi i shërbimeve financiare formale për personat që nuk kanë llogari bankare dhe individët me të ardhura të ulëta, luan një rol jetik në arritjen e përfshirjes financiare dhe rrjedhimisht të zhvillimit njerëzor dhe ekonomik. Procesi financimit të mësipërm kontribon në arritjen e sigurimeve ekonomike dhe sociale duke i kthyer këta individë në gjenerues të të ardhurave dhe jo në marrës të ndihmës financiare. Prandaj pasja e një organizate mbikqyrëse për sektorin mikrofinanciar u bë një domosdoshmëri. Objektivi kryesor i strategjisë është zhvillimi i një kuadri të unifikuar rregullator dhe mbikqyrës për sektorin mikrofinanciar. Në përgjithësi, akti nënligjor përcakton kuadrin legjislativ, duke përfshirë vendosjen e standarteve të larta të praktikave profesionale, duke rregulluar sektorin mikrofinanciar, duke mbrojtur huamarrësit e saj.

Zhvillimi i produkteve financiare/jofinanciare. Te gjitha imf-të e intervistuar kanë një njësi të dedikuar që merret me zhvillimin e produkteve/ shërbimeve ekzistuese dhe prezantimin e të reja. E katërta zhvillon produktet e saj financiare duke caktuar punonjës që kanë aftësi analitike për të studiuar dhe skanuar tregun vendas për të identifikuar mundësitë / programet e financimit. Të gjitha imf-të rishikojnë produktet e tyre në mënyrë periodike për të përditësuar veçoritë, temat dhe kushtet bazuar në hulumtimet dhe studimet e tregut.

Asnjë nga imf-të e intervistuar nuk ka produkte/ shërbime mikrofinanciare të fokusuar në turizëm. Megjithatë, programet e tyre mund të aksesohen nga të gjithë sektoret ekonomike, përfshirë turizmin si dhe shpesh diskutohet rreth një plani për të zhvilluar një produkt të ri financiar për bizneset mikroturistike në të ardhmen. Për sa i përket mbështetjes teknike të disponueshme, të gjithë imf-të ofrojnë shërbime jofinanciare dhe ofrojnë mbështetje teknike për klientët e tyre në fusha të ndryshme për të ndihmuar në përmirësimin e aftësive të tyre dhe në ndërtimin e kapaciteteve të tyre.

Pagesat me të cilat përballen imf-të për të dhënë me shumë kredi për sektorin e turizmit. Bankat janë burimi kryesor i fondeve për imf-të, me një pjesë më të madhe që vjen nga ato vendase. Zërat e kredisë të caktuara nga bankat zakonisht pasqyrojnë madhësinë dhe gjëndjen kreditore të një imf-je. Në përgjithësi, periudhat e shlyerjes janë rreth 9 muaj. Nga këndvështrimi i imf-ve të investuara, ka disa faktorë që rrisin rrezikun në shlyrje të kredive si: sezonaliteti i sektorit të turizmit dhe paqëndrueshmëria e performancës për sa i përket fluksit të parasë dhe të ardhurave vjetore të krijuara, kushtet e pasigurta ekonomike dhe sociale, duke ndikuar drejtpërdrejt dhe indirekt në marzhet e fitimit të biznesit dhe konkurrencën.

Kontributi i imf-ve në zhvillimin e mikrondërmarrjeve turistike. Kontributi i imf-ve në zhvillimin dhe rritjen e mikrondërmarrjeve turistike është nën pritshmëritë në lidhje me rolin e luajtur nga aktivitetet e sektorit, të cilat promovojnë punësimin, veçanërisht në fshatrat turistike dhe zonat e thella. Ato janë gjithashtu thelbësore për rimëkëmbjen e sektorëve të tjerë të ekonomsë. Shumica e imf-ve hezitojnë të japin më shumë kredi për sektorin e turizmit për shkak të shumë faktorëve të përmendur më heret, ku kryesorët janë sezonaliteti dhe ndjeshmëria e lartë ndaj faktoreve ekonomik dhe social.

Normat e interesit të kredise dhe gjatësi për pagesat e detyrueshme. imf-të e intervistuar ngarkojnë norma interesit për produktet financiare me një mesatare prej 18.5%. Përveç normave të larta të interesit shumica e IMF-ve vendosin gjatësi të cilat arrijnë deri në rreth 0.65% e kestit në ditë vonese, nëse një huamarrës nuk paguan në kohë një kësht kredie. Për më tepër, ka efekte negative të normave të interesit të kredisë mikro, kostoja e financimit për mikrondërmarrjet është mesatarisht 8-10% më e lartë se kostoja e marrjes së financave nga bankat lokale për ato me akses. Për shumë biznese mikro, normat e larta të interesit janë një pengesë kryesore për marrjen e fondeve adekuate nga imf-të.

Shuma e huasë, afati dhe periudha e faljes. Pas studimit të veçorive të produkteve financiare të prezantuara nga imf-të e intervistuar, është konstatuar se shumave minimale të kredisë që mund të aksesohet nga nënsektorë të ndryshëm ekonomike, specifikisht në turizëm, është rreth 100 mijë lekë, ndërsa maksimale është mbi 10 milionë lekë. Periudhat e shlyerjes së kredisë variojnë nga 6 deri në 24 muaj. Megjithatë, për rastin e investimeve në sektorin e turizmit, klientëve ju ofrohet edhe mundësia e një periudhe mospagimi deri 12 muaj.

Kërkesa-bizneset turistike

Për të inkurajuar rritjen e turizmit është thelbësore të kapërcehet hendeku financiar në mënyrë të qëndrueshme dhe të rriten mundësitë e financimit të bizneseve. Kjo është e nevojshme për të nxitur zhvillim ekonomik dhe shpërndarë fitimet në segmente të vende të ndryshme në Shqipëri. Huamarrja e parave me kosto të arsyeshme, me koleteral të vogël do të mundësonte biznese turistike të rrisin operacionet e tyre dhe të përfitojnë nga avantazhi konkurrues duke ofruar produkte të shërbime të reja me çmime konkurruese. Kjo do të tërhiqte më shumë turistë dhe klientë vendas. Nga ana tjetër, zbutja e vështirësive, me të cilat përballen pronarët e bizneseve turistike në sigurimin e kredive është thelbësore për rimëkëmbjen e sektorit të turizmit sidomos pas periudhës së pandemisë së Covid-19 pasi kërkesa turistike po kthehet në gjendje normale.

Përpjekjet e përbashkëta dhe bashkëpunimi ndërmjet agjensive qeveritare, sektorit privat, institucioneve mikrofinanciare dhe bizneseve mund të luajnë një rol jetik në adresimin e sfidave me të cilat përballen bizneset turistike. Atyre duhet të sigurohen lloje të ndryshme mbështetjeje për të zhvilluar dhe të mbështesin zgjerimin e biznesit. Në mënyrë të përmblodhur më poshtë janë të paraqitura problematikat:

Nevojat financiare të pronarëve të bizneseve turistike për të krijuar dhe/ose zgjeruar biznesin e tyre – Gjetjet tregojnë që pronarët e bizneseve turistike kërkojnë financim për disa arsye. Këto përfshijnë blerjen e aseteve fikse (makineri, pajisje, pajisje shtëpiake, vegla dhe mobilje), themelimin e një biznesi të ri, pjesëmarrje në trajnime të ndryshme,

shpenzime rinovimi, sigurimin e lëndëve të para, mbulimin e shpenzimeve operative (paga, qiranë, tarifat e licencës, etj.), mbulimin e shpenzimeve të marketingut, punësimin e stafit shtesë për zgjerimin e biznesit, krijimin e web-faqeve për promovimin e biznesit.

Pengesat që hasin sipërmarrjet turistike në marrjen e kredive – Ndër problematikat më të theksuara në marrjen e kredive është pamundësia për të siguruar koleteralin e kërkuar dhe normat e larta të interesit. Ndër problematikat tjera mund të përmendim pamundësia e pronarëve për të kryer studime fizibiliteti dhe përgaditur pasqyrat thelemelore financiare, shumat tavan të kredisë, periudha të shkurtra të faljes dhe shlyerjes së kredisë (periudhat e mospagimit), kohëzgjatja dhe kompleksiteti i procedurave për marrjen e një kredie së bashku me numrin e madh të dokumentave të kërkuara nga institucionet mikrofinanciare.

Fushat e mbështetjes teknike të nevojshme për bizneset turistike – Fushat kryesore të mbështetjes për bizneset e turizmit për të krijuar sipërmarrje të reja ose për të zgjeruar bizneset e tyre ekzistuese i kemi klasifikuar në tre kategori:

- *Trajnime menaxheriale:* menaxhim projekteve, marketing, shërbimi ndaj klientit, marketing dixhital, përgaditja e studimeve të fizibilitetit, zhvillimi i biznesit, përcaktimi i çmimeve dhe kostove, planifikimi i biznesit, planifikimi financiar, kontrolli i cilësisë.
- *Trajnime teknike:* aftësi artizanale, prodhim ushqimi (gatim), paketim, qepje e qëndisje, qëndisje elektronike, dizajn modës.
- *Mbështetje tjetër:* pjesëmarrje në ekspozita brenda dhe jashtë vendit.

Ndërgjegjësimi për termat dhe kushtet e aplikimit për kredi – Shumica e të interesuarve, veçanërisht ata që jetojnë në rrethina nuk kanë informacion të mjaftueshëm mbi kushtet dhe kërkesat e institucioneve mikrofinanciare për të aplikuar për kredi. Kërkesa të tilla përfshijnë garanci/koleteral, të dhëna historike financiare të huamarrësit, paraqitje të pasqyrave bankare, mbajtjen e kontabilitetit të rregullt, përgaditjen e studimeve bazë të fizibilitetit dhe pasqyrat e fluksit të parasë (për projekte të reja).

Sezonaliteti i operimit të bizneseve të turizmit – Shumë prej bizneseve në fushën e turizmit operojnë përgjatë muajve të caktuar çka ka ndikuar negativisht në interesimin e këtyre biznese për sigurimin e kredive nga institucionet e mikrokredisë.

Referenca

- Choi, H.-S. C., & Sirakaya, E. (2005). Measuring residents' attitude toward sustainable tourism: Development of sustainable tourism attitude scale. *Journal of travel research* , 43 (4), 380-394.
- Khan, S., Sajid, M.R., & Rehman H. (2011). Women's empowerment through microcredit: a case study of district Gujrat, Pakistan. *Academic Research International*, 1(2), 332-343.
- Kola, F., Ceku, B., & Loca, S. (2019). The Relationship Between Microfinance and Tourism (Case of Albania). *Fifth International Scientific-Business Conference LIMEN* (pp. 165-171). Graz: Graz University of Technology.
- Magali, J. (2019). The Role of MFIS Financing in Facilitating Tourism Development: Review of Empirical Literatures. *International Conference on the Future of Tourism (ICFT)* (pp. 230-241). Tanzania: The Open University of Tanzania.
- Nagouda, S. S. (2022). An Intervention of Microfinance in Tourism Sector: An Emerging Country Perspective. *Atna Journal of Tourism Studies* , 17 (2), 165-191.
- Omondi, R. I. A. & Jagongo, A. (2018). Microfinance services and financial performance of small and medium enterprises of youth SMEs in Kisumu County, Kenya. *International Academic Journal of Economics and Finance*, 3(1), 24-43.
- Osoro, K. & Muturi, W. (2013). The role of micro financial institutions on the growth of SMEs in Kenya: A case study of micro financial institutions in Kisi Town. *IOSR Journal of Humanities and Social Science*, 16(1), 83–93. <https://doi.org/10.9790/0837-1618393>.
- Sachs, J. D. (2015). *The Age of Sustainable Development*. Columbia University Press.
- Seeku, A. K., Jaabi & Chandran, V. G. R. (2017). Microfinance institutions in rural Gambia : Case study of village savings and credit associations credit associations. *International Journal of Development Research*, 5(04), 4162-4169.
- Weaver, D. (2006). *Sustainable Tourism: Theory and Practice*. New York: Routledge.

NDIKIMI I MËNYRËS SË TRAJTIMIT NË MOTIVIMIN E PUNËTORËVE NË NDËRMARRJE

Msc. Valbone Ramaj Phd Candidate-Kolegji Biznesi, Prishtine

Abstrakt

Shoqëria jonë nuk do të ekzistonte ashtu sikurse e njohim sot dhe as do zhvillohej me këto parametra në praninë e menaxhereve, të cilët drejtojnë organizatat e saj. Kështu theksonte P.Drucker, 2003 për të cilin menaxhimi efektiv është, ndoshta burimi kryesor i vendeve të zhvilluara dhe burimi me i domosdoshëm për zhvillimin e mëtejshme të tyre. Kështu që në kohët moderne mundësitë potenciale për progres janë të lidhura ngushtë, veçanarisht në cilësinë e menaxhimit.

Organizatat bashkëkohore kanë menaxherët e burimeve njerëzore të cilët kanë për detyrë që në organizatë të planifikojnë burimeve njerëzore, të bëjnë rekrutimin ose zgjedhjen, seleksionimin që është aplikimi i kriterëve për të zgjedhur, të organizojnë zhvillimin (trajnimin, edukimin e vazhdueshëm për tu përshtatur ndryshimeve, përparimin në profesion), ti motivojnë punonjësit që të arrihen rezultatet më të mira, etj. D.m.th menaxhimi i burimeve njerëzore është një proces për sigurimin e njerëzve të duhur në vendin e duhur dhe në kohën e duhur.

Njerëzit e duhur për të punuar sa më mirë qoftë të cilët do nivel hierarkik në organizatë, deshirojnë të motivohen, të shpërblehen për punën e tyre. Motivimi si proces paraqet një ndërthurje të dëshirave, nevojave, shtytjeve dhe kërkesave për plotësimin e nevojave personale të individit. Efikasiteti i procesit të motivimit vihet në pah atëherë kur harmonizohen qëllimet personale me qëllimet e organizatës.

Fjalet kyqe: motivimi, menaxhimi, burimet njerëzore, ndermarrje

Abstract

Our society would not exist as we know it today nor would it develop with these parameters in the presence of managers who run its organizations. This is how P.Drucker emphasized, 2003, for whom effective management is, perhaps, the main source of developed countries and the most necessary source for their further development. So in modern times potential opportunities for progress are closely related, especially in the quality of management.

Contemporary organizations have human resource managers who have the task of planning human resources in the organization, making the recruitment or selection, the selection which is the application of criteria to choose, organizing the development (training, continuous education to adapt to changes, professional advancement), motivate employees to achieve the best results, etc. That is, human resource management is a process for ensuring the right people in the right place and at the right time.

The right people to work as well as possible at any hierarchical level in the organization, want to be motivated, rewarded for their work. Motivation as a process represents a combination of desires, needs, drives and requirements for meeting the personal needs of the individual. The effectiveness of the motivation process is highlighted when personal goals are aligned with the goals of the organization.

Key words: motivation, management, human resources, entrepreneurship

Hyrje

Shoqëria jonë nuk do të ekzistonte ashtu sikurse e njohim sot dhe as do zhvillohej me këto parametra në praninë e menaxhereve, të cilët drejtojnë organizatat e saj. Kështu theksonte P.Drucker, 2003 për të cilin menaxhimi efektiv është, ndoshta burimi kryesor i vendeve të zhvilluara dhe burimi me i domosdoshëm për zhvillimin e mëtejshme të tyre. Kështu që në kohët moderne mundësitë potenciale për progres janë të lidhura ngushtë, veçanarisht në cilësinë e menaxhimit.

Menaxhimi si disiplinë shkencore është proces i planifikimit, i organizimit, i personelit, i udhëheqjes dhe i kontrollit. Do të ndalemi te personeli për tu njohur me rolin e tij si njëri prej resurseve ndoshta më të rëndësishme që ka në dispozicion një menaxher në një organizatë. Burimeve njerëzore në dispozicion nuk mjafton vetëm ti kesh, por duhet menaxhuar në mënyrë që t'i shfrytëzojmë racionalisht (Llaci, Sh. 2003).

Departamentet e burimeve njerëzore përfshijnë individët me një shumëllojshmëri njohurish, aftësish dhe zotësish të nevojshme këto për kryerjen e aktiviteteve që cojnë në realizimin e objektivave të organizatës. Sëra me efektivitet do t'i shfrytëzojmë këta punonjës varet nga cilësia e programit të burimeve njerëzore. Sa i përket termit "menaxhimi i personelit", në të kaluarën është menduar se me vetë sigurimin ose ekzistencën e të punësuarëve është kryer misioni (Kutllovci, E. 2004).

D.m.th. Punonjësit në organizatë janë konsideruar si një burim relativisht jo fleksibël në krahasim me burimet e tjera si paratë apo materialet. Por ky koncept tani shëndrrohet në konceptin e menaxhimit të burimeve njerëzore që paraqet procesin e planifikimit të nevojave për personel, organizimin, ushtrimin, zhvillimin dhe përparimin e personelit. Pra me term të ri nënkuptojmë se punonjësit nuk janë thjesht një shpenzim, por një burim i organizatës, ashtu sikurse janë kapitali apo pajisjet e tjera, madje burimi më i rëndësishëm i saj.

Organizatat bashkëkohore kanë menaxherët e burimeve njerëzore të cilët kanë për detyrë që në organizatë të planifikojnë burimeve njerëzore, të bëjnë rekrutimin ose zgjedhjen, seleksionimin që është aplikimi i kriterëve për të zgjedhur, të organizojnë zhvillimin (trajnimin, edukimin e vazhdueshëm për tu përshtatur ndryshimeve, përparimin në profesion), ti motivojnë punonjësit që të arrihen rezultatet më të mira, etj. D.m.th menaxhimi i burimeve njerëzore është një proces për sigurimin e njerëzve të duhur në vendin e duhur dhe në kohën e duhur.

Njerëzit e duhur për të punuar sa më mirë qoftë të cilit do nivel hierarkik në organizatë, deshirojnë të motivohen, të shpërblehen për punën e tyre. Motivimi si proces paraqet një ndërthurje të dëshirave, nevojave, shtytjeve dhe kërkesave për plotësimin e nevojave personale të individit. Efikasiteti i procesit të motivimit varet në pah atëherë kur harmonizohen qëllimet personale me qëllimet e organizatës.

1. Përkufizimi i problemit

Trajtimi i punonjësve në të njëjtën mënyrë si burimet e tjera është trajtuar shumë midis hulumtuesëve, menaxhereve dhe në mes tjerash në masë të madhe midis punonjësve. Koncepti i hershëm i shihet punonjësit si të gjithë burimet e tjera duke i trajtuar ata si makineri që duhej të bënin të njëjtën punë gjithmonë dhe duke limituar në këtë mënyrë qëllimin e tyre për rritje dhe marrje të iniciativës. *Ka ndryshuar në një masë trajtimi i punonjësve në organizatën biznesore. Trajtimi i punonjësve lidhet me motivimin e punonjësve. Motivimi i punonjësve ndihmon në rritjen e produktivitetit dhe cilësisë. Ka shumë mënyra për të promovuar punën në skuadër dhe kreativitetin.* Punonjësit e motivuar janë të nevojshëm në vendet e punës sepse ato ndihmojnë organizatat të mbijetojnë. Punonjësit të motivuar janë më produktive. Për të qenë efektiv, menaxherët duhet të kuptojnë se çfarë i motivon punonjësit brenda kontekstit të roleve që ata kryejnë. Nga të gjitha funksionet që një menaxher kryen, motivimi i punonjësve është ndoshta më e ndërlikuar. Kjo është për shkak, se ajo që i motivon punonjësit pëson ndryshime të vazhdueshme (Smith, 1994).

Ky studim ka si qëllim të jap një tablo të qartë të koncepteve dhe termave që shoqërojnë organizatën. Duke marrë thelbin nga literatura dhe publikime të ndryshme janë bërë përpjekje që të krijohet një udhëzues me një strukturë të përmbledhur në lidhje me këtë studim. Studimi nis me disa koncepte të përgjithshme të menaxhimit të burimeve njerëzore e posaqërisht dhe trajtimit të punonjësve në biznese.

Më pas punimi zgjerohet me konceptin e stresit në organizatë, i cili tashmë është një fenomen në biznese. Mandej parashtrahet pjesa e konceptit të motivimit dhe rëndësinë e tij në një organizatë, si ndikon ai në rritjen e performancës dhe produktivitetit dhe si duhet të aplikohen skemat e shpërblimit tek punonjësit. Se fundmi tema paraqet përfundime të kërkimit dhe ndalet në përfundime dhe rekomandime të përgjithshme.

2. Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi i këtij studimi është të përcaktoj rëndësinë e motivimit në organizatë si komponent që ndikon në rritjen e produktivitetit dhe efikasitetit.

Studimi synon:

- Të kuptojmë se si motivimi në organizatës,
- Të na njoh me problemet e stresit në organizatë
- Dhënien e disa konkluzioneve dhe rekomandimeve për përmirësimin e gjëndjes.

Objektivi i studimit

- Motivimi i punonjësve në organizatë,
- Stresi dhe ndikimet që ajo ka në organizatë,
- Strategjitë që duhen ndëkur për motivimin e punonjësve në organizatë.
-

3. Roli i menaxhmentit të burimeve njerëzore

Fjalën Menaxhment për herë të parë e përdori Frederick Ë. Taylor themeluesi i menaxhmentit si disiplinë shkencore në pjesën e dytë të shekullit të XIX-të. Një prej definicioneve të shumta për menaxhmetin është si vijon: “**menaxhmenti** definohet si (1) të gjitha veprimtaritë afariste (**funksionet menaxherike**) (2) të cilat i realizojnë **menaxheret**, (3) në kuadër të formës së përshtatshme afaristo-organizative (**organizata**), (4) duke angazhuar resurset e nevojshme (**resurset**), (5) me tendencë që të sigurohet bilanci përkatës në mes (5.1) **efektivitetit** dhe (5.2) **efikasitetit** (5.3) **afatshkurtër** dhe (5.4) **afatgjatë** (Shunje, 2003). Ndërsa, “procesin e planifikimit të nevojave për personel, organizimin, ushtrimin, zhvillimin dhe përparimin e personelit e quajmë menaxhment të resurseve humane” (Kutllovci, E. 2004).

Shekujt e fundit karakterizohen me zhvillimin e shkencave të ndryshme bashkëkohore të rëndësishme për zhvillimin dhe përparimin e procesit të ekonomisë të një shteti, e që pastaj shërben si mostër edhe për shumë vende tjera. Ndër këto shkenca të zhvilluara së fundmi gjendet Menaxhmenti dhe si degë e saj edhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, me një rol shumë thelbësor dhe domethënës për funksionimin e organizatave me veprimtari të ndryshme, kompanive shërbyese apo firmave me karakter prodhues.

Edhe pse resurset e një ndërmarrje përbëhen nga burime të ndryshme, siç janë burime financiare, fizike apo informata, të gjitha këto resurse duhet të realizohen përmes burimit më të rëndësishëm të një kompanie, faktorit “njeri”. Njeriu si faktor/resurs i kompanisë, duhet të merret me alokimin e drejtë të resurseve financiare, kujdesin dhe mirëmbajtjen e burimeve fizike (mjeteve) si dhe përpunimin e informatave të nevojshme për funksionimin e ndërmarrjes së caktuar. Andaj, njeriu mund të identifikohet si organizator, planifikues, udhëheqës, zbatues dhe kontrollor i këtyre proceseve në ndërmarrje. Dëshiroj të theksoj, se të gjitha këto funksione njeriu jo vetëm që i zbaton duke punuar në një ndërmarrje të caktuar, institucion publik apo organizatë biznesore, por janë edhe pjesë e jetës së tij të përditshme personale dhe familjare. Për ti kryer të gjitha këto funksione njeriu duhet të jetë i motivuar në mënyra të ndryshme, dhe ky punim ka për qëllim të shtjelloj një prej temave më interesante dhe sfiduese të kohës së fundit, tema e quajtur *motivim i personelit*.

Koncepti i burimeve njerëzore është zgjeruar nga termi menaxhim i burimeve njerëzore në zhvillim të burimeve njerëzore, i cili ka të bëjë me mbështetjen dhe aftësitë që u jepen punonjësve jo vetëm për të realizuar punën e tyre, por edhe për t’u përgatitur për rritjen e karrierës së tyre. Menaxhimi i burimeve njerëzore ka kaluar nëpër një proces të gjatë zhvillimi, derisa ka arritur në statusin që ka fituar sot, një nga funksionet më të rëndësishme të menaxhimit në një organizatë (Koli.Z, Llaci.Sh, 2005).

Menaxhimi i burimeve njerëzore është ajo pjesë e procesit të menaxhimit e përqëndruar në relacionet njerëzore dhe sigurimin e mirëqënies së tyre, me qëllim që ata të japin kontributin maksimal në punë. Instituti i Menaxhimit të Personelit në Britaninë e Madhe jep një përkufizim të tillë për këtë funksion: “Menaxhimi i personelit është ajo pjesë e menaxhimit e preokupuar për njerëzit në punë dhe për marrëdhëniet e tyre në kuadrin e një organizate. Qëllimi i tij është që të bashkojë dhe të zhvillojë punonjësit që e përbëjnë atë dhe është e preokupuar në mirëqenien e çdo individi dhe të ekipeve të punës për të nxitur ata që të japin kontributin maksimal për suksesin e organizatës. Menaxhimi i

burimeve njerëzore erdhi si pasojë e faktit që organizatat i kërkonin punonjësve të punonin dhe të prodhonin më shumë seç shpërbleheshin (Appelbaum. E, Bailey. T, 2000).

Kuptimi i burimeve njerëzore ndryshoi me kalimin e viteve për shkak se koncepti i organizatave u zgjerua dhe punonjësit filluan të trajtoheshin më tepër si qenie njerëzore dhe jo si materiale të gjalla apo sisteme organizacionale (Fisher, D. 1989).

Një përkufizim i thjeshtë, por racional paraqitet si vijon: “Menaxhimi i burimeve njerëzore është procesi i tërheqjes, zhvillimit dhe mbajtjes së një force pune të talentuar dhe energjike për të mbështetur misionin, objektivat dhe strategjitë organizative”. (J.Schermerhon, 2001).

Sipas një përkufizimi bazë, me burim do të kuptojmë çdo gjë që ka një vlerë, që është e disponueshme dhe është e dobishme për prodhimin e burimeve të tjera. Nën këtë përcaktim mund të përfshihet çdo gjë që përdoret nga njerëzit. Për shembull, një produkt natyral si nafta mund të quhet një burim sepse është i vlefshëm dhe i dobishëm pasi me anë të tij prodhohet energji apo përftohet benzinë, dhe gjendet i disponueshëm në sasi të mjaftueshme. Të tilla burime natyrore mund të jenë dhe uji, ajri, toka, malet, pyjet, bimët dhe kafshët. Nën këtë përkufizim përfshihen dhe gjërat jo natyrore të cilat janë të vlefshme, të dobishme dhe të disponueshme si paratë, teknologjitë, aftësitë dhe njohuritë.

Gjatë epokës industriale burimet njerëzore kanë pasur një rol të ngjashëm me materialet, kapitalin apo makineritë. Me ndryshimin e këndvështrimit të faktorëve të ndryshëm që ndikonin tek performanca e individëve, u ndryshua dhe mënyra e menaxhimit të punonjësve. Më tej me futjen e epokës së teknologjisë së informacionit dhe globalizimit, organizata, me qëllim që të ishte konkurruese në një mjedis global biznesi, filloi t’i trajtonte burimet njerëzore si një aktiv të vlefshëm të saj. Kjo gjë çoi në ngopjen e punonjësve me mësim dhe në ndërprerje të punës së makinerive në një nivel të caktuar.

Studiues të shumtë ndërmorën kërkime të shumta për të zbuluar arsyet që ndalonin rritjen e punonjësve dhe shkaktonin pakënaqësi midis tyre. Konkluzioni i tyre ishte që punonjësit pretendonin të trajtoheshin në një mënyrë më njerëzore. Ata kërkonin të konsideroheshin si pjesë e një grupi dhe të nxiteshin dhe në mënyra të tjera dhe jo thjesht me mjete monetare. Nevojat sociale, nevojat e përkatësisë apo të përmbushjes ndikonin shumë në sjelljen e punonjësit në organizatë (Porter et al, 2003).

Me hyrjen në lojë të studiuesve të tillë si Maslow, Herzberg, Vroom, filluan të zhvilloheshin teori të reja të menaxhimit të punonjësve, të cilat bazoheshin në psikologjinë e punonjësit. Këto teori sugjeronin motivimin e burimeve njerëzore nëpërmjet përmbushjes së dëshirave dhe nxitjeve të punonjësve. Ky koncept i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe trajtimit të punonjësve u bë shumë i preferueshëm në fillim të shekullit të 20 dhe deri në vitet 50-60. Ai hodhi themelet e menaxhimit të sotshëm modern i cili bazohet në leadershipin dhe motivimin e njerëzve nëpërmjet aftësive që ata zotërojnë.

Manaxhimi i burimeve njerëzore është një fushë kërkimi relativisht e re e cila është e mbushur me mendime heterogjene dhe që shpesh herë bien në konflikt me njëra-tjetrën. Duke patur parasysh origjinën dhe influencat e ndryshme nuk ekziston një përshkrim ekzakt për manaxhimin e burimeve njerëzore si dhe fushën që ai përfshin. Manaxhimi i burimeve njerëzore përfshin një tërësi termash si manaxhim personeli dhe marrëdhënie industriale. Manaxhimi i personelit ka të bëjë me administrimin dhe zhvillimin e punonjësve, përfshin dhe përmbledh principe, sisteme dhe metoda të përdorura nga kompanitë për të tërhequr, mbajtur dhe për të zhvilluar punonjësit e saj.

Nga ana tjetër, marrëdhënie industriale lidhet me marrëdhëniet kolektive ndërmjet elementëve të një organizate, pra tregon marrëdhëniet e punonjësve dhe njerëzve të tjerë. Koncepti i manaxhimit të burimeve njerëzore përfshin lidhjen, ndërveprimin dhe integrimin e individëve, të punës si dhe të organizatës në përgjithësi. Carrel, M.R., Norbert, F. and Robert, D.H. (1995). Individët rekrutohen në organizatë për të performuar në bazë të përshkrimit të punës së tyre. Kështu është e arsyeshme që puna dhe individi në organizatë të shikohen sëbashku dhe jo si dy elementë të pavarur dhe të palidhur me njëri - tjetrin.

Ato duhet të konsiderohen si dy elementë që janë të ndërvarura dhe të cilat sëbashku na japin efektin e sinergjisë. Emërtimi i punës përcaktohet nga kompania dhe është një pjesë e aktiviteteve të organizatës.

Prandaj është e rëndësishme të konsiderojmë emërtimin e punës, përshkrimin e saj dhe zhvillimin në kontekstin organizacional jo si një aktivitet i izoluar i cili as nuk ndikohet dhe as nuk ndikon në organizatë. Prandaj, organizata, individit dhe emërtimi i punës bashkëveprojnë dhe shkëmbejnë shpesh me njëri -tjetrin.

Më parë manaxhimi i burimeve njerëzore ishte i fokusuar në tre aspekte si individit emërtimi i punës dhe organizata si tre faktorë që ndërveprojnë dhe ndërlidhen me njëri tjetrin. Duke ndjekur këtë linjë veprimi ne arrijmë në një diskutim në nivel mikro për sa i përket manaxhimit të burimeve njerëzore dhe nuk do të na ndihmojë të arrijmë në konkluzione të rëndësishme për këtë temë. (P.Kottler. J, 1998)

Pra perceptimi i manaxhimit të burimeve njerëzore duhet të ndryshojë drejt një drejtimi ku manaxhimi i burimeve njerëzore është pjesë e kontekstit organizacional dhe e mjedisit të saj gjithashtu.

4. Kuptimi i personelit në biznes

Punonjësit apo personeli i biznesit në një organizatë janë burimet njerëzore që punojnë njëkohësisht në organizatë, qoftë në nivelit shtetor – në organet e ndryshme relevante, apo qoftë edhe organizata biznesore.

Aftësimi i personelit në kushtet e tanishme kryesisht bëhet nëpërmjet shkollimit, ndërsa një numër shumë i vogël këto aftësi i zhvillon nëpërmjet përvojës në ndërmarrje. Aftësimi i biznesmenëve, menaxherëve, kryesisht është formal - nëpërmjet shkollimit. Mungojnë institucionet e trajnimit dhe edukimit për biznes për nevojat e reja.

Kur të jenë përcaktuar detyrat për arritjen e qëllimeve në fazën e organizimit. Në këtë fazë është e domosdoshme të sigurohen kuadrot me strukture kualifikuese përkatëse. Kjo nënkupton aktivitetet vijuese :

- ✓ përgaditjen e planit të kuadrove në baze të politikës së kuadrove përkatësisht strategjies së zhvillimit afatgjatë,
- ✓ sigurimin e kuadrove sipas dinamikës së aprovuar të planit të kuadrove,
- ✓ shkollimin dhe zhvillimin e kuadrove,
- ✓ vlerësimin e punës,
- ✓ etika e kuadrit,
- ✓ siguriin e kushteve të punës dhe jetësore etj (Havolli, Y. 2003).

Detyra e pronarit të biznesit është për të siguruar që punëtorët të kenë një shkallë të lartë të motivimit. Motivimi i punëtorëve ndikon pozitivisht në rritjen e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve, në rritjen e efikasitetit dhe produktivitetit. Çelësi për një ndërmarrje të suksesshme është motivimi i punëtorëve.

Punonjësit e biznesit duhet të kuptojnë punën dhe do të jenë të motivuar drejt qëllimeve dhe objektivave të ndërmarrjes. Aktivitetet vlerësohen, vendosen dhe zbatohen në mënyrë të unifikuar minimizohen problemet që dalin nga keqkuptimet në komunikim midis niveleve të ndryshme të hierarkisë në kompani.

Struktura kualifikuese e personelit në bizneset e Kosovës mund të themi se ajo është relativisht e kënaqshme. Këtë konstatim e bazojmë vetëm duke marrë për bazë nivelin formal të shkollimit, e jo edhe përgatitjen personale e nivelin menaxherik për udhëheqje të ndërmarrjes.

Sipas Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK), deri në fund të muajit mars, 2013, gjithsej në Kosovë janë regjistruar 114.131 biznese. Nga numri i përgjithshëm i bizneseve të regjistruara 98,4% janë mikro biznese që punësojnë 1 - 9 punëtorë. Vetëm 1,3% janë ndërmarrje të vogla që punësojnë 10 - 49 punëtorë.

Sipas Agjencionit Kosovar të Regjistrimit të Bizneseve (2015), nga viti 2008, në baza vjetore, mesatarisht janë regjistruar rreth 6.500 ndërmarrje. Në vitin 2011 ky numër është rritur në 7.835 ndërmarrje të regjistruara. Përqendrimi më i madh i ndërmarrjeve është në rajonin e Prishtinës më 37,1%, pasuar nga Gjilani 20,8 %, Peja 16,5 %, Prizreni 15,2 % dhe Mitrovica me 10,4%.

Sa i përket llojit të pronësisë, regjistrimi i ndërmarrjeve si biznese individuale është forma më e shpeshtë e pronësisë në Kosovë, me 89,08 %. Si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar janë regjistruar 6,70 %, ndërsa ortakëri e përgjithshme janë të regjistruara 3,2%. Në përgjithësi më së shumti ka ndërmarrje tregtare me rreth 43%, të pasuara nga ndërmarrjet shërbyese me 39% dhe ndërmarrjet prodhuese me 18%. Sektori i NVM-ve punëson 232.411 të punësuar apo rreth 63% të totalit të të punësuarve në Kosovë. Në totalin e eksportit NVM-të marrin pjesë me 47,6% (ARBK).

Në fillim të vitit 2011, Agjencia për Mbështetjen e NVM-ve (AMNVM) ka bërë një hulumtim me 800 NVM lidhur me problemet kryesore me të cilat këto ndërmarrje ballafaqohen. Studimi tregon se këto probleme kryesore janë: qasja në financa, mungesa e energjisë elektrike dhe konkurrenca jo-formale.

5. Kuptimi i procesit të motivimit të punonjësve në punë

E sa i përket vendit të punës, motivimi i punonjësve është i një rëndësie të madhe. Në këtë kapitull do të kuptojmë motimin si thenje, rolin e motivimit në ngritjen e kënaqësisë së punonjësve dhe performancës së bizneseve.

Përveq kësaj do të hulumtojmë shkaqet e demotivimit dhe ndërmarrjen e hapave të nevojshme nga menaxheret e burimeve njerzore, për hartim, planifikimi, zbatim të strategjive të motivimit. Problemet që hasen nga udhëheqësit apo menaxherët dhe punonjësit e organizatës që demotivohen.

Kështu që sipas Ramosaj, B. 2007 në librin Bazat e menaxhimit thekson, Motivimi i punonjësve nuk është vetëm problem psikologjik dhe social i punës dhe sjelljes punuese, por sjellja është e drejtuar kah ndonjë qëllim i cili zgjon nevojat (e nxitura) të paraqitura brenda njeriut, e qëllimi i sjelljes është kënaqja e nevojave. Që njeriu të jetë në gjendje të motivoj të tjerët, së pari duhet të njoh dhe motivoj vetvetën, e pastaj të tjerët. Kështu që sipas Ramosajt mund kuptojmë më fjalë tjera, se motivimi paraqet vullnetin apo dëshirën për të performuar.

Motivi është arsyeja për të bërë diçka. Motivimi ka të bëjë me faktorët të cilët ndikojnë në njerëz që të sillen në mënyrë të caktuar. Është shumë e rëndësishme që proces i motivimit të aplikohet në ndërmarrjet/organizatat tona, por kjo behet e vështirë për arsye të ndryshme(Kutllovci, E. 2004).

“Shprehja *motivim* rrjedh nga fjala latine, *moves, movere*, që do të thotë *lëvizje*” (Ramosaj, B. 2007). Prioritet i menaxhmentit bashkëkohorë të resurseve njerzore është bërë motivimi dhe kënaqësia e personelit, pasi vetëm përmes ndërtimit të sistemit motivues organizata mund ti rritë aftësitë konkurruese dhe vlerat e saj. “Motivimi i punonjësve nuk është vetëm problem psikologjik dhe social i punës dhe sjelljes punuese, por sjellja është e drejtuar kah ndonjë qëllim i cili zgjon nevojat (e nxitura) të paraqitura brenda njeriut, e qëllimi i sjelljes është kënaqja e nevojave” (Jaganjac, J. 2009). “Që njeriu të jetë në gjendje të motivoj të tjerët, së pari duhet të njoh dhe motivoj vetveten, e pastaj të tjerët” (Vlatković, V. 2008). Më fjalë tjera, motivimi paraqet vullnetin apo dëshirën për të performuar.

Në kontekst më të gjerë parashtrohet pyetja: “Çka është motivimi?”

Motivi është arsyeja për të bërë diçka. Motivimi ka të bëjë me faktorët të cilët ndikojnë në njerëz që të sillen në mënyrë të caktuar. Tri komponentët e motivimit të listuara nga Arnold në vitin 1991 janë:

- ✓ drejtëm – çka personi është duke tentuar të bëjë,
- ✓ përpjeke – sa shumë/fortë personi po përpjet,
- ✓ këmbëngulje – sa gjatë personi po përpjet”(Armstrong, M. 20016).

Motivimi përshkruhet si sjellje qëllim - drejtuese pasi i bënë njerëzit të lëvizin në drejtëm në të cilin mbikëqyrësi dëshiron që ata të shkojnë në mënyrë që të arrijnë rezultate. “Individët e motivuar përpjeten të punojnë me përpjekje dhe mirëbesim të shtuar dhe shijojnë produktivitetin e lartë”.

Forma më e mirë e motivimit është kur njerëzit kanë qëllime të qarta dhe ndërmarrin aktivitete përmes të cilave ata presin ti arrijnë ato qëllime. Këta njerëz mund të quhen *persona të vet-motivuar*.

Me fjalë më të thjeshta, “cikli i motivimit përfshin tri faza: a) motivimi, b) efekti (rezultati), c) kënaqësia (mos-kënaqësia).

Faza e parë – lindja e motivit, paraqet momentin e ngjalljes (inicimit) të aktivitetit të të punësuarit kah realizimi i qëllimit të caktuar. Në *fazën e dytë* aktivitetet prodhojnë efekte të caktuara, ndërsa në *fazën e tretë* paraqitet kënaqësia e punëtorit, meqë pasojë e efektit është shpërblimi, i cili në të shumtën e rasteve shprehet me para” (Ramosaj, B. 2007).

“Modeli nevojë-lidhje i procesit të motivimit është i treguar në figurën nr. 1. Kjo tregon se motivimi është iniciuar nga identifikimi i vetëdijshëm apo pavetëdijshëm i nevojave të pakënaqura. Këto nevoja krijojnë dëshira, të cilat janë dëshira për të arritur apo fituar diçka. Qëllimet janë pastaj të krijuara, të cilat besohet se do ti kënaqin këto nevoja dhe dëshira dhe rruga e sjelljes është e selektuar nga e cila pritet të arrijë qëllimet. Nëse qëllimi është i arritur, nevoja do të jetë e kënaqur dhe sjellja sigurt do të përsëritet herën e ardhshme kur nevoja e ngjashme shfaqet. Nëse qëllimi nuk është arrit, aktiviteti i njëjtë ka pak gjasa për përsëritje. Ky proces i përsëritjes së sjelljeve të suksesshme apo aktiviteteve quhet përforsim apo ligji/rezultateve (Armstrong, M. 2006).




Figura nr. 1. Procesi i motivimit

Gjatë motivimit menaxhmenti gjithnjë duhet pasur parasysh një fakt të rëndësishëm, e që ka të bëjë me diverzitet të karaktereve të personave. Njerëzit të ndryshëm motivohen në mënyra të ndryshme, dhe në momente të ndryshme.

6. Strategjitë e motivimit

Shumica e të punësuarve preferon të jetë e motivuar nga ndërmarrja apo organizata ku punojnë, andaj është e rëndësishme që në vazhdimësi të zbulohen strategjitë e reja të motivimit, pasi të punësuarit nuk mund të motivohen gjithnjë në mënyrë të njëjtë. Ajo çka mund të motivojë një individ, për tjetrin mund të duket e mërzitshme apo frustruese. Një fakt që duhet përmendur është se “një person jo i motivuar mund të motivohet dhe një person i motivuar mund të demotivohet” (Erven, B. L. 2008).

Mjetet dhe mundësit të cilat menaxhmenti i ka në dispozicion për ti kënaqur nevojat dhe dëshirat e ndryshme të bashkëpunëtorëve të vet janë të ndryshme, dhe për këtë arsye është me rëndësi të përcillen në vazhdimësi nevojat dhe dëshirat e tyre dhe në bazë të tyre të zbulohen strategjitë e reja të motivimit. Ndërmarrja është fatlume nëse brenda saj punojnë individët që janë vet të motivuar. Strategjitë e motivimit mund të jenë: strategjia financiare/materiale dhe strategjia jo – material/financiare.

6.1. Strategjia e motivimit – Komunikimi

Lirisht mund të thuhet se bazën e çdo suksesi e paraqet komunikimi i mirë. Pasojat e komunikimit të tillë pasqyrohen në raporte të shëndosha në mes individit me familjaret, shokët, bashkëpunëtorët, etj. Si në jetën personale ashtu edhe në atë profesionale njeriu gjithnjë duhet pasur kujdes kur komunikon me bashkëbiseduesin. Brenda ndërmarrjes/organizatës komunikimi i mirë në mes të menaxherit dhe strukturave vartëse siguron përmbushjen e nevojave elementare të njeriut. Rrolin kryesor në këtë strategji e luan menaxheri, përmes sjelljes së përditshme dhe raporteve me bashkëpunëtorët. Përkushtimi i menaxherit ndaj vartësve, gatishmëria të dijë për problemet e punëtorëve, dhe të dijë ti zgjidh, të vlerësoj punën kualitative, të marrë parasysh mendimet dhe idetë e tyre, ti përfshijë në zgjidhjen e problemeve të përditshme, tregon se menaxheri kujdeset për ta dhe se “dyert e tij janë gjithnjë të hapura” për ta. Sjellja e tillë do të siguron një ambient relaksues ku të punësuarit do të ndihen më të sigurt, të kenë ndjenjën e përkatësisë në institucion, dhe me vetë faktin ndjenjën e vetë-konfirmimit në institucionin përkatës. Siç është cek edhe më parë, siguria, përkatësia dhe vetëkonfirmimi janë nevojat elementare të anëtarëve të organizatës, e komunikimi është njeri nga mjetet bazike për kënaqjen e këtyre nevojave. Mos të harrojmë të përmendim në fund një fjalë popullore “*fjala e butë dyert e hekurta i hap*”.

REZULTATET NGA TERRENI

Për të studiuar aspektin praktik dhe për të parë për se afërmi nga terreni, se sa janë të motivuar puntorë, si janë të trajtuar, kemi hartuar një Pyetësor anonim, i cili komplet shihet në anekset e këtij punimi. Plotësimi i këtyre pyetësorëve në terren është realizuar në disa mënyra: njëra është se pyetësorët i janë shpërndarë personelit dhe pastaj ata e kanë kthyer të plotësuar, mënyra tjetër, duke zhvilluar drejtpërsëdrejti intervistën me personin në fjalë, mënyra tjetër, ajo online, nëse aty për aty ska pas kohë, atëherë i kemi dërguar online Pyetësorin, në adresën e marrë, ose dhe në pyetësor ka qenë e ka shënuar adresën jonë na kanë ardhë përgjigjet.

Të dhënat e nxjerra dhe të përpunuara janë të paraqitura në këtë pjesë të punimit nga përgjigjet e punonjësve të nëntëdhjetë e dy punonjësve bizneseve që operojnë në Pejë, por duhet të potencojmë se kemi pas në plan njëqind, por për të ndryshuar pak numrin që të mos jete i plotë. Sipas rezultateve të nxjerra nga terreni kemi përdor fjalën punonjës, fjalë në të përgjithshme që përfshinë stafin menaxhues të nivelit të lartë, stafin menaxhues të nivelit të mesëm, puntorët e ndryshëm. Përkatësisht jemi munduar të nxirren mendimet dhe qëndrimet e tyre për procesin e motivimit në binzeset ku punojnë. Pjesë e këtij punimi janë edhe krahasimet e rezultateve të nxjerra nga përgjigjet punonjësve dhe janë diskutuar.

Intervistat të cilat janë zhvilluar me individ ku kanë pasur pozita të ndryshme si vijon:

Menaxher/e Regjional/e biznesit; Menaxher Regjional i Bankës; Menaxher i kompanisë së sigurimeve; Menaxher financiar; Administrator; Pronar/e biznesi; Zëvendës Menaxher e Financave, Merchendaiser, Financierë, Menaxher e Restorantit; Kalkulanta, Arkëtare administrative, Mbikëqyrës të sektore të ndryshme, Shef kryesor, Sektorista/e të ndryshëm; Arkëtare, Receptionsiste, Shitës/e; Analist kreditor.

Bizneset nuk ekzistojnë pa njerëz, dhe marrëdhëniet në mes të njerëzve nuk ekzistojnë pa komunikim. Të gjitha organizatat janë krijuar për tu organizuar përmes procesit të komunikimit dhe mirëmbajtjes nga njerëz që komunikojnë me njëri – tjetrin.

Gjatë motivimit menaxhmenti në biznesegjithnjë duhet pasur parasysh një fakt të rëndësishëm, e që ka të bëjë me diverzitet të karaktereve të personave. Njerëzit të ndryshëm motivohen në mënyra të ndryshme, dhe në momente të ndryshme.

Nëse menaxhmenti zbulon çka e motivon njeriun, ka zbuluar shifrën për sukses. Si përfundim mund të themi, se motivimi si proces nuk përfundon asnjëherë, por duhet të zhvillohet në vazhdimësi, në mënyrë që të ketë sukses një biznes.

Por, dita ditës mënyra e zhvillimit të afarizmit dhe menaxhimit të ndërmarrjeve përparon, prapëseprapë, është evidente mungesa e motivimit në shumë subjekte afariste. Shkaku i kësaj janë:

- ✓ mungesa e aplikimit të ligjit mbi marrëdhënien e punës, i cili ligj kish me i mbrojt punëtorët nga situata të palakmueshme por i cili në të njëjtën kohë i përshkruan edhe obligimet e tyre ndaj punëdhënësit,
- ✓ mënyra e zhvillimit të veprimtarisë afariste, e cila është trashëguar nga sistemi i mëparshëm, ku

përqindja më e madhe e të punësuarve është e interesuar vetëm për pagë, ndërsa dëshira për ndërtim të një karriere të suksesshme është e mangët apo nuk ekziston,

- ✓ periudha e shkurt e zhvillimit të biznesit privat (traditë jo e mjaftueshme në këtë fushë),
- ✓ mungesa e personelit menaxhues me përvojë dhe kualifikim të duhur të cilët kishin me motivua personelin në mënyra të ndryshme,
- ✓ mungesa e shkëmbimit të përvojës me ndërmarrje të ndryshme, qoftë ato brenda vendit apo jashtë vendit,
- ✓ frika nga ana e menaxherëve se punëtorët e nivelit të ulët mund t'ju zënë punën e tyre,
- ✓ punëtorët të cilët arrijnë në vende pune përmes lidhjeve familjare (dmth: jo me meritë) mundohen që në mënyra të pandershme të arrijnë në pozita të mira (psh: përmes spiunimit).

Rezultati më i rëndësishëm i analizës së punës është krijimi i një bazë për përshkrimin bazik të punës, në mënyrë që të sigurohet një mbështetje për menaxhim më efikas me resurset humane. Rëndësia e saj mund të jetë për të treguar nevojat për trajnim të personelit sepse përmes analizës së punës e dimë se cilët kanë nevojë për trajnim.

Pastaj për udhëhequr një analizë të pagave, për të siguruar një bazë të mirë për seleksionim, për të siguruar realizimin e planit strategjik, etj. Kur kompletohen rezultatet e analizës së punës në një raport të shkruar, atëherë këto informata menaxherët e resurseve humane i përdorin për të zhvilluar përshkrimet e punës dhe specifikimet e punës.

Kërkesat dhe nevojat e përbashkëta të menaxherëve dhe punëtorëve janë: kompensimi apo ndërrimi i orarit të punës për nevoja personale/familjare, respektimi i orarit dhe ligjit të punës, ngritja profesionale, për menaxher pjesëmarrja në trajnime, kurse për punëtor ofrimi i mundësisë së mbajtjes së postit më të lartë. Sa i përket ngritjes profesionale, kjo shumë lehtë mund të aplikohet si për menaxher ashtu edhe për punëtorë, pasi ekzistojnë kushte të volitshme për plotësim të këtyre kërkesave.

Rekomandimet

Në mënyrë që ambienti i punës të jetë sa më i përshtatshëm dhe relaksues, sipas hulumtimit të realizuar, janë nxjerrur rekomandimet si në vijim:

- 1) Arsytet e motivimit dhe të demotivimit janë paraqitë më parë veç e veç, dhe në bazë të tyre mund të konkludojmë se faktorët pozitiv dhe të përbashkët cilët i nxisin menaxheret dhe punëtorët për performancë të mirë janë: paga e mirë dhe e rregullt, ushqimi falas dhe i bollshëm, raporte të mira me kolegë, konsumator dhe menaxherë të nivelit të lartë, mundësia e ngritjes profesionale dhe kontratat e punës.
- 2) Faktorët demotivues dhe të përbashkët për këto dy kategori janë më të pakët, pasi faktorët e demotivimit, menaxheret më tepër i lidhin me sjelljen dhe presionin nga menaxhmenti i lartë dhe mos realizimin e planit të punës me sukses. Ndërsa në anën tjetër, punëtorët demotivohen nga: dënimet dhe vërejtjet e shpeshta dhe të panevojshme nga menaxheret e nivelit të mesëm dhe ata faktorë që ndërlidhën me kushtet (liritë) themelore të punës.
- 3) Themelimi i një këshilli apo organi i cili kish me i mbrojt të drejtat e punëtorëve dhe ti mbroj ata nga sjellja jo e mirë e menaxherëve, e që në të njëjtën kohë do duhej ta informoi edhe pronarin lidhur me situatën e cila mbizotëron gjatë realizimit të punëve, për arsye të shmangies së pakënaqësisë tek punëtorët.
- 4) Hapja e kutisë së ankesave për staf të nivelit të mesëm dhe të ulët, e pastaj ato ankesa të shqyrtohen nga menaxhmenti superior në bashkëpunim të ngushtë me këshillin e punëtorëve.
- 5) Kushtet e punës, të ofruara nga menaxhmenti i lartë, janë mjaft të mira për realizim të suksesshëm të punëve, por (stresi) presioni i krijuar nga menaxherët e nivelit të mesëm e vështirëson performancën dhe si pasojë punëtorët bëjnë më tepër gabime. Andaj, krijimi i një qendre rekreacioni i cili kish më i shërbye punëtorëve për relaksim dhe shoqërim, në mënyrë që ata ta përjetojnë punën si kënaqësi.
- 6) Mos lejimi i krijimit të klaneve apo grupeve cilët i shërbejnë menaxherëve në përgjithësi për spiunazh të kolegëve të vet, dhe që në të shumtën e rasteve sjellë pakënaqësi në mesin e punëtorëve.
- 7) i kish shqyrtua ato vlerësime të bëra nga menaxheri dhe në bazë të asaj të vendoset nëse ai duhet të promovohet.

BIBLIOGRAFIA

- 1) Armstrong, M. 2006., A handbook of Human Resource Management practice, 2006 10th edition, fq. 253
- 2) Appelbaum, E., Bailey, T., Berg, P. and Kalleberg, A (2000).” *Manufacturing advantage: ëhy high performance ëork systems pay off*”. Cornell University Press, Ithaca, NY.
- 3) Bernard L. Erven, *Leading, Motivating and Evaluating Employees*, Strategic Business Planning for Commercial Producers, Dep. of Agriculture, Environmental and development Economics, Ohio State University, PURDUE University.
- 4) Boëen, B. E., & Radhakrishna, R. B. (1991). Job satisfaction of agricultural education faculty: A constant phenomena. *Journal of Agricultural Education*, 32 (2).
- 5) Brian Keeley (2007). OECD Insights; Human Capital. ISBN 92-64-02908-7
- 6) Buford, J. A., Jr. (1993). Be your oën boss. *Journal of Extension*,
- 7) Carrel, M.R., Norbert, F. and Robert, D.H. 1995.
- 8) Dr Aziz Šunje, Top-menadžer, Sarajevo 2003, fq. 11.
- 9) Dr. sc. Enver Kutllovci, Menaxhimi i Resurseve Humane, Prishtine 2004. fq. 10. fq. 72.
- 10) Fisher, D. 1989. Current and Recurrent Challenges in HRM. *Journal of Management*. Vol: 15 pg. 157-178.
- 11) Havolli, Y. Menaxhmentii Burimeve Njerezore. RIINVEST, Prishtinë 2003
- 12) Henry, O. & Evans, A.J. (2008). "Occupational Stress in Organizations". *Journal of Management Research* 8 (3).
- 13) Ian Brooks, *Organizational Behavior, Individuals, Groups and organization*, Second edition 2003, Prentice Hall, fq. 48.
- 14) Ian Brooks, *Organizational Behavior, Individuals, Groups and organization*, Second edition
- 15) J. Coyle-Shapiro, K. Hoque, I. Kessler, A. Pepper, R. Richardson and L. Ėalker. (2013). *Human resource management*. University of London.
- 16) Jamila Jaganjac, Magistarski rad, Upravljanje ljudskim resursima u oblasti ekonomije, Maj 2009, fq. 51.
- 17) John P.Kottler "*Ėinning at Change*" *Leader to Leader*. 10 (Fall 1998): 27-33.
- 18) Koli, Z, Llaci, Sh. *Menaxhimi i Burimeve Humane*. Tiranë 2006.
- 19) Krantz, D., Grunberg , N., and Baum, A. (1985). *Health psychology*. *Annual Revieë of Psychology*, 36,
- 20) Kreitner, R. (1995). *Management (6th ed.)*. Boston: Houghton Mifflin Company.
- 21) Kume, Vasilika, Menaxhimi Strategjik” Tirane , shtepia botuese “PEGI”
- 22) Kutllovci, E. *Menaxhimi i Resurseve Humane*, Prishtinë 2004
- 23) Llaci Sh, Menaxhimi, Tiranë 2002.
- 24) Michael Armstrong, A handbook of Human Resource Management practice, 2006 10th edition, fq. 252.
- 25) Michael C. C. SZE, *Guide to Human Resource Management*. 1996.
- 26) Pinnington, H. A. Macklin, R. Campbell, T. *Human Resource Management: Ethics and Employment*. 2007
- 27) Portole, Laura. (2012). *B eginning Management of Human Resources*. USA
- 28) Prof. Dr. Berim Ramosaj, *Management, Bazat e Menaxhimit, botimi i pestë*, Prishtinë 2007, fq. 209
- 29) Ramosaj, Berim. (2006). *Menaxhmenti Kreativ & Lidershipi*.
- 30) Zeqiri, Izet. (2006). *Menaxhmenti Koncepte Praktika Zhvillimi afarist*
- 31) Zeqiri, Izet. *Menaxhmenti Strategjik, Tetove*, 2010.

MËNYRAT PËR PËRMIRËSIMIN E FEEDBACKUT NË MËSIMDHËNIE

Msc. Fidan Ibrahim Phd Candidat-Fakulteti Pedagogjik, Universiteti “Sv.Kliment Ohridski”, Manastir

Abstrakt

Proceset e komunikimit dhe ndërveprimit përmbajnë një sasi të caktuar, si dhe cilësinë e reagimeve që mund të ndryshojnë në shtrirje, strukturë dhe funksionalitet. Feedback-u në procesin e komunikimit, veçanërisht në mësimdhënie, është një hallkë që përcakton ndjeshëm suksesin e nxënësve, por sigurisht që i tregon mësuesit suksesin e tij. Mësuesi është po aq i suksesshëm sa nxënësit e tij. Komunikimi është gjithmonë një proces i dyanshëm. Ndjekja e sinjaleve joverbale të nxënësve ndërsa mësuesi mëson në një farë mënyre ofron një natyrë të dyanshme për procesin. Feedback-u në përgjithësi jep një pasqyrë nëse njerëzit që komunikojnë me njëri-tjetrin u jepnin të njëjtin kuptim mesazheve, fjalëve, shenjave ose nëse ata ranë dakord për një plan përmbajtjeje.

Feedback-u mund të njihet si një mjet që i ndihmon studentët ta bëjnë mësimin e tyre kuptimplotë. Kjo gjithashtu mund të përmirësojë ndjeshëm mësimdhënien në nivelin e arsimit të lartë. Ka një sërë treguesish që mbështesin dobinë e komenteve për të përmirësuar të nxënësit e studentëve. Dihet mirë se në kontekstin e arsimit të lartë, studentët mësojnë në mënyrë efektive kur reagimet e kolegëve janë një komponent i qenësishëm i vlerësimit të përgjithshëm. Ky element kyç i arsimit të lartë mund të konsiderohet si një qasje praktike për të lehtësuar zhvillimin e studentëve si studentë të pavarur për të kontrolluar dhe vlerësuar të nxënësit e tyre.

Fjalet kyqe: komunikimi, mesidhenja, feedback, studentet

Abstract

Communication and interaction processes contain a certain amount, as well as the quality of feedback that can vary in scope, structure and functionality. Feedback in the communication process, especially in teaching, is a link that significantly determines the success of students, but it certainly shows the teacher his success. A teacher is only as successful as his students. Communication is always a two-way process. Following the students' nonverbal cues while the teacher teaches somehow provides a two-way nature to the process.

Feedback generally gives insight into whether the people communicating with each other gave the same meaning to messages, words, signs, or whether they agreed on a content plan.

Feedback can be recognized as a tool that helps students make their learning meaningful. This can also significantly improve teaching at the higher education level. There is a number of indications that support the usefulness of feedback to improve student learning. It is well known that in the context of higher education, students learn effectively when peer feedback is an inherent component of overall assessment. This key element of higher education can be considered a practical approach to facilitate the development of students as independent learners to control and evaluate their learning.

Key words: *communication, media, feedback, students*

Proceset e komunikimit dhe ndërveprimit përmbajnë një sasi të caktuar, si dhe cilësinë e reagimeve që mund të ndryshojnë në shtrirje, strukturë dhe funksionalitet. Feedback-u në procesin e komunikimit, veçanërisht në mësimdhënie, është një hallkë që përcakton ndjeshëm suksesin e nxënësve, por sigurisht që i tregon mësuesit suksesin e tij. Mësuesi është po aq i suksesshëm sa nxënësit e tij. Komunikimi është gjithmonë një proces i dyanshëm. Ndjekja e sinjaleve joverbale të nxënësve ndërsa mësuesi mëson në një farë mënyre ofron një natyrë të dyanshme për procesin.

Feedback-u në përgjithësi jep një pasqyrë nëse njerëzit që komunikojnë me njëri-tjetrin u jepnin të njëjtin kuptim mesazheve, fjalëve, shenjave ose nëse ata ranë dakord për një plan përmbajtjeje. Reagimet gjithashtu ofrojnë një pasqyrë se si ata krijuan marrëdhënien. Mësuesi, duke i kërkuar nxënësit për komente, merr një pasqyrë të masës në të cilën nxënësit e kuptuan me sukses, si i interpretuan mesazhet e tij, çfarë përjetuan, si e pranuan. Komunikimi është i suksesshëm, për sa i përket përmbajtjes, kur personi që merr mesazhin interpreton personazhet në të njëjtën mënyrë si personi që dërgoi mesazhin. Rolet e personit që dërgon mesazhin dhe atij që merr mesazhin në klasë ndryshojnë vazhdimisht. Kjo është në përputhje me kërkesën e teorisë moderne që e kupton të mësuarit si një proces komunikimi të dyanshëm, ku reagimet janë pjesë përbërëse e këtij procesi. Për një mësimdhënie të suksesshme është e rëndësishme që mësuesi të marrë reagime nga nxënësi, por nuk është më pak e rëndësishme që nxënësi të marrë reagime nga mësuesi, si në formën e vlerësimit numerik ashtu edhe në atë përshkrues.

Feedback-u mund të njihet si një mjet që i ndihmon studentët ta bëjnë mësimin e tyre kuptimplotë. Kjo gjithashtu mund të përmirësojë ndjeshëm mësimdhënien në nivelin e arsimit të lartë. Ka një sërë treguesish që mbështesin dobinë e komenteve për të përmirësuar të nxënësit e studentëve. Dihet mirë se në kontekstin e arsimit të lartë, studentët mësojnë në mënyrë efektive kur reagimet e kolegëve janë një komponent i qenësishëm i vlerësimit të përgjithshëm. Shumë studiues kanë treguar se reagimet mund të jenë një mekanizëm që përmirëson rezultatin e procesit të të mësuarit. Për sa i përket përmirësimit të procesit mësimor, tashmë është parë se informacioni për cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënësit duhet të mbledhet nga institucionet e arsimit të lartë dhe caktimi i pikëpamjeve të studentëve është kthyer në një çështje të rëndësishme për procesin e përvetësimit të cilësisë. Në literaturë, ka disa studime që kanë treguar se sa efektivisht mund të përdoren komentet e mbledhura të studentëve për të përmirësuar mësimdhënien. Megjithatë, mbledhja e komenteve nuk është e lehtë dhe një sërë problemesh janë raportuar gjerësisht si pyetje të papërshtatshme, statistika të ulëta të përgjigjeve, analiza të gabuara të të dhënave.

Ky element kyç i arsimit të lartë mund të konsiderohet si një qasje praktike për të lehtësuar zhvillimin e studentëve si studentë të pavarur për të kontrolluar dhe vlerësuar të nxënësit e tyre. Qëllimi i reagimit është të mbushë hendekun midis performancës aktuale dhe asaj të dëshiruar.

Përveç rishikimit të reagimeve, është e rëndësishme të theksohet se duhet të merren parasysh disa variabla që ndikojnë drejtpërdrejt në marrëdhënien midis reagimeve dhe të mësuarit. Analiza e dhënë në literaturë tregon se të paktën tre kërkesa duhet të plotësohen për ta bërë reagimin efektiv: të nxënësit kanë nevojë për reagime, nxënësit marrin komente në kohën e duhur dhe kanë kohë të mjaftueshme për ta përdorur atë, nxënësit janë në gjendje të përdorin reagimet. Nëse nuk ka hendek midis njohurive të dëshiruara dhe aktuale dhe qëllimit të studentit, ai/ajo nuk ka nevojë të marrë reagime. Në mungesë të reagimeve, nxënësit duhet të mbështeten në vetëvlerësimin për të përcaktuar se çfarë po shkon mirë apo çfarë nuk është në rregull, por në këtë rast, vetëvlerësimi nuk ndihmon për të

identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të nxënësve. Ajo që është gjithashtu e rëndësishme është që studentët mund të interpretojnë mungesën e komenteve si një miratim indirekt i performancës së tyre. Nga ana tjetër, aftësia dhe gatishmëria e studentit për të përdorur komentet kthyes luan një rol të rëndësishëm, sepse lidhet me motivimin e studentit, të cilin shumë autorë e kanë njohur si një parametër të rëndësishëm.

Megjithatë, reagimet efektive dhe efikase konsiderohen si një çështje e vështirë. Në shumë raste, mësuesit janë ende duke punuar brenda formës tradicionale të njëanshme të reagimit dhe studentët janë të pakënaqur me komentet që marrin për punën e tyre. Studimi i Stobart arriti në përfundimin se studentët raportojnë mungesë të reagimeve në kohë dhe të përshtatshme. Në të njëjtën kohë, mësuesit argumentojnë se nxënësit nuk arrijnë t'i vënë në praktikë këshillat që marrin. Në lidhje me problemin e përmendur më sipër, në literaturë janë paraqitur një sërë sugjerimesh për të krijuar reagime shumë më efektive në drejtim të përmirësimit të procesit mësimor.

Pavarësisht nga aspekti që reagimet janë të rëndësishme për përmirësimin e procesit mësimor, në literaturë janë paraqitur një numër në rritje i raporteve të pakënaqësisë me reagimet, si nga këndvështrimi i nxënësve ashtu edhe i mësuesve.

1. Koncepti i komunikimit

Komunikimi është procesi i transmetimit të një mesazhi nga një person tek tjetri, ku është e rëndësishme të kuptosh informacionin. Komunikimi i suksesshëm nënkupton saktësinë e informacionit të marrë në lidhje me përmbajtjen dhe kuptimin e deklaruar nga dërguesi. Komunikimi, ndryshe nga informacioni, është një proces i dyanshëm dhe reagimi është një pjesë integrale e këtij procesi. Është më shumë se thjesht një ndryshim fjalësh, sepse e gjithë sjellja jonë përcjell një mesazh dhe ndikon tek personi me të cilin jemi në një lidhje. Komunikimi, si shkëmbim dhe shkëmbim i ideve dhe informacionit, është ndërveprimi me njerëzit e tjerë, aftësia për të shprehur nevojat e tyre përmes të folurit, të kuptuarit dhe përmbushja e pritshmërive të tjerëve.

Hargie dhe Dickson deklarojnë se komunikimi është një proces në të cilin informacionet, kuptimet dhe ndjenjat ndahen ndërmjet individëve përmes shkëmbimit të mesazheve verbale dhe joverbale. Komunikimi i suksesshëm thekson ndryshimin midis të dhënave dhe informacionit, ku të dhënat do të thotë fakte "të papërpunuara" në një kontekst të ngushtë, dhe informacioni është i dhënë në një formë kuptimplote. Informacioni është më i dobishëm kur është i saktë, në kohë, i plotë dhe i përshtatshëm. Saktësia i referohet besueshmërisë dhe pakundërshtueshmërisë së informacionit, ndërsa me kohë nënkuptojmë se informacioni duhet të arrijë kur nevojitet, pra në kohë. Nuk është gjithmonë e mundur të merret informacion i plotë, sepse njerëzit nuk mund të dinë kurrë gjithçka, por informacioni duhet të jetë mjaft i plotë për të marrë një vendim bazuar në të. Rëndësia zakonisht varet nga situata. Ajo që është e rëndësishme për një person mund të mos jetë aq e rëndësishme për një tjetër.

Për të filluar procesin e komunikimit, dërguesi duhet të formulojë një ide ose të mendojë se çfarë të thotë. Në këtë proces, mesazhi udhëton nëpër kanale të caktuara për të arritur tek marrësi. Kanalet kryesore të komunikimit janë letra, e-mail, biseda ballë për ballë, telefoni, faksi, gazeta, broshura, filmi, video, radio, televizioni, uebsajti dhe posterit. Komunikimi i ndërsjellë zhvillohet ndërmjet dy ose më shumë njerëzve ballë për ballë me mundësinë e reagimit të menjëhershëm. Feedback-u është reagimi i marrësit ndaj procesit që bëhet një bisedë ose komunikim i dyanshëm. Komunikimi i ndërsjellë varet nga niveli i njohurive dhe besimit reciprok, përfshin sjelljen verbale dhe

joverbale dhe zhvillohet në mënyrë spontane, të praktikuar dhe të planifikuar. Cilësia e marrëdhënies së krijuar ndikon në suksesin e komunikimit të ndërsjellë.

Për të kuptuar më mirë konceptin e komunikimit, Vodopija nxjerr në pah gjashtë karakteristika të komunikimit njerëzor: shumëllojshmërinë e shkaqeve të komunikimit njerëzor, efektet e qëllimshme dhe anësore të komunikimit, reciprocitetin e komunikimit njerëzor, përfshirjen e të paktën dy personave, ekzistencën e komunikimit të suksesshëm dhe të pasuksesshëm.) dhe përdorimi i simboleve në komunikim.

2. Komunikimi në mësimdhënie

Sternberg dhe Williams vunë në dukje se mënyra se si mësuesi komunikon në mësimdhënie është një nga elementët kyç në nxitjen e kreativitetit dhe përafrimin e karakteristikave të kurrikulës me interesat dhe aftësitë e secilit student. Autorët besojnë se respekti është baza e komunikimit të qëllimshëm në klasë. Është treguar se mënyra se si nxënësit bëjnë pyetje dhe se si ato lidhen me problemet e reja varet shumë nga qasja e mësuesit. Për shembull, nëse mësuesi shpesh e injoron pyetjen e nxënësit dhe në të njëjtën kohë jep mesazhin se pyetja e bërë nuk është e përshtatshme, zvogëlon kuriozitetin e nxënësit për të zgjidhur dhe kërkuar probleme të reja. Është e vështirë të imagjinohet komunikimi mes mësuesve dhe nxënësve pa bërë pyetje dhe pa dhënë përgjigje. Brajsa thekson se pyetjet bëhen si mënyrë për të edukuar bisedën dhe për të njohur bashkëbiseduesin. Liston funksionet bazë të pyetjeve që mund të zbatohen në komunikimin mësues-nxënës. Funksionet bazë të pyetjeve nga mësuesit dhe nxënësit janë: marrja e informacionit, nxitja e interesit dhe kuriozitetit të nxënësve për një temë të caktuar, vlerësimi i vështirësive në deshifrimin e një mesazhi të dërguar nga mësuesi ose nxënësi, shfaqja e interesit për bashkëbiseduesin (mësues, nxënës). qëndrimet për të nxënësit dhe ndjeshmërinë, inkurajimin e nxënësve për të komunikuar dhe bashkëpunuar me mësuesin, vlerësimin e "njohurive" të studentëve, inkurajimin e të menduarit kritik të studentëve dhe ruajtjen e kontrollit mbi ndërveprimin. Autori argumentohet se ai që bën pyetjet e menaxhon bisedën dhe vë në dukje: “pyetja është po aq e mirë sa edhe përgjigja që ka nxitur”.

Një formë e kotë dhe e pakuptimtë e komunikimit është ajo në të cilën mësuesi tregon njëfarë interesi për problemin e nxënësit, por për shkak të mosnjohjes së përgjigjes së saktë jep një mesazh të pakuptimtë ose të paqartë. Komunikimi efektiv përfshin dëgjimin dhe të folurin, si dhe leximin dhe shkrimin. Mësuesit duhet të jenë shumë të aftë në të gjitha këto fusha, sepse këto aftësi u mundësojnë atyre të transferojnë njohuritë, aftësitë dhe vlerat pa pengesë dhe këto aftësi ndihmojnë në motivimin e nxënësve dhe inkurajimin e tyre për të qenë aktivë në mësimdhënie. Komunikimi i dobët mes mësuesve dhe nxënësve dhe përdorimi i shpeshtë i stileve të papërshtatshme të komunikimit mund të jetë shkak për prishje të përhershme të marrëdhënieve mes mësuesve dhe nxënësve dhe mund të çojë në tërheqje të përhershme dhe mosveprim të nxënësve në mësimdhënie. Aftësitë e komunikimit varen kryesisht nga një kombinim i aftësive të mira ndërpersonale dhe aftësisë për të menaxhuar qëndrimet dhe emocionet e veta.

Aftësitë e komunikimit sot janë një element kyç i suksesit në fusha të ndryshme profesionale dhe janë veçanërisht të rëndësishme për mësuesit. Komiteti përkatës arsimor mësuesi dhe mënyra se si mësuesi e përcjell përmbajtjen e mesazhit, pra nëse është e kuptueshme apo jo.

Mësuesi që preferon një stil komunikimi dominues duhet të mendojë për stilin e tij dominues të komunikimit dhe vazhdimisht të rishikojë dhe të kërkojë përmirësime për të arritur një komunikim më efektiv me nxënësit. Stili dominues i komunikimit mes mësuesve dhe nxënësve çon në komunikim të njëanshëm ndërmjet mësuesve dhe nxënësve dhe në këtë mënyrë redukton aktivitetin dhe angazhimin e nxënësve në mësimdhënie. Shumë i rëndësishëm është edhe dimension i socio-emocional i komunikimit, i cili i referohet sjelljes së themeluesit (përzemërsia, ndershmëria, menjëhershëmëria, besimi) dhe kthyeshmëria sociale si tregues i marrëdhënieve demokratike ndërmjet subjekteve të procesit arsimor.

Ekzistojnë 4 stile komunikimi në të cilat zhvillohet komunikimi ndërmjet mësuesve dhe nxënësve:

1. Komunikimi bashkëpunues (vlerë - vlen): mësuesi e trajton nxënësin me respekt të plotë, mirëkuptim, durim dhe përpqet ta zgjidhë situatën me bashkëpunim dhe marrëveshje;
2. Komunikimi inferior (nuk ia vlen - ia vlen): mësuesi e trajton nxënësin në mënyrë të pasigurt, jo bindëse dhe tregon mosbesim ndaj vetes dhe aftësive të tij;
3. Komunikimi superior (ja vlen – nuk ia vlen): mësuesi e trajton nxënësin në mënyrë dominuese, “nga lart”, e nënçmon dhe nënvlerëson;
4. Komunikimi sfidues (nuk ia vlen - nuk ia vlen): kjo formë komunikimi në vokacionin e mësuesit është krejtësisht jofunksionale, mësuesi aplikon komunikim negativ, nihilist, që është një nga stilet më të padëshirueshme të komunikimit.

3. Komunikimi pedagogjik cilësor si faktor në zhvillimin e kompetencës komunikuese të nxënësve

Mësuesi është përgjegjës për vendosjen e komunikimit pedagogjik cilësor, si dhe për zhvillimin e kompetencave të komunikimit të nxënësve. Për të arritur një komunikim cilësor pedagogjik në mësimdhënie, është e nevojshme të plotësohen këto kushte: mësuesi (dhe nxënësi) kompetent për komunikim, komunikimi ndërpersonal dhe mesazhet komunikuese.

Mund të pranojmë të kuptuarit e Suzic-it se aspektet kryesore të komunikimit pedagogjik cilësor janë: aftësia e dërguesit për të përcjellë një mesazh ose për të komunikuar në mënyrë efektive përmbajtjen e komunikimit; aftësia e marrësit për të kuptuar ose marrë mesazhin ose përmbajtjen e komunikimit; reagime efektive dhe eliminimin ose minimizimin e zhurmës ose shpërqendrimeve.

Bazuar në këto aspekte, mund të konkludojmë se komunikimi pedagogjik cilësor në mësimdhënie mund të arrihet nëse dërguesi i mesazhit është në gjendje të dekodojë mesazhin dhe ta bëjë atë të disponueshëm për të gjithë pjesëmarrësit, marrësi i mesazhit është në gjendje ta kuptojë mesazhin, veçmas. e rëndësishme e përdorin atë në mënyrë të parëndësishme dhe vlerësojnë atë që ofron marrësi. Në këtë mënyrë vendoset reagimi në komunikim, marrësi i përgjigjet mesazhit që vjen nga dërguesi. Feedback-u bën të mundur eliminimin e pengesave si përfaqësimi i pakuptueshëm i mësuesve, prezantimi i paqartë audio-vizual, por edhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet pjesëmarrësve në komunikim. Hulumtimi i kryer nga Brillhart, Galanes, Adams zbuloi se studentët që komunikojnë në një grup me reagime të shpeshta kanë bashkëpunim më të mirë dhe homogjenitet më të fortë grupor.

Formula e komunikimit për sukses dhe “katër rregullat e arta të komunikimit” të vendosura nga Tijana Mandic mund të shërbejnë si pikënisje për zhvillimin e kompetencave të komunikimit të nxënësve. Respektimi i këtyre rregullave çon në krijimin e një komunikimi pedagogjik cilësor. Këto janë: fleksibiliteti, aftësitë komunikuese, respekti dhe puna në grup. Nëse këto rregulla ndiqen nga nxënësit dhe mësuesit, është fare e dukshme se kjo kontribuon në krijimin e një komunikimi pedagogjik cilësor, për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe veçanërisht për zhvillimin e kompetencave të komunikimit. Fleksibiliteti si rregull për komunikim të suksesshëm nënkupton aftësimin e mësuesve dhe nxënësve që të reagojnë ndryshe dhe të përshtaten me situatat e komunikimit. Fleksibiliteti i zhvilluar i studentëve në komunikim është një tipar i rëndësishëm i kompetencës së komunikimit. Një rregull tjetër për komunikim cilësor është që aftësitë e komunikimit vazhdimisht mësohen dhe përmirësohen. Askush nuk lind një komunikues i madh, kjo bëhet përmes komunikimit. Duhet pak përpjekje, këmbëngulje, praktikë nga të gjithë ata që mësojnë të komunikojnë me njerëzit e tjerë. Në mënyrë që studentët të bëhen komunikues të mirë, ata duhet të fitojnë gradualisht aftësi komunikimi. Do të thotë jo vetëm të fitosh njohuri se si të trajtosh të tjerët, por edhe të sillësh ndaj të tjerëve në përputhje me njohuritë e fituara. Rregulli i tretë i komunikimit është respekti për personin. Të respektosh njerëzit do të thotë: të vëzhgosësh dhe të vlerësoësh. Nëse mësuesi respekton nevojat, interesat, aftësitë e nxënësve, ai kontribuon në krijimin e një komunikimi reciprokisht stimulues. Duke respektuar personalitetin e nxënësit, mundësohet nxitja e nxënësve për të ndërmarrë veprime. Rregulli i katërt për komunikim të suksesshëm është puna në grup. Theksimi i potencialeve të veta në grup, shkëmbimi i përvojave, ndarja e detyrave në lidhje me interesat dhe mundësitë e individit, ndarja e të drejtave dhe përgjegjësisë, të gjitha këto janë momente të rëndësishme në zhvillimin e aftësive komunikuese që mund të arrihen në punën ekipore. .

Komunikimi cilësor kërkon: vendosjen e barazisë ndërmjet subjekteve që komunikojnë, njohjen e ndërsjellë, afeksinin personal, besimin, tolerancën, mirëkuptimin reciprok, respektin. Ky komunikim i vendosur mes nxënësve dhe mësuesve është i rëndësishëm në shumë aspekte: krijon një klimë pozitive psikosociale në klasë, nxit zhvillimin e kompetencave të komunikimit të nxënësve, ndikon pozitivisht në zhvillimin shumëpalësh të nxënësve, përmirëson punën edukative, afirmon shkollën në përgjithësi.

Shoqëria.

Pra, komunikimi mes mësuesve dhe nxënësve nuk është diçka që “thjesht ndodh”. Ai është rezultat i një grupi të ndërlikuar aftësish që zhvillohen, perfeksionohen, praktikohen, inkurajohen dhe përshtaten me rrethanat e ndryshme. Komunikimi i vendosur në klasë është një art i vërtetë. Si mësuesit ashtu edhe studentët janë artistë.

Mësuesi është një artist që krijon atmosferë, krijon aktivitete dhe krijon materiale për klasën. Ai përgatit gjithçka përpara se studentët të hyjnë në klasë. Dhe më pas, kur hyjnë edhe 30 “artistë” të tjerë, të gjithë të ndryshëm, me idetë, imagjinatën dhe vullnetin e tyre për të bërë diçka të re, çdo orë në klasë mund të bëhet një – një vepër e re arti”.

Aspektet e komunikimit cilësor pedagogjik nga mësuesit që nxisin zhvillimin e kompetencave të komunikimit të nxënësve janë:

- Informacioni, të dhënat e mësuesve duhet të jenë të bazuara dhe të artikuluar pedagogjikisht. Pra, në mënyrë të qartë, të saktë dhe të arsyeshme për të shmangur paqartësitë dhe reagimet negative të studentëve;

- Për nga përmbajtja, mesazhet duhet të korrespondojnë me mundësitë dhe stoqet e shenjave të nxënësve. Nga pikëpamja e përmbajtjes, komunikimi i suksesshëm është nëse shenjave me të cilat komunikojmë u jepet i njëjti kuptim.

- Detyrat dhe kërkesat e vendosura nga mësuesi duhet t'i përshtaten moshës dhe aftësive intelektuale të nxënësve.

- Komunikimi i mësuesit me nxënësit dhe qëndrimi i tij ndaj tyre në përgjithësi duhet të jetë i artikuluar pedagogjik dhe shumë etik, bazuar në pranimin dhe mirëkuptimin e nxënësve dhe respektimin e dinjitetit të personalitetit të tij.

Natyra e kompetencave të komunikimit të mësuesve dhe nxënësve nuk është e hulumtuar mjaftueshëm në mënyrë shkencore, veçanërisht kur bëhet fjalë për lloje të ndryshme të komunikimit në procesin arsimor. Në procesin edukativo-arsimor, komunikimi pedagogjik që zhvillohet ndërmjet mësuesve dhe nxënësve me qëllim të bartjes, përvetësimit të njohurive dhe zhvillimit personal dhe që kontribuon në zhvillimin e kompetencave të komunikimit, nxënësit mund të jenë: ndërpersonal, ndërpersonal, personal, personal, një. mënyrë. , komunikim i dyanshëm, verbal, joverbal, autoritar dhe demokratik. Komunikimi ndërpersonal është komunikimi që zhvillohet ndërmjet të paktën dy personave që ndodhen në të njëjtin vend ose nëpërmje zhvillimi i kompetencave të komunikimit të nxënësve. Në kuptimin pedagogjik, komunikimi ndërpersonal zhvillohet si një proces ndërveprues në të cilin mësuesi i përcjell nxënësit mesazhe të caktuara edukative për të nxitur zhvillimin e tij. Zhvillimi i komunikimit ndërpersonal kuptohet si një proces i zotërimit të aftësive dhe kompetencave aktive dhe ndërvepruese në komunikim.

4. Supozime për komunikim cilësor mësues-nxënës

Komunikimi në klasë është subjekt i ndërprerjeve të vazhdueshme që kërkojnë marrëdhënie cilësore mësues-nxënës. Mësuesi nuk ka më rol dominues në mësimdhënie, ai është partner i nxënësve, i ndihmon nxënësit dhe është i ndjeshëm ndaj nevojave të tyre. Nëpërmjet një qasjeje ndërvepruese, një marrëdhënie bashkëpunuese të komunikimit të suksesshëm dhe dëgjimit aktiv, arrihet zhvillimi i iniciativës së pavarur dhe rritja e aktivitetit të nxënësve në klasë. Aftësia e mësuesit për të komunikuar, për të kontrolluar sjelljen dhe emocionet, ndjeshmëria, toleranca dhe bashkëpunimi i tij, do t'i nxisin nxënësit të jenë aktivë në mësimdhënie. Një mësues që inkurajon lirinë e komunikimit për studentët që të jenë në gjendje të shprehin qartë mendimet dhe pikëpamjet e tyre, pa frikë dhe turp, të tregojnë respekt, të ndihmojnë studentët të bëhen të pavarur, të inkurajojnë pavarësinë dhe kompetencën e nxënësve. Lalic - Vucetic (2007) thekson se mësuesit, vëmendja e të cilëve përqendrohet në sjelljen pozitive të nxënësve dhe që përdorin lavdërime, nuk kritikojnë ose përdorin reagime represive, krijojnë një klimë të cënueshmërisë së komunikimit dhe në këtë mënyrë u hapin rrugën nxënësve për të zhvilluar aftësitë e komunikimit dhe sociale. marrëdhëniet. Nxënësit kanë nevojë për mbështetje motivuese dhe afektive gjatë ndërveprimit me mësuesit dhe bashkëmoshatarët. Me këtë qasje, studentët përfshihen pa frikë në aktivitetet në klasë.

Mësuesit duhet të përmirësojnë komunikimin me nxënësit në baza ditore dhe të përpiqen të zvogëlojnë pjesën e të folurit në komunikimin me ta, të krijojnë një komunikim të kthyeshëm, pra njëlloj të ndryshueshëm mes tyre dhe nxënësve.

